ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 22 MAJ 2021. NUMËR 131 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Ky shkrim synon të jetë një itinerar i ndjekur prej përkthyesve për të sjellë në shqip Dante Alighierin, para se ai të vinte i plotë nën përkthimin mjeshtëror të Pashko Gjeçit. Në një moment tjetër do të botojmë edhe një itinerar që fillon pikërisht nga ky moment, pra pikërisht nga botimi i përkthimit të plotë dhe vijon gjer' sot, ditë në të cilat akoma përkthyes të ndyrshëm sprovojnë veten me shqipërimin e Dantes!

SHTEGTIMI I DANTE ALIGHERIT NË GJUHËN SHQIPE

Nga Andreas Dushi

Dantja dhe Shqipëria,
vizatim nga Abdurrahim Buza

BOTOHET NË KINË "SHQIPËRIA NË ART" I FERID HUDHRIT

Libri "Shqipëria në Art", i përkthyer në gjuhën kineze nga Wang Xianya sapo është shpërndarë nëpër librarinë e Pekinit dhe qyteteve të tjera të Kinës. Është realizuar nga Shtëpia Botuese e Mësimit dhe Studimit të Gjuhëve të Huaja (Foreign Language Teaching and Research Publishing Co.,(FLTRP).

(fq.14)

SHËNIME PËR LIBRAT

Vëllimi "Transkript nga krevati tjetër"

NJË PËRPJEKJE PËR TË TRANSKRIPTUAR LIBRIN E ERVIN HATIBIT

Nga Adrian Zalla (fq.7)

Vëllimi "Trup e shpirt" i Timo Fllokos

POEZI E NDJENJAVE INTIME TË NJERIUT

Nga Ali Aliu (fq.10)

Novela e Lev Tolstoit

ATË SERGI, "MËKATI I KRENARISË"

Nga Agim Baçi

Musa RAMADANI: ***Profeti nga Praga,***

RINGJALLJA E KAFKËS

Nga Gentiana SOFTOLLI (fq.11)

Intervistë me poeten e njohur nga Prishtina



ERVINA HALIL:

Procesin e shkrimit e shoh si zbulesë të po asaj kujtese që veçse është brenda nesh, por e kemi harruar

(fq. 8)

BERNARD-HENRI LÉVY

Refleksione mbi Luftën, të Keqen dhe fundin e Historisë

LIBRI I RI I MIRA MEKSIT

"Kutia e Agatha Christie-t", një roman për dashurinë

Nga Shpëtim Doda

BIBLIOTEKË

Adil Olluri (fq. 16)
Fragment romani në dorëshkrim

Ballsor Hoxha (fq. 17)
Poezi

Silvio D'Arzo (fq. 19)
Dy pleq

Vianu Mureșan
E mbështolle veten në një fustan të zi (fq. 18)

Poezia Moderne Hebraike
Këngë gruaje (fq. 21)

Versioni që solli Driada Dervishi me teatrin "Aleksandër Moisiu" ishte vezullues, kishte dritë.

Burra-gra: edhe duhemi, edhe grindemi!...

Nga Josif Papagjoni (fq.20)

SHTEGTIMI I DANTE ALIGHIERIT NË GJUHËN SHQIPE

Nga Andreas Dushi

Sigurisht, për shumëkënd, *Komedia Hyjnore* në shqip lidhet drejtpërdrejt me emrin e përkthyesit të njhur Pashko Gjeçi çka është e drejtë dhe krejt e përligjur pasi në vitin 1960, shtëpia botuese *Naim Frashëri* e botoi të plotë këtë kryevepër nën përkthimin e tij. Vlerat, saktësia dhe besnikëria e këtij përkthimi nuk mund të jenë dhe nuk janë objekt i këtij shkrimi: për to ka folur vetë shoqëria *Dante Alighieri* duke e quajtur si një ndër tre përkthimet më të mira të Dantes kudo ai është përkthyer.

Përgjatë viteve pasardhëse, përkthimi i Gjeçit do të ribotohej shumë herë, në Shqipëri nga *Naim Frashëri* deri pas rënies së komunizmit si dhe në Kosovë nga *Rilindja* (botimi i 1981 redaktuar nga Ali Podrimja). Së fundmi, me rastin e ***Dantedì*** (25 mars), shtëpia botuese *Onufri* e risolli, shoqëruar nga një parathënie e Ismail Kadaresë dhe një studim i Natalino Sapengos.

Përveç vlerës në rrafsh gjuhësor, ky përkthim ka edhe një vlerë të madhe në rrafsh historik pasi është, sikurse e thamë, i pari përkthim i plotë i veprës. Por kjo nuk do të thotë se më përpara, përkthyes të tjerë nuk kanë provuar ta sjellin në shqip këtë kryevepër. Kështu që në vijim, po paraqesim një udhëtim të shkurtër në mënyrë kronologjike të disa prej këtyre tentativave, qysh nga fillimi, deri në botimin e plotë të veprës. Kjo edhe për të treguar se nuk ekziston një lidhje organike mes ardhjes së Dantes në shqip për herë të parë dhe ardhjes së fashizmit, sikurse studiues të ndryshëm kanë pretenduar.

Në esenë *Dantja i pashmangshëm,* Kadare thotë: *Sipas Ernest Koliqit, danteolog dhe shkrimtar shqiptar antikomunist, i ikur nga Shqipëria fill pas kapitullimit të Italisë, përkthimet e para të Dantes, copa nga "Komedia Hyjnore", "Jeta e re" dhe "Gostia", u përkthyen e u botuar në shekullin XIX, nga arbëreshi Luigi Lorecchio. Në vitin 1900 u përkthye Këngа e pestë e "Ferrit", nga Sokol Baçi, shqiptar erudit nga Mbishkodra. Ndër të parat përkthime, fill pas pavarësisë dhe kaosit shqiptar, ka qenë Këngа e njëmbëdhjetë e "Parajsës" (Shën Françesku), prej Pater Vinçens Prennushit, poet e dijetar, vdekur tragjikisht më pas në burgjet komuniste. Në vitet '30 ndodhi shpërthimi i Dantes me përkthime e përkthyes të shumtë, ndër të cilët u dallua vetë Ernest Koliqi.*[1]

Në këtë citim, Kadare e ka fjalën për shkrimin *Dante e noi Albanesi* të Ernest Koliqit botuar në vitin 1965 te *Shêjzat*[2]. I gjithë ky numër i asaj së përkohshmeje i është kushtuar pikërisht Dante Alighierit me rastin e 700 vjetorit të lindjes së tij. Në brendi, bëhet i njohur për shqiptarët jashtë atdheut përkthimi i plotë i realizuar nga Gjeçi, duke i bërë edhe jehonë. Autorë pjesëmarrës janë vetë Koliqi, Martin Camaj, Giuseppe Gradilone, Nos Qirjaku, Karl Gurakuqi dhe Atë Giuseppe Valentini.

[1] Kadare, Vepra 18, Shtëpia Botuese "Onufri" fq. 364.
[2] Ernest Koliqi, "Dante e noi Albanesi", "Shêjzat", IX, nr. 9-10, 1965, fq. 321 - 326

PËRKTHIMI I LUIGI LORECCHIOS

Bazuar këtu, e orientuam kërkimin tonë drejt gjetjes së atij përkthimi, të parit, kryer nga Luigi Lorecchio. Bëhet fjalë për librin *Antologia Albanese* përgatitur nga De Rada. Aty është, në dy gjuhë, italisht dhe *në gjuhën e Arbëris*, përkthyer nga Lorecchio Kënga I e Ferrit. Në vijim po paraqesim veç një pjesë të shkurtër prej saj, edhe si një dëshmi të mënyrës se si është shkruar shqipja nga arbëreshët e asaj kohe:

Ka pissa e Dantit. Kenka e paar pëjerr ndë gjuugh t' Arbërès[1]

E gjoghes s'aan tek gjîmsa e õômìt
m'u ndòõa mbrènta te ñë piilj e erret,
se ûõin e mbaar e kìša bìérrur.

Bobo cë pûne e reend ! oo për mê thëën
sa ajo piilj iš e égkër ej e krèšk,
më vet ndë ni kuljtòñ ntenet drea.

Eiõur oo! sâ pak vëdekia e škón :
po të mîatë të tièra se të Ɛë fiil,
të tierat kë me ñògha u dùa të thóom.

Të rrëfieñ sì u këghassa nkë dii miir
piòt gjuum si išia tek aí momènt
kûr ûõënë e drèkjtë e patta ljëën.

PËRKTHIMI I SOKOL BAÇIT

Vetëm pak vite më vonë, Sokol Baçi, *shqiptar erudit nga Mbishkodra* sikurse na thotë Kadare, do të jetë ai që do të marrë guximin për të përkthyer dhe botuar një tjetër pjesë të *Komedisë Hyjnore*. Bëhet fjalë për Këngën V të Ferrit, vargjet nga 88 deri në fund:

Saggio di traduzione in Albanese[2]
di una parte del V CANTO DELL' "INFERNO" DI DANTE[3]
Kalzim
Dantia ishte me Virgilin n' rèth t' dyt t' Ferrit kû gjinden t' flhightit, t' zilt jan paa práa hiedh e mundue prej gnieers t' rebt fort. Ktù paa dy vet qi shkoishin bashk: Francesken prej Rimini e Paloken Malatesta; i thiri e Franceska alzoi t' dhèmshmen istorien e vet[4].

Vjersha

Niiri i kandshem e i but, qi gjalh halaa
Erdhe me gjet ne kèt burgh me te kqija plot
Nee, qi token me gjak gni dit kem laa,

Me naa pas nepak n' hiir i Madhi-Zot,
Kishim me e lut per tyy, sî per pagj tanne
Massi per t' zhezhen ton kaq po derdh lot.

Mii ckà me ndii me fol tyy fort po t kanne
Na po ndighioim, po flasim sî qef kee
Tesh qi sikur po dan eera po prâne.

Gjindet qyteti i em n' t' zilin kam lee
N' bregh t' deetit, shi m' gnat vend ku Pohi shghrehet
Me lumet tjer, qi i mledh dhee neper dhee.

Dashtnija qi me i her zhemers i qepet
E kapi ket per t' bukrin trupin t' im
Qi bora, me c' mndyr gjaku halaa m' zehet.

Kush â dasht per paa dasht nuk kaa peshtim;
E vet praa me te zuna i kaq miksii
Qi, si po shef, as tesh s' mund t' m' qes n' harrim.

M' gni soi deket naa coi ne kiò dashtnii,
E e pret Kaina atè qi naa maroi.
Gniketo fjal prej tyne kiene ndii.

Prej biseds t ktyne shpirtne ndrova boi;
Fort u trishtova, e mec me krye ner kam
Saa m' pueti Beitagija[5]se c' mendoi.

Une pergjegja me gni t' madhe sham:
Oh saa mendime t ambla i cuun kta t' shkret,
Oh saa dishiir, n' ket t' zhii marim, oh c' nam!

Mandei prej tyne u solha e fola vet
E filhova: Franceska e zhezha jote
Ma derpton zhemren an per an si zhggjet.

Por deh! m' kalzò: Kuur gneni tjetrin dote

[1] Girolamo de Rada, "Antologia Albanese", Napoli, 1896, fq. 66 – 70.
[2] *La Nazione Albanese*, anno IV, num. 6, 31 marzo 1900.
[3] *Dal verso **88** sino alla fine del Canto.* (shënimet me *italic* janë të tekstit origjinal)
[4] *Franceska kjè e bija e gnifar Guido da Polenta, Beghu i Ravens, i zili ja dha per grue Begut Riminit Gianciotto Maletsta, ghadi si me perdhun, psè Franceska nuk e pelqete Gianciotton, qi ishte i mrapsht e ghunghiac. Zuni praa miksii me Paloken t'kunatin e vet, dial i pashem e fort i vjefshem, me t'zilin tuj e gjet gni dit i shogji i myti t'dy n'viet 1284.*

[5] dhe [6] *Bietagija – Zhotnia asht Virgjili.*



Me zhemer vec, dashtnija n' c' mndyr e si
U zhblue qi halaa jasht s' u diftote?

E mue ajò: Kurgjâa maa keq, o ti,
S' asht se ditt e ghazhmendit me kuitue
Kuur keem raa posht: Zhotnija[6] i jot e di.

Per massi ranzen ti dishron me zhblue
E dashtniis on, e t' kande fort me e dit
Un tuj fol e tuj kjaa kam me t' diftue.

Rishim e kndoishim bashk per qef gni dit,
Si Lancilotti mas gni vaizhs sharroi;
E halaa shoqi-shoit shkndii si kem qit.

Tui kndue gneni tjetrin shpesh filhoi
Me kqyr; ftyra si lakena na u bâa,
Por gni vetim kjè ajo qi na zhaptoi.

E si e bukura buzh kuur mrim me paa
Prej gni ashikut aq t' ndezhun puth kjè e lmuu,
Ky qi prej mejet kurr s' kaa me ken daa,

Tuj u dridhun ma puthi ghojen muu.
Galeotti[7] emnin librit ja kaa lan,
E maa c' at dit nuk muitme n' te me knduu.

Gnera hije ktà t' dhimshme fjal tuj than
Tjeters sî ghurra i shkoishin lott saa t' mek
M' raa mue, sikur t' ishe shpirt tuj dhan.

E raash sikur rzohet trup i dek.

Edhe në numrin e sipërcituar të *Shêjzave* është paraqitur ky përkthim, bashkë me një shënim nga redaksia të cilin po e japim të plotë për ta njohur se kush është përkthyesi:

Nji provë përkthimi mjaft e interesantshëme gjindet në La Nazione Albanese *(Vjeti IV - Num. VI - 31 mars 1900) t'Anselmo Lorecchio-s nënshkrue Sokol Baazi. Mbas gjase auktori âsht Kola i Sokol Bacit. Sokol Baci, burre në zâ kah fillimi i këtij qindvjeti, vojvodë i Grudës, ishte adjutant i Krajl Nikollës të Malit të Zí. Gruda bante pjesë, nonse shqiptare, me principatën e Gospodarit të Cetinës. Kolë Baci, i biri, kreu studimet universitare në Romë e syzimi letrar qi po parashtrojmë dishmon se në rinín e vet merrej me gjuhë shqipe e me letrësi.*

Ky asht nji hartim në të cilin vrehet qartas shkalla bukur e naltë ku para 65 vjetve kishte arrijtë zhvillimi i shqipes letrare. Sot na shofim në të disa të mbeta: përdorim fjalësh turqishte, kumbim rimesh tepër të rendomta, nji farë vishtirsije në rrotullime të perjudhave, por duhet marrë parasysh se asokohe ishim ende në fillesë të përpjekjeve letrare. Asgjâmangut kjo copë e Komedís Hyjnore, sjellë në gjuhë t'onë, dallohet për nji zotsi të rrallë në te hartuemit e vargut njimbëdhetërrokësh e për nji njomsi shprehjesh idiomatike qi i ep përkëthimit nji shije të thjeshtë shqipe. Tue mendue kohën kur u botue, kjo cope, nonse me disá të mbeta, na çuditë për shkathëtín shprehse të saj.

PËRKTHIMI I ATË VINÇENS PRENNUSHIT

Më pas, për më tepër se dy dekada, asnjë pjesë nga krijimtaria e Dante Alighierit nuk botohet në shqip. Bazuar në bibliografitë e *Bibliotekës Kombëtare*, rezulton se vetëm në vitin 1926 në të përkohshmen *Zani i Shna Ndout* do të lexohej sërish në shqip *Komedia*. Tanimë është *Kanga XI, Parrizi*[8] ku tregohet takimi i Poetit me Shën Françeskun. Ajo botohet e ndarë në gjashtë numra të së përkohshmes: nr. 5, 2 maj, 1926, fq. 75- 77; nr. 6, qershor, fq. 90 - 92; nr. 7, korrik, fq. 106 - 109; nr. 8, gusht, fq. 122-125; nr. 9, shtator, fq. 138-140; nr. 10, tetor, fq. 158-161. Si hyrje, mes të tjerash, shkruhet:

Komedija Hyjnore e Dantit në giûhë shqype? A s'vsht nji guxim?

T'a thrrasë bota letrare gjith si të duen ket hapin t'one, na, pa pasë nevojë per tash me u zblue tjerve çka me dashtnì e cene e me nji vullndet të çeliket veprohet nen hijet e paqta të kuvêndeve per të bëgatun t' amles giûhe amtare, kemi dà e ç'

[7] *Galeotti asht emni i gni librit qi kalzon si Lancillotti, ushttar fort n'zhàa motit, zuni miksi me vashen e bukur Ginerva; e ktù do me than qi sikur motit Gallehault kiè shkuusi i Lancillotit me Ginerven, ashtù libri i tii kiè i Paloks me Francesken.*
[8] Dante Aligieri, "Parrizi", Kangë XI, nga "Komedia hyjnore", "Zani i Shna Ndout", nr. 5, 2 maj, 1926, fq. 75- 77.

me ket Numer po nisim me botue, sa per shijim t'ksajë veper pernjimênd të madhnueshme e pse gjindena mrênda rrethit të Kremteve shtate qindvjetore të dekës së Sh Franceskut, Kângen e XI të Pjesës III të Komedis Hyjnore në të cillen flitet giatë mi jeten e veprimin e kti Patriarkë Shêjt, masi paraqitet në tê me nji perftyrim te kand shem vendi ku u lè Shêjti si nji diell, të larguemt e tij prej ba bet tuej u lidhë me vobsi si më kunorë, të mkamunt e Urdhnit franciskan, pranimi i rregullës prej dy Papve, dishiri i martirizimit, shty prej të cillit del para Sulltanit me predikue, të kthyemt e tij n' Itali, te mârrunt e varrve e deka e lumnueshme qi ky Shêjt bâni.[9]

Pra, përkthyesi nuk bëhet i njohur. Pak vite më vonë, kur Padër Vinçens Prennushi boton vëllimin poetik *Gjeth e Lule*, në fund shton edhe këtë përkthim, çka na tregon se është pikërisht ai përkthyesi. Në vijim po paraqesim pikërisht variantin e gjendur në këtë libër, pasi kemi të bëjmë me një botim të mëvonshëm dhe të rishikuar prej përktyesit.

Përkthimi është i plotë, pra e gjithë Kënga, por ne po paraqesim një pjesë të saj, nga vargu *37* deri në *111*.

PARRIZI[10]
Kângë IX

QIELLA E DIELLIT – SHPIRTENT E DIEJSHEM

[37] Njani n' dashtní desht serafimësh t' flakoje,
E tjetri qi mî tokë per dije t'ishte
Dritë kerubike, qi gjithkah t'ndritoje.

[40]Per njanin due ktû t' flas: nji vlerë po kishte
Si njani tjetri, kêdo t' nisësh me çmue;
P'r' i qellim veprash Zoti t'dy i grishte.

[43]T''Tupinit n' mjes e t'ujit qi tu'u lshue
Prej kodre t'zgiedhun bjen t'Ubald, t' bekuemit,
Nji moje e frytshme mali gjindet shtrue,

[46]Kah ndíen Perugja t ftoftë e t' xét ne t' çuemit
Prej Porta Sole, e per mas kû i kjájn
Noçera e Gualdo si prej peshës t'randuemit,

[49]N' ket brî kû kjo, si syt munden t' a dájn,
E then perpjeten, bota pau tuj lé
Nji diell, si n' Ganxhe ndollë ka 'i herë; kúr t'bajnë

[52]Kushdo, prá, fjalë permî ket vend, ket dhé
Aj mos t'a thrrasë Asces, Orjent t'ia njese
Po desht me folun si don folë nder né.

[55]Nuk ishte gjith aq larg pre' asaje fillese,
Kúr nisi ktij mî tokë t'i delte zâni
Per vyrtyt t' madh, qi siellte nji farë shpnese;

[58]Pse p'r aq nji grue ky djalë i rí, n' luftë rrâni
Me t' anë, pse asajë mia çile, m' sá mordes kushi
Deren e gzimit zemra kuej s'i bani.

[61]Para bujarvet n' shpírt dishirin mushi
E para babës, me tê kúr muejt t' bashkohej,
Tu' e dashtë mandej si nuk e desht askushi.

[64]Kjo, masi i rá prej burrit t' parë t' vejohej,
Per vjet njimi e 'iqind perbuzë pat metë,
E dér n' ket nier' s'u gjet kush ti afrohej :

[67]As me ndie s' viëjti se t' sugurtë me e gjetë,
Bashkë me Amiklatin, n' tingell t' zânit t' sajë,
I rá njatij qi boten m' frigë pat shqetë.

[70]As viejti gjâ t'qindrohej si askurrajë,
Kshtû qi, kû Mrìs i rá shi poshtë me u ndalë,
Ajo me Krishtin mrrijti n' Kryq te kjajë.

[73]Por, qi biseda teper mylltë mos t' m' dalë,
Per kta dy t' dashtun, Franon e Vobsin
Kupto tashmâ, kah jam tu'u zgiatë nder fjalë.

[76]Lidhnija e zêmres, ftyra n' gzim, dashinín,
Me t' kqyr'na t' kandshme, n' shpírt aq fort i a shtini
Sá veç tu' i pá mêndojshesh shêjtenin;

[79]Aq, sá Bernardit shêjt per zêm'r i hini
E u zdath mâ i pari e, mas asajë qetsí
Ngâu e tuj ngâ, i u bâ se vonë aj mrrîni.

[82]Kam, qi s' kjè njoftë, e mirë e frytshme unjí!
Egid, Silvester zdathen per nji heri
Kaq, mas ktij dhanderr, pelqen vasha e tí.

[85]Mandej udhton aj babë e msues per nderi
Me gruen e vet e me familje t' veten,
Pse t' prûjtë litarin njeshte tash shum nieri.

[88]As s'i u xûn syt se ndiete n' zêmer t' shkreten
Se ishte djalë i Pjeter Bernardonit
E se n' t' perbuzun do t'a shkote jeten.

[91]Por mretnisht duel e para t' naltë njaj fronit
Mênden e vrashtë Papës Inoçencit fíll
I a zbloj e muer vulen e rreligionit.

[94]E çeta n' skam si u shtue n' per msim e kshíll
T' ktìj, jeta e t'cillit mâ mirë kish' me u kndue,
Kaq kje per mrekull, n'lumní t' epra n'Qiell,

[97]Me i kunorë tjeter rishtas kje kujtue
Prej Shpirtit Shêjt, e i a pat dhâne Honori,
Dishiri i ktij Arkimandritës t'bekue.

[100]E masi, etshem per martir, aj xori
Para Sulltanit, laimtár me hir,
T' predikojë Krishtin e kê e mas aj mori,

[103]E si e pat gjetë per kthim gjith aq-e t' vshtír
At popull marë, qi aty aj kot mos t' rrite,
N' njomsi itatjane kthej ke fryti i mirë!

[106]N' shkam qi n' mes t' Tibrit edhè t' Arnit bite,
Vulen e mramë prej Jezu Krishtit muer,
Qi per dy vjet n' giymtyrë per t'a bárt kite.

[109]Deri sa aj, qi per aq t' mirë e xuer,
Deshti me e ngrehë fíll nalt e kah shperblimi
Qi aj meritoi te pervûjtnís n' sinuer.

Një fakt tejet interesant që lidhet me këtë përkthim gjendet edhe në *Gazetën e Tiranës*. Në numrin e saj të nëntë, datë 11 tetor 1931, kjo gazetë boton një shkrim me titull "Komedija Hyjnore e Dante Alighierit në gjuhën tonë" ku parashtron idenë se, pas një fragmenti të saj përkthyer prej Padër Prennushit, ky i fundit do ta përkthejë dhe botojë të gjithë veprën. Por me sa duket, kjo nuk ndodhi, dhe nuk ka asnjë të dhënë nëse ai vijoi me përkthimin.

—

Një vit më vonë, e përkohshmja *Demokratia* do të botojë disa fjalë të urta nga "njerëz të mëdhenj" mes të cilëve përfshihet edhe Dante. Citati i marrë prej tij është:

Neqezllëku shuan dëshirën t' onë për ç'faredo mirësi.[11]

Përgjatë viteve të ardhshme, vijon të shkruhet për Alighierin. Fillimisht është H. Dakli ai i cili në *Normalisti* boton "Dante Alighieri edhe vepra e tij 'Divina Commedia' (Komedia Hyjnore)"[12] e më pas, në revistën "Ora" botohet një shkrim i Klyda Richardson Steege me titull "Dante, Poet' i perëndishëm i Florencës"[13]

PËRKTHIMET E ERNEST KOLIQIT

Përkthimi i Dantes do të vijonte veç në dekadën e ardhshme, përkatësisht në vitin 1932 kur Ernest Koliqi botoi vëllimin e parë të librit "Poetët e Mëdhej t'Italis", shtypur në shtypshkronjën "Nikaj", Tiranë. Në atë vëllim përmblidhen poezi të përkthyera nga Koliqi prej katër poetëve italianë: Dante Alighieri, Francesco Petrarca, Ludovico Ariosto dhe Torquato Tasso.

Pjesa kushtuar Dantes, e cila është edhe e para, ajo që e çel vëllimin, paraprihet nga një shënim i ndarë në disa kapituj për jetën dhe veprën e poetit. Nje pjesë syresh janë përkthime nga tekstet bazë të studimit të letërsisë italiane si "I grandi autori della letteratura italiana" të G. Lipparini, "Breve Storia della Letteratura Italiana" të E. Danadoni, ndërsa një pjesë tjetër, vëzhgime dhe studime të përkthyesit.

Përkthimet përfshijnë të gjitha fushat e krijimtarisë së Dantes. Pra, përveç disa këngëve të caktuara të *Komedisë Hyjnore* (*Françeska*, *Pjer de la Vinja*, *Ulisi*, *Kont Ugolini*, *Kazela*, *Sordeli*, *Matelda*, *Të dukunit e Beatriçes*, *Poemi i Parrîzit*, *Shën Françesku*, *Virgjines*) ka edhe *Beatriçe* nga *Jeta e re* si dhe *Tingëllim* dhe *Baladë* marrë nga *Libri i Kângëve*.

Në *Shêjzat* e përmendura qysh në krye të herës, nën pseudonimin *Hilushi*, Koliqi boton edhe shkrimin e tij me titull "Ahmarrja e të mërguemit qi quhej Dante", ku mes të tjerash, qysh në fillim, shkruan:

"Rreth vjetit 1930 i a pata hŷ me gjoks përkëthimit të disá vjerrshave të Dantes. Tue lexue aty-këtu në libra të ndryshëm ngjarjet e jetës së tij, më rá menjiherë asokohe në sý gjasimi mutandis mutandis gjendjes së Firencës gjatë rrnesës së Poetit me atê të Shqipnís. Kronikat e Dino Compagni-t e të Gjon Villanit mbi gjakimet (passions) qytetare, shembrimi (rivalité) ndërmjet dý dyervet paranike të Cerchi-evet e të Donatvet, përleshjet e përgjakëshme, tërnimi (alternance) në krye të pushtetit të lagjeve kundrështare politike, hovi lakmues me dalë njâni sipër tjetrit, ndërhŷmja e të huejvet, mënija e flakët qi turbullonte mende e zêmra, epshi i sundimit më tërhiqshin si me pasë qênë tregim qi na përkitte s'afërmi né Shqiptarvet. Më përshkoheshin, nëpër kujtim, tue i lexue, ndodhít e rrethanat t'ona q'prej vjetit 1920 e tutje. Jeta e Dantes u end në nji atmosferë qi shum prej nesh kanë përjetue. Mjafton mërgimi i tij politik m'e shênjue Poetin si njeri qi pasqyron në vetvete punë e kushte gjallese tëcilat Shqiptarët, me radhë, njoften."[14]

Në vijim po paraqesim disa copëza nga libri, duke filluar me tre krijimet që nuk bëjnë pjesë te *Komedia*, për të vazhduar me ato pjesë që janë përkthyer edhe nga të tjerë, për të krijuar mundësinë që të bëhet edhe një lloj krahasimi mes përkthimeve:

BEATRIÇE[15]

Beatriçja kalon nëpër qytet, e âmbël dhe e përvûjtë; pershëndetja e saj ngjall në poetin ndiesí qi s'âsht i zoti të shprehin; ajo âsht nji mrekull i gjalle qi mbush, kêdo qi e soditë, me âmbelsi, edhe e bân me dënesë prej mâllit qi zgjon në shpirt.

[1]Aq' e njerzíshme e aq e hijshme gjanë
grueja e eme kur gjint ajo përshndetë,
sa qi gjuha, tu' u dridh', pa folun mbetë,
e syt për m' e shikue guxim nuk kanë.

[5]Ajo kalon, tue ndie lavde n' çdo anë,
e veshun n' përvujtní t' âmbël e t' qetë;
e duket nji gjâsend qi qilla vetë
na çoi me i tregue mrekull tokës tanë.

[9]Kaq' e pëlqyeshme i gjan' kuj e soditë
qi, npër sŷ, i ep zêmrës nji âmbëlsí
qi kush nuk e provon nuk mund e dijë.

[12]E thue sikur në buz't e saj shetitë
nji fllad i kândshëm, plot me dashuní,
qi shkon tu' i thânun shpirtit: - Psherëtijë.

TINGËLLIM[16]

Fantazija e Dantes ândrron qi atê bashkë me Guido-n e Lapin e me trí zojat e tyne t'i zênte si nji magji qi mbrênda nji anije, t'i çonte në hapësín e në vetmin e detit ku mos të bâjnë tjetër veçse me folë gjithmonë mbi dashuní.

[1]Kisha me dasht' qi tý, Lapin e mue,
Guido, t' na zênte si nji far' shortije
e t'na shtînte të treve n' nji anije
qi era t' çoj npër dét kah t' duem me shkue;

[5]n' mnyr' qi mos t' mujte kurr me na ndalue
as koh' e keqe dh' as furí duhije,
por, tue jetue mbas qejfit t' on', t' na vije
ândja me ndéjun bashk' prore t'u shtue.

[9] E zojën Vanna e zojën Lagja t' vênë,
me atê qi âsht n' numrin tridhjet' e çfaqun,
brij nesh fuqít e magjistarit t' onë,

[12]e aty me fol' mbi dashunín gjithmonë,
e sejcila prej tyne t' jet' e knaqun
sikur dhe na kujtoi kishim për t' qênë.

BALADË[17]

Poeti dergon këtë baladë si lajmtare ke vasha e tij për me i tregue mjerín qi e ka mbulue e i thotë se, po s' qe e zoja t'i bije ndonji ngushullim prej saj, do ta shifte krejt tue mbarue.

[1]Me petkun e 'i lajmtarje plot urtí
shko ti, baladë, aty ku due me t' çue,
shko ke ajo vasha e bukur pa u vonue
e thuej qi jeta e ime âsht tue u shkri.

[5]Fillo e thuej qi sŷt e mij dikuer
për me i shikue fytyrën engjullore
vêjshin për rreth si nji kunor' deshiresh:

[9] Po aty, fq. 74.
[10] Dante Aligieri, "Komedia hyjnore", "Parrizi" - Kangë XI, "Gjeth e Lule", botimi II, Shkodër, Shtypshkronja Françeskane, 1931, fq. 161 – 163.
[11] "Fjalë të urta (Nga Sallnstius, Seneca, Dante, Ausonius)", "Demokratia", nr.12l, 24 shtator 1927, fq.3
[12] H. Dakli, "Dante Alighieri edhe vepra e tij 'Divina Commedia' (Komedia Hyjnore)", "Normalisti", nr. 6, tetor 1929, fq. 6-17.
[13] Klyda Richardson Steege, "Dante, Poet' i perëndishëm i Florencës", "Ora", nr. 40, 3 nëntor 1929, f.10-11 si dhe në nr. 41, 15 nëntor, f.18-19.
[14] Hilushi, "Ahmarrja e të mërguemit qi quhej Dante", "Shêjzat", IX, nr. 9-10, 1965, fq. 289.
[15] Ernest Koliqi, "Poetët e Mëdhej t'Italis", shtyoshkronja "Nikaj", Tiranë, 1932, fq. 27.
[16] Po aty, fq. 28.
[17] Po aty, fq. 29.

por tash qi pamja e saj sŷve i u muer
[9]po m'i fik' me mjerim Deka mizore
sa i q'u rrethuene me 'i anak martiresh.
I shkreti un! qi s' dij se ç'far' ëndiresh

[12]t'i u gjêj; e do t'më shifish krejt t' mbaruem
mos mujsh ndoj ngushullim prej saj me m' prûem :
prandej po t' lus, baladë, me ámbëlsí.

Ndryshe nga përkthimet e tjera, Koliqi te përkthimi i tij i *Komedis*ë numëron tercinat, jo vargjet. Ai e fillon përkthimin e Këngën I të Ferrit, një pjesë të së cilës po e paraqesim më poshtë.[18]

Ferrë, Kânga e parë.[19]

Jetu e njeriut i gjason nji udhtimi. Në këtë kângën e parë të Komedis Hyjnore qi âsht parathânja e të gjith poemit, si kânga e dytë asht parâthanja e Ferrit, Dante tregon si në gjymsën e këtij udhtimi kujtohet se ka humbun në nji pyll t' errshëm. Del prej këtij pylli e gjindet ke rrânzat e nji kodre. Me mëzi përshkon nji bregore e fillon me i u ngjitun përpjetjes : por trí bishë t' egra, nji panterë, nji luâ e nji ulkojë, njâna mbas tjetrës, i a pêngojnë rrugën. Në fillim qindron, por mbandej, mbushë me tmerë, kthen dalë.

Kur qe, më sa âsht tue hŷ rishtas në pyll, i duket nji hije, Virgjili, qi tue i lajmue ardhjen e nje Lângoni, gjetur i asaj ulkoje, e fton me e ndjekë nëpër Ferrë e Burgatuer për në dashtë me shpëtue prej atij rreziku. Në Parrîzë do të ngjitej, po deshti, me nji prîs tjetër. Dante pranon, edhe nisën së bashku.

[1]Në gjysmën e shtegtimit të jetës s'onë, mbassi
qi humba udhën e drejtë, u gjeta në nji pýll
t'errshëm.

[2]Ah sa vishtír âsht me tregue ç'pýll i egër,
i dêndun edhe i ashpër ishte ky qi vetëm tue
e mêndue t' a përtrîn frigën!

[3]Aq' i idhun sa pak mâ tepër âsht deka; porse
me diftue të mirën qi aty gjeta, po tham
sêndet të tera qi páash.

[4]Un s'dij me kallzue mirë se si aty hŷna
kaqë ishem mbushë me gjumë n'at ças qi laçë
udhën e vërtetë...

***

Françeska[20]

Ferrë, V, vv. 73 - 142. - Në rrathin e dytë janë të dënuem mëkatnorët e dashunís. Sikur në jetën e tyne qenë rrëmbye prej duhís së furishme të pësimit, ashtu tash nji stuhí e rrëmbyeshme i hjedh si gjeth n' erë, e i sjell e i rrahë njânin kundra tjetrit. Shkojnë tuba tubu si zogjt.

Ndërmjet t' atyne shpirtënve Dante shef dy qi duken mâ të lehtë se shokët e qi i a vrasin sŷnin pse era nuk i hjedh kundra shoqishojit, por i lên të bashkuem.

Atëherë Dante pyet Virgjilin për ta.

[6]"O njeri plot me hir e me mirsí
qi shkon tue vrejt' nëpër kët bân' mjerimit
né qi botën me gjak kem' kuq'e rî,

[7]mik po t'na ishte mbreti i rruzollimit
do t'a lutshim Atê për paqën t' ande.
mbassi ndien dhim' për né qi humbme shqimit.

[8]Na po ndëgjojm' shka me na thân' ju kande,
po flasim shka me ndie u pëlqen jue
m' sa po pushon, si bâni, era e rânde.

[9]Toka ku linda shtrîhet t'u zgjatue
bregut detit ku lumi Po na zbritet
me gjith ndjeksit e vet për me pushue.

[10]Dashnija qi vrik n' shpirt t' njerzíshëm ngjitet
këtê shtŷni at trup t' bukur t adhurojë
qi m' qe hjek '; e prap mnyra e vráshme m' gitet.

[11]Dashnija qi s' lên t' dashun pa bâ t' dojë
kaq fort kah ândja e ktij më ka tërhjekë
sa, si shef vet', as ktu nuk mundet t'm' lshojë.

[12]Dashnija na çoi t' dy s' bashku me dekë.
Kaina e pret atê qi mbyt na ká."
Fatin e tyne kshtu erdhën tue çekë.

[13]Kur ndëgjova ata shpirtën keqas vrá
ula fytyrën edhe e mbajta aq' gjatë
deri sa mjeshtri m' tha: "N' ç' mêndim ke rá?"

[14]Kur i u përgjegja, zûna: "Ah krajatë!
sa mênd' e âmbël e sa shum deshirë
dergoi në shteg t' pikllueshëm kta dy t'ngratë."

[15]Mbandej fola prej tyne tuj u prirë

LA DIVINA
COMEDIA DI DANTE,
DI NOVO ALLA SVA VERA
lezione ridotta con lo aiuto di molti
antichissimi esemplari.
CON ARGOMENTI, ET
ALLEGORIE PER CIASCVN
Canto, & Apostille nel margine.
ET INDICE COPIOSISSIMO DI
tutti i Vocaboli piu importanti usati dal
Poeta, con la sposition loro.
CON PRIVILEGIO.
IN VINEGIA APPRESSO GABRIEL
GIOLITO DE FERRARI, ET
FRATELLI. M D LV.

e fillova: "Françeska, mue lot dhime
psimet t' tuja prej sýve jan' tue m' xirë.

[16]Por m' thuej: n' kohën e t' âmblave pshërtime
si e prej shkahit Dashnija u ka dhânë
me i njoftun ju deshiret plot dyshime?"

[17]"S'ka idhnim mâ t'madh, -- ajo nisi me thânë –
"se me kujtue kur t' jésh n'mjerim e n' vajë
kohën e lume; Mjeshtri e din q' âsht pranë.

[18]Por n' daç me njoft' se si mâ t parën rrajë
lishoi dashnija e jon' n' jetën qi kishim
m' lên qi tue t'a kallzuemun t' flas e t' qajë.

[19]Nji dit' për qejfi tue lexue po rrishim
si Lançilotin e pat zân' maraku:
pa far dyshimi dhe krejt vetëm ishim.

[20]Ai lexim na la ftyrën pa pik' gjaku
e sa her' sŷt na i nxiti për m'u kqyrë:
por q'u mujtme nji vênd vetëm qe shkaku.

[21]Kur na lexuem se e deshiruemja ftyrë
u puth paprit prej nji dashnori t' tillë,
ky, qi nga un s'do t' dahet n' kurrnji mnyrë,

[22]të tân' tu' u dridhun n' goj më puthi fillë.
Galeot kish qên' libri edh' ai qi e shkrojti.
Atdit flet' tjera n' tê nuk kemi sillë."

[23]Ndërsa qi njâni shpirt këtë na tregojti,
tjetri aq' fort qante saqi si nji t' mekun
prej dhimbes s' madhe zêmren m'a kaptojti;

[24]e rásh ashtu si bjen nji trup i dekun.

Shën Françesku[21]

Parr. XI, 43-117. – Në të katërtin qiell, n' atê të Diellit, Dante shef shpirtënt e doktorave në theologji, qi, tue shëndëritë shkëlqyeshëm, këndojnë e kërcejnë rrath si e Beatrices.

Mbandej prej atij anaku të ndritëshëm dahet nji shpirt, ai i Shën Tomës prej Akvinit, mâ i madhi theolog i Kishës, auktuer i veprës Summa Theologica. *Shën Toma, domenikan, flet mbi Shën Françeskun e Asizit tue rreshtue lavdet e tija, sikur në kangën e pastajshme, Shën Bonaventura, françeskan, ka me ba lavdet e Shën Domenikut (a Dodës).*

Të dy urdhënt, të Françeskut e të Domenikut ishin mëkâmbë për me i dalë zot Kishës në rrezik; por ndërmjet ndjeksave të tyne ngjalleshin zilina e ndodhëshin grindje, qi Dante rrafshon për bind atje në qiell.

[12]Të shkuemit mirë me shoqishoqin e fytyrat
e tyne të gëzueshme, e dashunija e mrekullija
e shikimi i âmbël, ishin shkak i shum mendi meve shêjte:

[13]aqë sa Bernardi i dêjë për nderim mâ i pari
u zdath, e vrapoi kah paqi i madh, e me gjith
qi ngitte i dukej se ish i ngathët.

[14]O pasuní e panjohun, o Mirsí qi ka grat!
Zdathet Egjidi, zdathet Silvestri me ndjekë dhandrrin
kaqë fort u pelqen nusja.

[15]Mbandej shkon ai át e ai mjeshtër me zojën
e vet dhe me at familje qi kish nisë të lidhej
me konop përvûjtnije;

[16]edhe aspak nuk i a zûni sýt turpi qi m' u
dukun njeri i ultë sa me çuditë, ai i biri i
Pjetër Bernardonit;

[17]por në mënyrë mbretnore Inocencit i a tregoi
qellimin e tij të vishtír e prej atij mori vulosjen
e parë për besim të vetin.

[18]Mbassi qi gjindja e vobektë erdhi tue u shtue
mbas këtij, jeta çmeritëse e të cilit mâ mirë do
të këndohej në lavdín e qiellës,

[19]me nji kunorë të dytë shpirti i amshuem rrethoi
me anë të Honorit vullnetin shêjt të këtij
arqimandriti.

[20]E kur, nga eti i martirizimit, në pranin e Sulltanit
krenar, predikoi Krishtin e të tjerët qi e
ndoqen,

[21]e, tue pasë gjetun gjinden tepër të papregatitun
për këthim në fé, për mos me ndejë kot,
erdhi rishtas me nxjerrë fryte nga bari i Italís;

[22]në shkâmbin e ashpër, ndërmjet Tibrit e Arnos,
ai pat prej Krishtit vulën e fundme qi dý
vjet gjymtyrët e tija bajten.

[23]Kur Atij qi e zgodhi për kaqë të mira, i pëlqei
t' a naltoje ke shpërblimi qi meritoi tue u
bâ i vogël,...

PËRKTHIMI I KRISTO FLOQIT

Pas Koliqit, për disa vjet nuk rezulton të jetë botuar ndonjë tjetër sprovë përkthimi e Dantes. Por duhet thënë se ka disa shkrime për të, si përshembull ai i Haxhi Bedos me titull "Dante - Poeti i hyjnueshëm"[22] apo "Danteja dhe Islamizmi"[23] i Ullah Inayat, përkthyer nga anglishtja prej Sherif Putrës.

Ndërkohë në 1937, revista *Leka* do të botonte *Kont Ugolini*[24], përkthyer nga Kristo Floqi. Përkthimi ka 143 vargje nga 157 që ka versioni origjinal. Duke qenë se ka shkëputje, po paraqesim veç një pjesë syresh, me atë ndarje që i ka bërë vetë përkthyesi, krejt ndryshe nga ndarja e zakonshme në tercina me nga tre vargje.

KONT UGOLINI

Kokën lëshoj dhëmbësh, si e breu, e xhvati,
Buzët e përgjakta pas flokëvet fshiu,
Sŷt i zgurdullovi, por si sy lugati,
Tepër ashpër foli mëkatar-fatziu:

"Ç' kam me këtë kokë, që s'po ngjinjem kurrë,
Doni që ta msoni, çashtjen t'ju tregonj ?
He, dëgjoni mirë, kjo ku më ka prurë,
Të keqen e madhe që sot ju zbulonj!
Vjete tash e ruanj brenda zembrës s'ime
Plagën e majisur, kobin që më gjet,
Që më coptoj eshtrat me aqë pikllime,
Bolbën e poterën që shpirtin ma vret!
Ç' më punoj i poshtri s' kanë të rëfyer,
Më mundoj, më treti, më dogji, më shoj,
Kjo s'ka ngjarë kurrë, tepër më ka thyer
Ky qên, ky gjakpirës që më përvëloj!
S' pati frigë Zoti, s' pat as një mëshirë.
Shpirtin ky ma fiku, krejt ma shkatëroj,
Lotet që kam derdhur n'atë burg të pshtirë
Kjo bish' e mallkuar, kjo mi shkakëtoj!
Mizoritë q'hoqmë Zoti ja shpërbleftë,
Se s' mjaftojnë mshimet për këtë xhelat,
Ah, vujtjet e mija Zoti trish ja ktheftë,
Si na ka munduar voftë ky lugat!

"Cilli jé zotrore s'dua ta msonj kurrë,
Si e qysh u ndodhe brenda në kët Ferr,
Vec degjo dhe mbahu, mbabu në jé burrë,
Edhe n'e paç zëmbrën gúr, ose mermer!
Fjalët që dëgjova, fjalë Fjorentini
Më duket se janë, s' kam as një dyshim,
Mso, pra, kush jam un.. KONTE UGOLINI,
Qytatar' i mjerë, që vdiq në dëshprim !
Koka që po shifni, q'e brenj i terbuar
Eshtë koka vetë e njeriut të keq,
E atij RUGJERIT, ipeshkvit mallkuar,

[18] Bëhet fjalë për të njëjtën pjesë që ka përkthyer edhe Luigi Lorecchio.
[19] Ernest Koliqi, "Poetët e Mëdhej t'Italis", shtyoshkronja "Nikaj", Tiranë, 1932, fq 30 – 31.
[20] Po aty, fq. 41 – 46. (Bëhet fjalë për të njëjtën pjesë që ka përkthyer edhe Sokol Baçi)
[21] Po aty, fq. 93 – 98.
[22] Haxhi Bedo, "Dante - Poeti i hyjnueshëm", "Laboremus", nr.16, gusht, 1932, f.21-23.
[23] Ullah Inayat, "Danteja dhe Islamizmi, Ndikimi i koncepteve islame në 'Komedinë Hyjnore", Profesori Miguel Asin Polacio për këtë problem", përkth. nga. anglishtja Sherif Putra, "Zani i naltë", nr. 7, mars, 1933, fq. 580 – 589.
[24] Dante Alighieri, "Kont Ugolini" nga "Komedia Hyjnore", përkth. Kristo Floqi, LEKA, nr.4, prill, 1937, fq.162-165.

Që prej sijsh nuk ndahem, as dorë nuk heq!
I besova shpirtin këtij arrakati,
Këtij klyshit t' Ferrit, nierint rrencak,
Gjer sa e pësova dhe flî rash' i ngrati,
Në një llom të thellë, në muzg' e batak !
Psé kërkon t'ap gojën, psé më lëndon plagën,
Plagën e tulitur për se ma skëlfit,
Që më shtyp krabnorët e që kërkon shpagën,
Psè s'më lé ta shqyhenj, kokën ta zgérmit ?

Më gënjeu të mjerin ras' e tij priftnore,
Ras' e tij shêjtë ajo më mashtroj,
Dhe më vrau me vdekjen, vdekjen mê mizore,
Ah, rasën e shkretë kurrë n'e harronj!

Nalt n'atë kështjella t'errët ç' kam pësuar,
Askush s'e kuptovi, mbet si një problem
Por se ju tanithi kini për ta msuar,
Atë që më gjeti sot do t'ju a them.
Tani do dëgjoni si ky na ka vrarë,
Si na shoj urijet, gjall' si na mbuloj,
Djelmt e mij dhe unë si e gjetmë varrë,
Më dëgjoni pákë se ç' do t' ju zbuloj.

Në atë kështjellë, - që "kështjell' urije"
U qojt qysh ahere - ky na pati ndrŷ,
Ku, nga vrim' e vogël një reze shkëndije
Dikur hynte brenda, na binte ndër sŷ.
Prej asajë birruce shumë herë pashë
Hënëzën e zbetë mbushur plotm me ré
Dhe kur më zû gjumi dhe në ëndër rashë
Një tmerr më topiti, më ra një rrufé !
Një brengë të keqe shpirti m' ëndëriti,
Dhe më cfaqi fatin, atë fat te zí,
Që ky i mallkuar né na pregatiti
Pa pikë mëshire, pa një dhemshurí!

Pashë nj' ulk që ikte me klyshat e trembur,
Që ky tradhtor ndiqte me një shpejtësí,
Dhe mundohej tepër si një bish' e çmendur
Ti shtinte të gjith brenda në pusí;
Me genj e langorë shumë të drobitur
Brithte! Pas i vijnin do shoq të këqinj,
GUALAND, LANFRANGË, SISMUND të mërzitur,
Gjakpirës të gjithë pleq edhe të rinj.
Ujqtë mjaft u trembën dhe qent' e dopsuar
Mbi' ta si të marrë turren me furrí,
Copë cop' i bënë ujqit e friksuar
Që s' kishin ai mbrohen brenda n'ati vrî!
U zgjuash me nj' herë – ishte me të gdhirë –
Djelmt' e mij të ngratët që i kisha shoq,
Bukë më kërkonin, qanin, ishin shtrirë,
Mu fik shpirt e zembër, mu zhurrit, mu doq !
Do të jesh prej guri, granit' á mermeri,
Në mos derthsh çurk lotte, në mos qafsh tanì,
Në s'të ngufon vaji, brima edhè tmeri
Ah, mendoje mirë këtë tiraní!...

PËRKTHIMET E PASHKO GJEÇIT

Vetëm një muaj më vonë, i pari që ja doli ta përkthejë të plotë *Komedinë*, Pashko Gjeçi do të botonte sprovën e tij të parë: përkthimin e *Karonti*[25], nën pseudonimin *Surgens*:

KARONTI

PËRMBAJTJA: Tuj nisë udhtimin e vet të mrekullueshëm, Danti me Vergilin hîn në férr e gjinden në trême kû janë mbledhë tucat; kúr mbërrîjnë në brek t'Akreontit vrejnë kalimin e shpìrtnave mbî barkë të Karontit: në nji të perzím të madh të viseve të ferrit, Danti rrxohet i mujtun prej nji rrfejet të papritun e qitet kështû në breg tjetër të lumit.

E qe, po vjen kah na, permbí nji aní,
nji plak, prej mosh's me qyme te sbardhueme,
tue brit' "T mjer't ju per vedi, o shpirten t' kqi!

"Mos t'iu rrejn' shpres't, se shifni mâ qiell t' lume:
eh, erdha 'i tash, të gjith mbi tjetrin ball
m'í u çu, n' zierm, n' akull e n' terrin t' amshueme!

"E ti shka po lyp' ktu, mor nier i gjallë?
Shpejt hiqu shpirtensh, qi jan' dá asaj jetë!"
Por si pau se un po rrijshe tue u tallë

shtoi: "N' tjera udh', limaje ké me gjetë
bregun, jo ktu; per me kalue pertej
duhet qi t' bari ty nji drû ma e letë"

Por per fjal' t'tija Prisi kokerr ndei:
"Karon, ti mos u xéj! Kû âsht fuqija
n'gjithshkâ, kshtu urdhnohet: mos me shtyj ma 'ndej!...

Anitarit te Knetes s' ndyt qetíja
i kthei n' at ftyr' tan' lesh te çueme peshë,
e ka' i ngerdhucte, syt i qitshin shkndija.

Por ata shpirten, qi ishin lodhë e shdeshe,



Kerclluene dhamb't e ndrruen ftyr' tue ngamun,
porsa qi fjal't e randa u ran' nder veshë.

Prindt e vet, Zotin rrijshin, veç, tue namun,
gjinín njerzore mar', vendin, motmotin,
pjellen e t'par' ve e t'mbram've, qi i ka bamun.

Mand u bashkuen' (s' u a pritte lotja lotin
kaq fort po dnes'shin) n' te mbrapshten bregore,
qi pret shpirtin, qi n' bot' nuk dreshti Zotin.

Karonti dreç, me sy si gac' zjarmore,
u ban me gisht e t'gjith me at shej mblidhen:
kuj do t' vonohet i a kris' rem pa ndore.

Sikur n' stin' t' vjeshtes gjetht e veshkun hidhen
njeni mbas tjetri, der sa t mbes' pa gjâ
dega e shdeshun, n' sa gjetht neper tok sillen;

e dobta farë e Adamit n' at mnyr pra
i rraset bregut nji kah nji pa fjalë,
me at shej si zogu i msuem me u thirr' me zâ.

Kshtu shkojn' gjithmon' me aní mbi t'zeshkten valë
e, pa ndesh' bregun tjeter çeta e parë
nji çetç e re fillon tektej me u ndalë.

"O bir i jem," m'tha atbot' msuesi bujar
"Ata mblidhen, qi n'shekull kan' mbarue,
n'mní te Naltit, prandej gjindja e pa farë;

e jan' te gatshem lumnin me kalue,
pse drejtsija hyjnore u grah' pa mshirë,
kshtu qi vet' friga n' nji deshirë â shndrue.

Nji her' me than' nuk bje ksajt shpirt i mirë,
e, n' ke se ka Karonti ankim per ty,
tesh mund t'kuptojsh, ksi fjal'sh pse aj goje xirë.

Rrafshina e errt', mbassi kto fjal' pat kry,
u dridh aq fort, sa kur mendoj at mnderë,
me djerz' t'ftoft' balli endè fillon m' u nyj;

toka me lot e zbrûme lshojti erë,
qi qiti jasht' mandej kuqloshe i dritë,
e cilla ç' do ndjesi m' shojti me 'i herë

e rash' si aj nier q' e kap' gjumi pa pritë.

Edhe poezitë e tjera të përktheyra prej tij...

Një vit më vonë do të botohen edhe tre pjesë të tjera nga *Komedia Hyjnore* përkthyer po prej tij: *Farinata*[26] dhe *Kont Ugolini*[27] nga *Ferri.*

Farinata

Ferr X. vargje 22-93.

Jemi në rrathin e gjashtë, mbrenda mureve t'hekurta të dites, kû vuejnë erezjarket. Rrafehina âsht mushë me vorre të zjarrta, Mbrenda vorreve, nder flakë t' amshueme, ndeshkohen mkatnorët. Danti, në ket kange, flet me dy prej tyre me Farinata-n degli Uberti e Cavaloante Cavaloanti-n. Mbassi Gibelint në 1258 kjenë perzanë prej Firencet, aj (Farinata) theu Guelft rrepsisht në Montaperti (1260) ktheu rishtas n' atme. Me gjithkte, kur në djeten e Empolit pjesa ma a madhe e shokëve të tij dote me shemë Firencen, aj, i vetmi, pat guzimin me u kundershtue ball-haptas. Sa per Cavalcante-in, aj âsht i ati i Guidit, qi ishte poetë e mik i Dante-s.

"O ti Toskan, qi n' per qytet të zjarit,
i gjall' po shkon tue fol' kaq me njerzí,
kí durim pak me u ndal n' ket vend mâ s' parit.

Mir' t' njofta se je, zónin kur t kam ndí,
i atdheut bujar, kû un leva e jetova,
të cillit ndoshta i dhash' dhe shum merzí."

Pa pritas njenit harqeshit ndigjova
tue dal ky zâ; prandej, nji frig, n' mue, ngjallë,
me u struk' mâ fort per prisin t' êm fillova.

Aj, por, m' tha: "Siellu shpejt! a i ke syt n báll ?
Kqyrma 'i her' Farinaten ç'kenka çue :
prej belit e perpjet' ké me e pa gjallë!"

Un majshe syt, tashma, n' sy t' tij ngujue,
e aj kish qit' jashta ball e gjoks, sa pati,
si mos t'a bâte máll at ferr t mallkue.

Me t'padurueshmet duer atbot' ndej gati,
t' më shtyj' tu aj, ndermjet vorrezash, prisi,
tue m' than' kadal' : "Shikjo: fjal't t' uja mati!"

Kur un tu gryka e vorrit kjesh', i a nisi,
si m' pat kqyr' mirë e mir' nji herë, idhnueshem
me m' pvet : "Kush kjen' par't tue e prej ç far' fisi?"

E un, qi ishe me ndigjue i dishrueshem
kurrgjâ s' msheha, por fjalt gjithshka diftuen:
per shkâ aj rrulli vetllat, pak mendueshem,

mandej tha: "idht' dikur keta u coptuen
me mu, me t' par't e mí, me t' imen anë,
sa dy her rresht prej meje u shpurtalluen"

"N' kjen' qitun jashtë, ato kthyn' prej ç'do anë"
i gjegja "n' t dyja her't, n' at koh' t kalueme,
por ket far' harti t' vet s'e paten xanë"

N'kto fjal' n'a duet me t'shpejt prej grop's s'sbulueme,
bri saj, nji hije e kjo fytin s'kalote:
kujtoj se ishte nder dy gjuit e çueme.

M'shikjoi mir' rreth e rreth, sikur t'dishrote
me pa a ndokuah tjeter kishte hy,
por, si u kujtue se ishte nji shpres kote,

tue vajtue, tha: "Ne kje se ti je shty
n' per ket burg t'verbt per mende t'lart e t'kthiellë
po biri i em kû âsht? pse s'erdh me ty?"

E un "Prej vedit ksajt nuk jam tue – u sillë:
aj qi po m' pret, tektej m' ka bâ me dal,
me t cillin Guidi s' pat ag punt per fill."

Mnyra se si ndeshkohej e ato fjalë
rreth emnit t'tij mue menden kishin ndrite,
prandej un i pergjegja atbot' pa u ndalë.

Qitas, veç, u ngreh n'kamb' n'ket mnyr tue britë:
"Si thae: aj pat? po s kênka aj mâ n' jetë?
Njimend s' ia vret mâ syt e âmbla dritë?"

Kur u kujtue se pîtas kishe mbetë,
e po ngurrojshe me i pergjegjun drejtë,
rá n' shpinë e kryt s e çoí tjeter perpjetë.
Por aj shpirt-madhi tjeter njashtu krejtë,
qi kishte mbetë si e lash' hiq ftyr' nuk ndrrojti,
as nuk perkuli shpin' as qaf, por ndrejtë!

"E pse" me' i her', kû kishte mbetë, fillojti,
"ende at hart s'e kan kuptue te mijt :
mâ se ky shtrat, m' mundon, shikjo, m' mundojti.

"Por pesdhet her', po t' thom, nuk ka me qitë
t' ndezten flyr' Hana, qi sundon nder né,
e sa i rand vjen aj hart ti ke me e dijtë.

E persrí shkosh me pá at amblin dhé !)
po m' thuej: pse aq i mbrapshtë aj poplli i jonë
diftohet kundra t' mive n' ç' do ligj' t' ré?"

Prandej un: "Grindja e ploja, n' têmpllin t'onë,
qi Arbjen kuq prej gjaku paten bâ,
i shtyn ato kso far' urat'sh, qi t thonë.

Si pat tund' kryet me t' madhe aj tue fshâ :
"Sa p'r ate s' kjeshë i vetun "m' tha" as sigur
s' kishe lujt' vendi, pa arsy n' dyrnjâ.

"Por un, veç, kjeshë i vetmi n' at vend kur
prej t' gjithve kje pranue me shêm' Florencen,
njaj, qi ball - hapt', per pshtim te saj dha e mur."

[25] Dante Alighieri, "Karonti", marrë nga "Ferri", përkth. Surgens, "Cirka", nr. 22 - 23, 6 qershor 1937, fq.131-132.

[26] Dante Alighieri, "Farinata", marrë nga "Ferri", X, vargjet 22 – 93, përkth.: Surgens, Cirka, nr. 38, 30 janar 1938, f.27-28.

[27] Dante Alighieri, "Konti Ugolini", marrë nga"Ferri", XXXlll. vargjet 1-90, përkth.: Surgens, Cirka, nr.54, 13 nëntor 1938, f. 272-274. (është e njëjta këngë që ka përkthyer edhe K. Floqi.)

***

KONT UGOLINI
KUSHTUE SHOKUT: PAULIN MAMOLIT

FERRË XXXIII v. V. 1 – 90.

Në fundin ferrit, në rrotullakun e dytë vtë rrathit të nandër, trathtarët e atdheut qesin kryet jashta akullit të Koçitit, i katerti lum i ferrit. Në nji lloj vendi Dante shef dy të dnuem, qi rrijnë në nji birë t'akullit: e njâni prej tyne brén egersisht kryet e tjetrit n'arrç të qafës. Poeti ndalet i tmeruem e pyet at të dnuemin mbi psehin e nji mnije kaq shtâzore.

Gojen e shkoqi atbot' prej s'egres gjellë
aj mkatnori, me flok' t'krés tue fshí
t' cillin mbrapa me dham kish' çelun shpellë ;

mandej filloi: "Ti don qi un t'pertrij
at dhim, qi zemren kurr nuk mën t'm' a vrajë,
pa e permendë, jo mâ kúr n'fjalë të hij.

Por n'do t'jet fjala e ime far', qi t'bâajë
m'i a qit' mbrapshtin trathtarit q'jam tue bré
do t'm' shifsh me' i her' tue m'rrjedhun fjalë e vâj.

Un nuk po t'njof as s'di se si nder né
ké mujt' m'u ul' ktu posht', por florentin
po m'duke, me t'vertet', n't'folun se jé.

Pra do t'a dijsh se kjeç Konti Ugolin
e Arçipeshkvi Rugjer ky qi kam para:
pse prûhem kshtu me ket, tesh te po e din.

Se, prej mendimesh s'tija të pambara,
un qi i besojshem kjeç me' i herë burgue,
e mandej mytë, qi e ndîn s'âasht her' e para;

por ate, qi s'ké mujt' kurr me e ndigjue,
do t'ndijsh sa i kobshem kje per mue marimi:
kshtu do t'marrsh vesht se shka m'ka bâ ky mue.

Nji vrimë e shkurt' n'at kull' të ngusht' burgimi,
qi, qysh me mue, e – ûs – me u thirrë i a nisi
(e aty dhe t'tjer' do t'shtijn' me vdek' ngujimi)

N'per hapsí t'saj mâ se nji han' të shndrisi
kish' a, kúr pásh at anderr t'keqe n'gjum,
qi tisin e koh's s'ardhshme krejt ma grisi.

Prîs e t'par n'gjah, ket shifshem tue gjurmuem
ujkun me zogj kah mali, q'i a ka xanë
Luken pizanve, e s'munden me e kundruem

Me shaka t'thata t'dhun' na e t'msueme pranë,
Gualandin me Sismondin vû i kishte
me Lanfrankun e n'báll para i kish' lanë.

Mbas nji vrapi të shkurt', m u duk se ishte
i ati lodhë me t bijt, e, tue i a ndukë
brijt me dham', shifshe mishi ka' u dermishte,

Kúr un u sgjova, drita mir' pa u dukë
ndjeva tue dnes' pergjumshem fmijt nen zâ,
që kish me veti, e tue kerkuemun bukë!

Thom se s'ké shpirt ne mos ndijsh dhim tashmâ
tue sjell' n'per mend ate qe zêmra m' kjate;
e n' mos kjásh tash, per shka jé msue me kjà?

U kish dal' gjumi e koha po n'a u bâte,
shûjten me e prû, per her' si e ki'n detyrë ;
per anderr t vet n' dyshim seicilli u mbâte :

e un ndjeva tue vû goshdat posht' nder dyrë
të tmerrshmes kullë e kqyra si i hutuem,
pa bâmun verb me goj, fmijt e mij n' fyre

Hiq s' kjajshe kaq mbrend ishem i gurzuem;
Ata, por, kjajshin e Anselmini i ngritë
m'tha : ç'ke, bab' qi n'at mnyr' rri tue m'shikjuem.

Me gjithkte s' kjava, e n' asnji mnyrë at' ditë ;
nuk i pergjegja, as at nat' kúr hime,
deri sa dielli s' duel mbi bot' me ndrite.

Si depertoi disi n'per at burg dhime
pak rrezja e diellit, e kjartsisht dallova
nder katër ftyrat edhe ftyren t' ime;

n' dham' prej idhnimit t dyja duert coptova,
e tue mendue ata se prej nevoje
të bukes i shtym aq ashpersisht veprova,

u çuen e than' - seicilli, át, do t' psoje
mâ pak, n' vesh dor' mbi né; ti na dhae 'i herë
ket mloje mishi t' shkret', ti n'a shvesh soje. -

Atbot' pushova mos t' i bâj mâ t'mjerë.
At ditë e t' nesren s' kemi fol mâ gjatë.
Ah, tokë e fort' ; pse nuk u çele humnerë!

Kur zbardhi dita e katert, sa gjan' gjate,
Gaddi nder kamb't e mija m' u shtrî fásh
tue m' than - Shka ké qi s' po m'ndimon, o át? -

«Aty aj vdiq e, si po m' shef, un pash
kah nji kah nji tre fmít e mij tu' u mekë
n' t pesten e t' gjashten dit'; prandej u dhash

"krejt i verbuem me u end' mbi ta tue i prekë.
Dy dit i thirra mbassi ata maruene;
mandej ma fort se dhima ûja m'çoi n'dekë."

Ai heshti, kokërllok't por i u shtremnuene:
t'i a njiti rrashtes n'dham, qi mbrenda i hine
Vrashd' si nji qêni, e, per asht kap' kerclluene.

Ah, ti Piz', faqe e zezë e asaj krahine
t'hishme, atje kû i ndihèt si – hit jona;
mbassi fqijt t'ue kurr me t'ndeshkue s'po vine,

le të dyndet Kapraja dhe Gorgona,
e Arnin tu gryka porsi gardh t'a xanë,
e mos t'lâaj nieri n'ty per koh' mâa t'vona!

Pse n'kje se kish' Kont Ugolini zâ,n
se t'bori disa kshtjella si trathtár
s't'perkitte ty n'at krygj' t'zezt fmi m' i a lânë.

Porsi të ri, moj Thebe e ré, pa farë
faji ishin Ugoçioni dhe Brigata,
e ata dy tjer't, qi janë permend' mâ parë.

PËRKTHIMI I MARK NDOJËS

Ndërkohë, po atë vit, Mark Ndoja, përkthyes i njohur që gjithashtu u mor gjerë e gjatë me *Komedinë* botoi të përkthyer në shqip *Urata e mbrames*[28] nga *Burgatueri*, trajtë e përdorur prej tij për *Purgatorin*. Ky është edhe përkthimi i parë i një kënge të kësaj kantike. Botohet e ndarë në dy numra të gazetës *Sporti Shqiptar*. Në vijim, po paraqesim pjesën e parë:

Urata e mbrames
(Burgatuer, Kangë e VIII)

Isht' tashmâ ora qi iu siell dëshirë
Voztarve e zêmbrën m'përmallim u a prekë
Dita qi miqve t'amb'l u than' lamt'mirë:
E qi të rijn' shtegtá t'dashtnijës thekë
Po t'ndiejë ai s'largu të kumbon's ndoj zâ
Qi giet se po e kjan' ditën qi â tiu dekë:
Kúr un filluesh ndigjimin t'kot' me e bâ
E nji prei shpirtnish t'çuemun me soditë
Qi me i çûe vesht lypte me dor' pá prâ.
Ai të dý duert i çoi e bashk' tu' i njitë
I nguli sŷt ka lindet dielli i rí
Si me i thân' Hyjit: "Për tjetër s'due me ditë".
"*Te lucis ante*" kaq' me pëshpirtní
Prei goje i delte n'tinguj ambëltorë
Sá mue ndër mênd më treti vehtja unjí:
E t'tjer't mandei të butë e përshpirtnorë
Giát hymnit mbar' mbas sì shkuen qetë e qetë
Tu' i pasun sŷt kah rrath't mâ t'nalt qiellorë.
Ktû mpreh sŷt mir', lexues, kah nji e vërtetë,
Sepsè e vërteta tash â e holl' sá s ké,
Qi mbrênd cok me u përshkuemë â punë e letë.
Un atë ushtrí fisnike, mbassi u pré
Kanga, te' nalte e pava tui shikjuemun
Sikúr tui prit' përvûjshëm edhè zbé;
E pásh tui dal' prei s'nalti e posht' tu' u lshuemun
Dý ênjuj me dý shpata majesh s'preme
Qi porsì zjarmi shkojshim tui flakuemun.
Të blerët sikúr gjethlar porsá t'leme
Ki'n veshën, qi me krah' prei nyjeje s'njâjtë
Tu' e rrah' mbas vedi e merrshin n'er' të ndeme.
Pak përmbí né èrdh njêni vênd me xâjtë
E tjetri u dorgj mbí bregun kundërshtár
Kështû qi gjindja mbet në mjes përmbâjtë.
Ndër tà mirë e dallojshem kryet njye ár
Por sŷnit t'ftyrë i bite sì' i terrîinë
Si shises kúr teprín nuk mûnd e bár.
"Të dỳ prei gjîut t'Mariës jan' kah vînë"
Sordeli tha "lugînës me i ndej' roje
Prei gjarpnit qi sá ndora ktû tash mbrrînë".
Kah un, qi s dijshem se për ç'shteg, prej droje
U solla rrotull, e i afruesh sá s'ká,
Krejt i ftohtë akull, besnikes mburoje.
E prap Sordeli: "Tash â kohë me rá
Ndër hije t'mdhaja, e ndonji fjal' me u thanë:
Kan' me u kënaq' sá s e ké bes' tu' u pá".
Veç nja' tre hapa se kjeç' djer' më gjanë,
E u gjeta poshtë, e pásh nji qi m'shikjote
Pá prâ, si se po m'njef t'ishte ka' i danë.
Ishte do koh' q' sé ajri po u errsote
Por jo njaq' sá n'mjes sŷve t' tijë e t'mijë
Mos me u dallue përpara ça pêngote.

PËRKTHIMI I ATË MARK HARAPIT

Pesë vjet më vonë kemi sërish një tjetër përkthim, nga një tjetër përkthyes. Bëhet fjalë për 37 vargje të *O Virgjin Nanë*[29], përkthyer nga Atë Mark Harapi S. J dhe botuar në vitin 1943. Ky përkthim nuk gjendet i pasqyruar te shkrimi "Dante e noi albanesi" i sipërcituar.

"O virgjin Nanë..."
(Dante Alighieri: "Komedija Hyjnore",
Parrîzi, kanga XXXIII, 7 – 37.)

"O virgjin Nanë, e Birit t'and vetë bí,
E pervût e e madhnuet mbî kreatyrë,
Shêj i padám i s'amshuemes pleqní,

Ti jé njajo qi e rrite ket natyrë
T'onen aq fort, sa Kush e ka trajtue
S'perbuzi të marrë prej soje shtat e ftyrë,

Në krahnorin t'and, po, flakë persrí u çue
Njajo dashtní, e cila në pagjë t'amshueme
Bân ket farë drandofillje me lulzue.

Ti jé per né ktû nalt në mbretní të bekueme
Diell i pamêm dashtnije, e n'at shkretí
Jé gurrë uzdaje per robní të mjerueme.

Zojë, ti ké njaq madhní e njaq fuqí
Sa kush do' nderë e tý s't'a lypë, i gián
Atí qi don pa krahë të fluturojë n'ajrí

Mirësija e jote hire e ndimë i dán
Jo veç atí qi të lutë, por dhè sa hera
Atí i del para, qi te ti nuk kján.

Në tý grumbull janë mishriera, dhimba, ndera,
Në tý bujarí, madhní e sa stolí
Qi janë pikë pikë të shperdame në sende tjera.

Tash ky, qi prej kû mblidhet ç'do llomshtí
Ederi ktû, kah nji kah nji ka pá
Si shpirtent kndej e kanë nder kto mbretní

Po të lutet njaq fuqí mirësisht me i dá
Sa të mundet me sŷ të vet atje m'ja spjetë,
Kû shpirti të mbramin fíll të shenjuem e ka.

E un qi kurr s'kjeçë dhanë per të pamun vetë
Mâ fort se due qi të shofë tash ku, po të vê
Lutat e mija të gjitha e thát mbe mbetë

Jo mos i lên; por xier t'a mujë ç'do rê
Qi trupi bân, e kshtû Kenaqunija
E Plotë unjî t'i duket zbluet ndê.

Tý, o Mbretneshë, qi dér kû të duesh fuqija
Të punon, po të lus, mbas kaqe të pám, më rrshitë
Jo mos i lên mâ kurr ndiesít e tija:
Zekthin e zí denjou ti në fashë m'ja qitë."

*

Ky shkrim synon të jetë një itinerar i ndjekur prej përkthyesve për të sjellë në shqip Dante Alighierin, para se ai të vinte i plotë nën përkthimin mjeshtëror të Pashko Gjeçit. Në një moment tjetër do të botojmë edhe një itinerar që fillon pikërisht nga ky moment, pra pikërisht nga botimi i përkthimit të plotë dhe vijon gjer' sot, ditë në të cilat akoma përkthyes të ndyrshëm sprovojnë veten me shqipërimin e Dantes!

[28] Dante Alighieri, "Urata e mbrames", marrë nga "Burgatueri", VIII, përkth.: Mark Ndoja, "Sporti Shqiptar", nr.117, 2 prill 1938, f.5; nr.l19, 16 prill, f.5.

[29] Dante Alighieri, "O virgjin Nanë", "Lajmtari i Zemres s'Jezu Krishtit", 1943, nr. 5, fq. 145 – 147.

NJË PËRPJEKJE PËR TË TRANSKRIPTUAR LIBRIN E RI TË ERVIN HATIBIT

Nga Adrian Zalla

Gjatë muajve të fundit të 2020 na erdhi në treg pas 16 vitesh mungesë, pas 16 vitesh nga vëllimi i fundit një vëllim i ri me poezi nga Ervin Hatibi, një nga zërat më original të pasviteve ´90 por edhe letërsisë bashkëkohore shqipe, vëllimi quhet "Transkript nga krevati tjetër", botim i shtëpisë botuese Onufri, kështu na dha mundësinë të themi lirshëm që 2020 nuk qe tërësisht një vit i humbur e i errët, por solli edhe të reja për tu lavdëruar e falenderuar…

Vëllimi me poezi "Transkript nga krevati tjetër" përmban 40 poezi, duke pasur parasysh stilin, kurimin gjer në detajin më të vogël, por edhe kulturën dhe edukimin e Hatibit mbi shkencat dhe teologjinë islame, numri 40 sipas islamit mund të na çojë në deduksionin e thjeshtë të historisë së profetit Muhamed me kryeëngjëllin Gabriel ku kuptimi i gjithë asaj historie dhe ëndrre të shpjeguar nga profeti, po ta shpjegonim me fjalë të thjeshta është se pas të 40-ave fillon një cikël i ri, një kapitull i ri, ose siç populli do thoshte jeta fillon pas të 40-ave lidhur edhe me besimin islam.

Habi të bën fakti që në besimin e krishterë numri 40 lidhet me disa periudha gjykimi ose dënimi, (Zanafilla 7:4; Ezekieli 29:11, 12.) pra vetëm me numrin e poezive që ai ka vendosur të botojë do kishim mjaft material për të ndërtuar një përpjekje për ta transkriptuar këtë vëllim! Pra kemi një dikotomi mes feve me konotacione krejt të ndryshme, por nuk do ndalemi këtu, ka mjaft thesare për të eksploruar në këtë përmbledhje, për të ngecur në këtë detaj!

Vlen për tu nënvizuar fakti që në këtë përmbledhje nuk ka parathënie, nuk ka pasthënie, nuk ka dedikime, por ka vetëm një titull dhe nis aksioni, njëlloj si ne lindim, na vihet një emër dhe nisim proceset e të rriturit dhe eksplorimit nëse është me vend të ndërtojmë këtë paralelizëm…

Në përpjekje për të transkriptuar poezinë e re të sjellë nga Hatibi, në përmbldhjen "Transkript nga krevati tjetër" kam tentuar të bëj një ndarje poezish e cila është krejt subjektive por që shërben për të analizuar rrafshe të ndryshme të poezisë por edhe tematikave me të cilat përballemi. Ka një grup poezish të cilat vijnë me tituj emrash të përveçëm, ose si figurë konkrete e rëndësishme për jetën e çdo njeriu. Poezitë i bashkon dashuria në thelb, admirimi, dëshira për ti gdhendur në kujtesë që nuk shuhet, dëshira për të rrëfyer të shkuarën e tyre lidhur me të veten. Poezitë janë një përzierje apologjie, elegjie, rrëfimi, kujtese, falenderimi mbushur me imazhe, metafora dhe ndërtime gjendjesh emocionale përkatësisht poezitë: **"Harallamb. P", "M.A.M.A", "E.L.E.N.I", "Në kujtim të Evgjeni Harizit", "Balada e xha Xhihatit"!**

Do veçoja poezinë **"M.A.M.A",** është si një udhëtim në kohë, mbushur me emra konkretë, mbushur me histori, me ngjarje, nga cikle të ndryshme jete, me një krijim universi të lënë në pezull, tregon fakte pa mbajtur qëndrim, pa u shprehur qartë, duke e bërë abiguitetin çelës interpretimi përkatësisht në vargjet: *("Përherë kam besuar te mirësia e të panjohurve/ Përherë ua kam besuar veten të panjohurve/Meqë kam veç një jetë prandaj!")* vazhdon në vargun e fundit të tercinës së katërt *:("Përditë ua kam besuar veten anonimëve")* dhe mbyllet me vargjet me të cilat mbyllet poezia: *(Kështu më kishe lindur, me mirëbesim, pa më ditur më solle/Përherë i kam besuar mirësisë së të panjohurve.)*

Grupi i tjetër i poezive është ai me origjinë gjeografike, ku titujt e poezive janë ngritur mbi emra lokacionesh a vendndodhjesh, disa nga poezitë përmbajnë edhe vite, ky është një tipar tjetër i poezisë së Hatibit ka një piknisje në kohë të caktuar por koha rrjedh e rrjedh dhe nuk përcaktohet se ku përfundon! Poezitë janw një përzierje përsiatjesh poetike kulturash, ndjesish, historish e ngjarjesh të ndryshme, disa më intime se të tjerat e disa më universale se të tjerat përsa i përket rrokjes së tematikave dhe gjuhës së zgjedhur, përkatësisht poezitë: **"Zjarr i madh i Selanikut" , "Golem 1993", "Akaba 1999"** (fshat në verilindje të Palestinës), **"Shqipëria e re", "Tirana e re".**

Grupi i tjetër të cillin kemi grupuar dhe bashkuar janë poezitë me piknisje të historisë botërore dhe asaj shqiptare. Sigurisht kompozitat vijnë ndryshe, të aktualizuara dhe të rifunksionalizuara. Sigurisht në këtë grupim poezish vihet re edhe ndikimi i traditës shqiptare por edhe kulturës së saj. Këto janë poezi thellësisht të angazhuara ku përmes imazheve, sekuencave që ndërpriten e rimerren trajtohen probleme, ngrihen probleme, shfaqet pendesë për mosbërjen më shumë, këto shfaqen në poezitë: "**Kryqëzata e fëmijëve", " Një senat", "Skena nga historia e zbutjes së kalit" "Monogrami".** Ndërkohë në poezitë; **"Veterani i valles së shpatave", "Baladë e gjetur", "Heronj të heshtur"** na vijnë si rivizitim, rizbulim dhe risjellje dhe rikujtim i të shkuarës, me elemente thellësisht shoqërore, por edhe shpirtërore të cilat identifikohen në detaje shumë të holla!

Grupimi i fundit që kemi mbledhur dhe bërë bashkë nga ky vëllim janë poezitë për poetin, artin, metaforën, poezinë, librinë, letërsinë pra origjinën e Hatibit, se Hatibi është poet para së gjithash. Në këtë grup kemi poezitë; **"Radio", "Qafa e poetit", "Fjalët e gjuhës së zjarrtë", "Dora e poetit", "Vdekja e metaforës", "Dora e poetit 2" ("Iu gjetën copa poezie dhe hymnesh"), "Statujat e poetit".**

Poezitë duken se flasin për dhimbje, moskuptim, frikë nga harresa, flasin për evolucion, për ndryshim, për rritje, për ndryshimin e të parit të gjërave ndryshe, flasin për realitetin fatkeq të poetëve, mënyrën sesi adminstrohet e shihet talenti, flet për vetminë, për dramat, sfidat por ka edhe një shpërfaqje ndërtesktorësie të jashtëzakonshme që nga Iliada e Homerit e deri te veprat më bashkëkohore, mbizotërohen nga imazhi, presja është rojatari i rregullit, gjuha është e kuruar edhe pse të jep përshtypjen e pakujdesisë vende-vende.

Këto poezi kanë një rrokje dhe përfshirje rrafshesh dhe universesh nga të gjitha anët, me gjurmë nga çdo fushë njerëzore, reminishenca por edhe gjurmë ndërtekstorësie të rifunksionalizuara, të sjella me një konotacion dhe kompozicon krejt ndryshe nga ato të origjinës.

Vëllimi "Transkript nga krevati tjetër" përmban edhe shumë gjurmë intime, familjare e personale për Hatibin, por edhe për kohën e komunizmit që siç vijon të na vihet shpesh në dukje është një shoqëri e tërë e cila nuk i ka larë ende hesapet me diktaturën e rënë! Poezia " Ekskluzive" e cila mbyll këtë përmbledhje është një dëshmi, britmë, dhe thirrje që e shkuara nuk mund të mbetet e pandëshkuar edhe pse dhimbjen, vuajtjen, dhe memorien asgjë nuk mund ti fshijë…

Në këtë vëllim gjejmë traditë dhe përmbysje të saj plotësisht, në fakt Hatibi është në rrugën për të ndërtuar kanonin e tij të pangatërrueshëm. Gjejmë poezi të ndërtuar me 2-vargësh, 5, 6, 8-vargësh, gjejmë sonetin, gjejmë stilin e baladës popullore shqipe, gjejmë stilin epiko legjendar ala Lahuta e Malcisë, por gjejmë edhe poezi të ndërtuara mbi ritmin ku një fjalë është një varg, gjejmë poezi në formë prozë, gjejmë poezi ku injorohen shenjat e pikësimit dhe vargut, gjejmë poezi të ndërtuara mbi fakte historike pa humbur gjuhën poetike apo melodinë e brendshme, gjejmë një metaforë të thyer dhe të çorientuar por që e bëjnë këtë vëllim një markë origjinale të paimitueshme!

Gjuha është e kultivuar, e bazuar mbi erudicion, ka një lidhje shkak-pasojë e cila mund të përjetohet ose kuptohet vetëm përmes ndjesive dhe imazheve, në poezi të tjera gjuha është ajo e mendimit, shprehëse, deklamuese, ritmi është ruajtës i gjuhës por edhe i kuptimit të poezisë. Figurat e përdorura janë poliedrike, shumkuptimësia, ambiguiteti, errësimi i tipareve të caktuara, apo kalimi nga e prekshmja në të papërceptueshme bëjnë që Hatibi të ketë krijuar një gjuhë personale identifikuese…

Poezia **"Transkript nga krevati tjetër"** është shumë e veçantë nis me një element shumë identifikues, zëvendësimi i th-së me f-në dhe i dh-së me v-në në, fjalët "gjithë, thanë, thashë, thotë, qeth, puth- kthehen me f: gjifë, fanë, fashë, fotë, qef, puf" ndërsa fjalët me dh zëvendësohen me v përkatësisht: "mëdhenj, hedhin, dhëmbë, dheu, hidhu, dhemb, erdhi- kthehen me v mëvenj, hevin, vëmbë, veu, hivu, vemb, ervi".

Kjo është një gjetje e jashtëzakonshme, si nga ana e jashtme e veshjes tingullore, ashtu edhe nga ana e brendshme, simboli kësaj poezie ëështë pafajsia, padija, të mos qenit i ndërgjegjshëm plotësisht për fatin personal, për fatin e të dashurëve të tua apo se çfarë mund të sjellë e ardhmja. Poezia flet për fatet, realitetet e njeriut, transformimin e botës, dhe padijen që kemi përkundrejt këtyre çështjeve, si dhe përpjekjen e vazhdueshme për të kërkuar këto përgjigjie, dhe në fund gëzohemi e lumturohemi me diçka të vogël që zhduket ende pa nisur ta shijosh!

Vëllimi "Transkript nga krevati tjetër" është si përvoja e Ayahuascas (procesi kur një njeri zbraz të gjitha të vërtetat gjysmë i vetdijshëm, ose krejtësisht i pavetëdijshëm). Gjatë eksplorimit të tij, përthithjes së tij, dhe gjatë kalimit të tij në sistemin tënd mendor e shpirtëror duke parë të bardhë mbi të zezë ke pësuar katarsis pa e kuptuar. Shpresoj të ketë qenë një tentativë e suksesshme dhe një përpjekje e arritur me sukses transkripitimi i vëllimit më të ri me poezi të Ervin Hatibit!

Poetja nga Kosova Ervina Halili vjen në këtë bisedë që rrjedh ndër hulli psikologjike, filozofike e letrare për t'u përmbledhur në fund si bisedë mbi poezinë e saj të jashtëzakonshme.

ERVINA HALLI: PROCESIN E SHKRIMIT E SHOH SI ZBULESË TË PO ASAJ KUJTESE QË VEÇSE ËSHTË BRENDA NESH, POR E KEMI HARRUAR

Intervistoi ExLibris

NUK JANË SYTË E MI

Këta dy sy në ballë nuk janë sytë e mi
Njeni asht i hanës dhe nga hana sheh terrin
Tjetri asht i dellit dhe sheh nga dielli dritën

Këta dy sy në ballë nuk janë sytë e mi
Njeni asht nga qumeshti i rrjedhun yjesh
Tjetri asht nga gjaku pulsue mbi eshtna
Vajzë asht njeni dhe andërr sheh peshkun
Para se ta shohë tjetri të notojë në lumë
Tjetri asht Djalë dhe sheh peshkun që noton në lumë

Këta dy sy në ballë nuk janë sytë e mi
Janë dy fetusë langëzue ku kruspull rri Zoti
Dhe sheh fluturën me ngjyra saherë hapen sytë
Drejt rève e mbyllen kah zemra

ExLibris: Ervinë, sytë çfarë janë? Sepse shprehje për to ka shumë, deri në ekzagjerim, ku një pjesë e mirë arrijnë nivelin e mediokres. Ndërsa poezia jote i dimensionon ata në hapësirë, asaj prej vërteti, pra që gjendet përtej shtresave të cilat mbështjellin planetin tonë si dhe në pika gjeografike e historike të llojllojshme. Pra për ty, sytë çfarë janë, brenda poezisë dhe jashtë saj?

E.H: Fillimisht sytë janë optikë magjike prej nga hyn drita dhe jep dy sinjale paralele, njerin tek arsyeja, mendja (sinjalin e gjërave që reflektohen në sy, përceptohen nga ai si imazh, mishërim) dhe tjetrin tek imagjinata, (sinjalin e ndjesisë që ka dhënë reflektimi si kujtesë emocionale). Ne jemi të prirë më shumë të shohim sinjalin e arsyes, mendjes, sepse ai na siguron formën, materien, por ne harrojmë që forma merr kuptimin sepse ne e kemi kujtesën për formën përtej arsyes. E ajo kujtesë trashëguese, ruhet dhe trashëgohet pikërisht në imagjinatën tonë. Gjithçka që aryeja nuk e përcepton si formë, ajo e abstragon, dhe duke e abstraguar, ajo e shkëput, e distancon e veçon nga bota racionale. Në ditët e sotme, këtë abstragim e gjejmë shpesh si trajtim mbi irealen, dhe brenda kësaj mendësie, njeriu e ka shkëputur edhe inteligjencën universale, absolute, edhe çdo gjë të shenjtë nga vetja e tij, por jo edhe nga imagjinata, sepse imagjinata nuk pyet arsyen, ka një shteg tjetër, ka shtegun e zemrës. Zemra si fenomen, proces, jo si organ, mbart me vete kujtesën që mendja e ka harruar, për çdo fotografi liron sinjale të asaj kujtese brenda imagjinatës sonë, sepse nuk i mjafton vetëm forma, po t'i mjaftonte, nuk do të ekzistonte imagjinata. Imagjinata nuk është ndërdija frojdiste, në këtë rast e diskurs tek po flasim, është ajo që nuk ka arritur ta përtypë arsyeja, sepse nuk ka asnjë mjet për këtë përtypje. Arsyeja përtyp formën, edhe çdo gjë që nuk i takon formës, shkon diku tjetër. Por pse me fotografinë?

Fotografia nuk lidhet vetëm me syrin objektiv, ajo lidhet me çdo sy të kujtesës, sepse syri është projektim, çdo qelizë e jona është sy më vete, përderisa ka memorien e saj. Njeriu është projeksion i asaj inteligjence absolute e të tkurrur, që reflekton makrokozmosin në mikrokozmos; Dhe çdo gjë brenda tij, do të duhej të funksiononte po me atë harmoni siç funksionojnë ata dy sy të principeve bazë të lëvizjes së makrokozmosit.

FARË

Lëvozhgën teme e la me u vyshkë e farë me ra në dhè
mbinë dritë dhe lindë ajër n'gjoksin tem plot sy të kthjellët çelin
ujvarat rrjedhshëm rrjedhave rrjedhin në trupin e gjithsecilit
që merr frymë në ngopje ajri
e nxjerr jashtë spërkala jete
e të gjithë më marrin n'gji
e janë fëmijët e mi
e janë nanat e mia
janë babatë e mi

ExLibris: Po procesin krijues, si e sheh? Mendon se e gjitha gjendet brendashkruar teje dhe veç pret të dalë e të shfaqet, apo ndodh diçka që krijon atë çarjen prej ku ngre krye filizi i poezisë?

E.H: Procesin e reflektimit e të shkrimit e shoh si zbulesë të po asaj kujtese që veçse është brenda nesh por e kemi harruar. Në një thellim drejt vetes, drejt imagjinatës (imagjinatës së vërtetë), ajo projekton ndjesinë përmes ngjarjeve, koncepteve, momenteve dhe i përkthen ato në copëza kulture dhe intelekti, heqje pluhuri të gjërave që kanë qëndruar në ty, por nuk i ke parë më herët. Edhe poezia është një projeketim si çdo gjë tjetër, por për dallim nga proza, në rastin tim, ajo nuk mund të kalohet nëpër proces kalkulativ, duhet të dalë drejtpërdrejt nga imagjinata (ajo e vërteta) sepse po e intelektualizuam fillimisht, i kemi dhënë një dimension tjetër.

HARRESË

nji ditë ka me ardhë dhéu me ma lypë trupin mbrapa
e të ushqyem andrrash ka me ia kthye në mitër
nuk e di a ka me mbi pishë në atë dhé a zambak alpesh
veç unë pa trup ka me u kthy te nana
e tek atëherë kanë me m'u kujtue ninullat
    që m'i kanë këndue para se me ma falë kit shtat
    harrese mbi dhé

ExLibris: Kjo poezi përshkon si rreze, me po atë shpejtësi, të dyja shtresat prej qelqi të brendisë: vetëdijen dhe nënvetëdijen që mandej të niset për të fjetë si zgjim brenda në zemër. Si ja del uni lirik të lëviz nga Alfa te Omega, e pastaj, edhe përtej saj, pra arrin deri në përtejomega?

E.H: Nëse uni lirik flet nga imagjinata (ajo imagjinata e vërtetë) nuk ka fillim edhe mbarim, nuk ka as edhe përtej. Nëse uni lirik, siç e quan ti, flet nga një dimension, social, racional, intelektual, kulturor, atëherë, është brenda kufijve të tij me të cilët pavetëdijshëm identifikohet dhe brenda të cilëve do të operojë. Përndryshe, poezinë e çdo uni lirik, e "kufizon" gjuha, e cila nuk është thjesht kulturore. Gjuha del përmes frymës së kulturës edhe pikërisht ky kufi e bën të bukurën e poezisë, sepse gjuha ka një hile magjie poashtu, çdo gjuhë, ka shenjtërinë e saj.

ExLibris: Në një poezi shkruan frikë kishim nga zbrazëtitë/ e zbrazëtia ishte krejt ajo prej të cilës ishim kriju. A ka qenë dhe a mbetet për ty poezia një urë nëpër të cilën kalon sa herë kërkon ta njohësh më mirë veten?

E.H: Do të thoja që mua më ka paraprirë poezia që kam shkruar, ajo është shumë më inteligjente se unë, unë ende nuk e kam arritur atë. Poezia mbetet mësuesja e shpirtit tim, ajo më ka formuar, ajo më ka shkruar mua si njeri, si intelekt. Unë shpesh e kuptoj më vonë veten në poezitë e mia sesa në çastin kur i shkruaj ato. Dhe kur i kthehem në restrospektivë, ato gjithmonë tentojnë të thonë të njejtën gjë, por aftësia ime i ka nxjerrë në trajta të ndryshme, melodi të ndryshme, varësisht nga vendqëndrimi im shpirtëror e intelektual. Ndoshta ato gjithmonë kanë dashur të njejtën gjë përmes meje, edhe nga vetja.

ExLibris: Në vijim të kësaj pyetjeje, kur e shkruan një poezi, ndodh brenda teje një lloj catharsis?

E.H: Kur shkruaj poezi, ndodh fanitje, një zhbërje, një shkrirje e vetes. Un nuk jam më, është veç ajo.

ExLibris: Kur jemi takuar në Shkodër, në librin tënd më bëri përshtypje elementi i dimnave. Atëherë ma shpjegove, por po të pyes sërish: Ç'janë 25, 29, 30, 31... dimna?

E.H: Po, unë për çdo ditëlindje timen, i dhuroj vetes nga një poezi, sepse ngaqë poezia është edhe mësuesja ime, dua që një ditë të takohem me vetat e mia në kohën hapësinore, edhe ta shoh se si është rritur, brenda një bote fragmentare.

ExLibris: Pse ke zgjedhur pikërisht dimnin për ta përshkruar ditëlindjen tënde?

E.H: Po shpesh bjen borë në ditëlindjen time, dhe ne, si shoqëri moderne, ende nuk jemi mësuar që t'i shohim edhe fenomenet e ftohta si diçka të bukura dhe pozitive ose si diçka të domosdoshme për rrumbullakësimin e një cikli, harmonie. Ne, sikur i shohim gjërat të shkëputura, me preferenca dhe të veçuara, nuk arrijmë të shohim që ato ekzistojnë falë disa të tjerave. Ne kështu kemi ndërtuar edhe moralisht botëshikimin tonë, nuk e shohim pamjen e plotë, e ndajmë në copa dhe copëza të tjera. Dimri, vjen mbas një stine të bukur, vjeshtës, e cila, është përgjegjëse për kalbëzimin, vdekjen. Kur të jenë kalbur gjërat që nuk shërbejnë më, dimri i ngrin, fillimisht, pastaj i pastron, e heq kujtesën sipërfaqësore të tyre, edhe e bën tokën gati që ajo t'i jepet lulëzimit. Pra dimri, është pastrimi, përgatitja që të lindet e reja.

ExLibris: Në leximin e poezive tuaja, vërej një humbje të identitetit (me veten teme t'paemën/ që fle zotueshëm n'palëvizje t'përhershme/ lidhmëni), pa ndonjë dëshirë të madhe ta zbulosh apo rizbulosh atë. Në pozitën e unit lirik, ndihesh më rehat si dikush i paemën?

E.H: Ne na vihen emrat vetëm pasi të jemi lindur edhe jemi mish e eshtra dhe identitet psikologjik, e shpesh vetëndërtohemi, ose na ndërtojnë të tjerët. Kështu shpesh e projektojmë veten vetëm sa e kemi kufirin e atij identiteti, duke harruar se gjithçka tjetër rreth nesh edhe brenda nesh është Ne, poashtu. E shumë gjëra kanë ngelur pa emra, fatmirësisht.

Unë dua që subjekti të ngritet në një dimension jashtë material në këtë poezi, ndonëse ajo sillet në vetë strukturën materiale përmes intelektit racional e gjuhës dhe bashkohet me dimensionin psikologjik, i cili dimension e krijon realitetin individual. Të mos kesh emër, nuk është të mos kesh identitet, është të jesh vetëm frymë dhe inteligjencë. Fryma nuk ka identitet material, sepse nuk i duhet. Çdo identitet krijohet kur e përkthejmë njohjen në mendim. Kur atë njohje, nga realiteti ekzistencial e transferojmë në realitet psikologjik, aty ajo përkufizohet, në mënyrë që të mund të komunikohet, të marrë formë, përmes shenjës, simboleve, përngjasimeve. Brenda kufijve tanë njerëzor, (dhe ne jemi ai mikrokozmosi, jo kozmosi vetë) realiteti ekzistencial është i pavarur nga njohja edhe përkufizimi ynë. Kjo nuk do të thotë që ne si njerëz, nuk mund të shkëputemi nga realiteti jonë psikologjik individual dhe të bëhemi një me realitetin ekzistencial duke e ruajtuar brenda realitetin individual. Të bërit një me të, asnjëherë nuk mund të përkthehet në realitet racional, por mund të projektohet edhe përmes tij sepse aktivizon një memorie arketipore që ruhet dhe trashëgohet në ne. Kjo memorie, kur përkthehet në mendim dhe intelektualizohet, përkufizohet edhe merr definicion. Nuk është e tëra, pjesa tjetër abstragohet, ajo që nuk është kuptuar, nga dija konvencionale.

ExLibris: Poezia jote krijon një tablo të memories në përgjithësi, jo veç asaj të fituar nga eksperienca, por edhe asaj që vjen vetvetiu, që gjendet brenda nesh për hir të së shkuarës, brezave... Nga çfarë vjen forca e njeriut për ta zbuluar dhe njohur atë bashkë me gjithë çka ka brendashkruar saj?

E.H: Unë nuk besoj se njeriu lindet tabula rasa, besoj se njeriu lindet i harruar, sepse po ta mendonim njeriun si tabula rasa, do ta përkufizonim tërë kujtesën e tij vetëm në të menduarit e tij dhe mësimin e jashtëm. Këtu njeriu do të tkurrej, do të ngushtohej, do të ishte duke operuar me ligje të veçuara në hapësirë, përderisa ai është zgjatim dhe vazhdimësi e hapësirës, ku çdo gjë operon në harmoni, me të njëjtat ligje. Njeriu vjen me përngjasimin e gjyshit të tij në sy, mamasë së tij në flokë, stërgjyshërve të tij të para shumë shekujve, dhe ky përngjasim nuk është vetëm estetik, as vetëm objektiv, është memorie e gjallë në të, që lëviz gjakun, ujrat, hormonet e tij në atë formë që rregullon shpesh edhe thjerrëzat me të cilat ai sheh. Ne shpesh e reduktojmë sjelljen e njeriut me ato që ai merr nga jashtë dhe brumoset, por harrojmë, që njeriu merr nga jashtë edhe atë që thërret prej brenda, dhe thërret në formë tërësisht organike, i tërë organizmi i tij. Çdo qelizë në trupin e njeriut ka memorie. Njeriu është afër 72% ujë, ujë i cili vetëm qarkullon, për shekuj e shekuj e shekuj, në të gjitha trajtat e tij, ujë i cili ushqen po atë tokë me të cilën ushqehemi, i njëjti ujë, që kemi edhe në gjak, e trup, i njëjti ujë, në placentën e së cilës rri sot një fetus dhe ushqehet për të ardhë, jo ndonjë ujë tjetër, e njëjta memorie molekulare që qarkullon. A mund ta tretësh lëngun?

Të kujtosh, do të thotë ta shohësh veten pjesë të pandashme të krijimit, të harrosh do të thotë ta veçosh veten brenda psikologjisë individuale. Njeriu ka edhe imagjinatë kreative, për t'u thelluar drejt harresës edhe për ta projektuar veten si përkthim besnik i egos. Njeriu nuk është egoja e tij, egoja është vetëm mekanizëm i domosdoshëm i mbijetesës psikologjike njerëzore, që i jep njeriut ndjesinë e pushtetit, por unë e quaj harresë, ndonëse jeton në mendje.

ExLibris: Çka është organike në një poezi?

E.H: Meqë kemi folur për memorien edhe për një lloj imagjinate e cila nuk është imagjinata kreative e mendimit, ose imagjinata psikologjike, organike është çdo gjë e lidhur me natyrën dhe ligjet ose rregullin e harmonisë kozmogonike përmes asaj imagjinate, kur ajo del përmes procesit gjuhësor, mishërohet aty, sepse procesi gjuhësor është proces organik, në tërësinë tonë dhe proces psikologjik në mendimin tonë. Poezia nuk flet vetëm nga copëza jonë e mendimit, ajo flet me tërë memorien e trashëguar që bartë njeriu, deri te memoria e fijes së flokut.

FRYMË

ka qene nji mot kur shpirti nxirrte fjalë e donte me
marrë formë pa nda
tash që fjala m'asht ba shpirt
kam veç frymë qe shkruhet
në zemrën tande

ExLibris: Sikurse Shkrimi i Shenjtë na thotë, Fjala e Perëndisë u bë Njeri nga vullneti i Tij. Po fjala jote, si u bë shpirt?

E.H: Nëse e komunikojmë në këtë diskurs:

Fjala e Perëndisë u bë mish, edhe erdhi të banonte mes nesh, por ai mish mbarti përgjithmonë edhe fjalën e Perëndisë, siç e thashë më lart, ai mish erdhi me memorien. Fjala është kujtesa, për të cilën ne duhet të kujtohemi. Duke qenë se ne identifikohemi me memorien kulturore, sociale, individuale, të reduaktuar kryesisht në mendim, kjo memorie e kësaj fjale, që rri në çdo cep të trupit e frymës sonë, nuk ka hapësirë të zgjerohet. Kur ne e shkrijmë trupin, nuk identifikohemi me të, për një çast, ne bëhemi një me atë memorie, me atë fjalë. Do ta quaja kthim të dytë. Duke qenë se kjo memorie nuk erdhi me racion, ajo nuk mund të kujtohet duke u menduar, ajo ka një shteg tjetër të kujtesës. E ka udhën e saj. Poezia i afrohet deri diku shtegut.

ExLibris: Studiuesit, por edhe lexuesit e angazhuar në poezinë tënde vërejnë atë elementin femëror, por ka edhe prej atyre, si për shembull Suzan Finger sipas së cilës, poezia jote nuk ka gjini. Ti vetë, si e sheh? Mendon se gjinorja dhe agjinorja vijnë për shkak të gjendjes, janë fryt i një rrugëtimi të poezisë...? Nuk e di, ti vetë si e mendon?

E.H: Për mua ka një dallim në mes të gjinores dhe principit (fenomenologjisë) mashkullor dhe femëror. Çdo gjë në natyrë, në univers, në gjënë më të vogël të krijuar, në çdo organizëm, në çdo mikroorganizëm, ka dy principe dualiste bazë, mashkullor dhe femëror. Edhe ne, pa marrë parasysh se çfarë gjinie përfaqësojmë, duke qenë se jemi manifestim i po asaj kokrre rëre, i po atij kozmosi, i kemi të dyja principet më vete, përveç se kemi memorie të lashtë të trashëguar në trupin tonë, janë vetë hormonet tona, struktura jonë e trupit, baza e dy principeve në harmoni. Sipas traditave më të lashta që më vijnë ndërmend, principi mashkullor (jo mashkulli), kozmogonik, është mishërimi, do të thotë manifestimi, dhe, më herët e parafrazove, "fjala u bë njeri", që do të thotë, është njeriu, ndërsa principi femëror, është fjala që u bë njeri. Por ka prirje të keqkuptohet po ta lë me kaq, po e shpjegoj brenda një tradite tjetër. Në traditën hinduse, principi mashkullor është Shiva ndërsa principi femëror është Shakti (energjia, forca).

Shiva, si manifestim, konsiderohet si mësuesi i parë i njeriut, (adiyogi), porse Shiva ishte vetëm princip mashkullor para se të bëhej mësuesi. Shiva si mësues, është bashkë edhe princip mashkullor edhe princip femëror. Gjysma e tij është mashkull gjysma femër. Për t'u bërë Shiva Adiyogi, (mësuesi i parë i njeriut) i përndrituri, Inasni Kamil, ai u desh të bashkohej me Shaktin. Bashkimi i tyre e bëri njeriun perfekt, ai nuk ka gjini sepse është princip i unisuar, i harmonizuar brenda dy gjinive të kundërta.

Unë nuk jam adiyogi, njeriu perfekt apo mbinjeriu, jam vetëm njeriu, edhe shkruaj nga perspektiva ime njerëzore. Aspak nuk mund ta di sesi dalin me saktësi poezitë e mia, edhe si shpërfaqen te lexuesi. Por ne flasim për poezinë më shumë kur nuk flasim për të, kur e lëmë pozinë të jetë ajo që doli, e pastër nga imagjinata jonë, kur ne ishim jashtë dimensionit tonë të mendjes.

Njëjtë, ne flasim më shumë për gjininë kur nuk flasim për të, kur e lëmë të lirë të jetojë, siç jeton në çdo gjë përreth nesh. Nuk ka ndodhur ashtu, fatkeqësisht, sepse njeriu është harrestar dhe e ka lënduar këtë pjesë të harmonisë e cila do të duhej të projektohej kudo, edhe në shoqëri. Temë e gjerë, do ta vazhdojmë këtë, specifikisht një herë tjetër.

ExLibris: Andrra është një motiv i përsëritur, si dëshirë por edhe si gjendje. Mendon se ekziston ndonjë andërr – dëshirë, kthimi i së cilës në gjendje kishte me të frikësu?

E.H: Ashtu siç jam unë projektim, zgjatim i çdo gjëje që më rrethon, edhe andrra po ashtu është manifestim që mishërohet në mua. Nëse unë edhe çdo gjë që projektohet në mua, jemi në harmoni, ne vetëm do të vallëzojmë, edhe nuk di a ka dikush frikë nga vallëzimi? Po që se nuk jam në harmoni me qendrën prej nga jam zgjatuar dhe me çdo gjë që është zgjatuar nga unë, andrrat e mia do të më trishtojnë, e këtu, përsëri ato do të jenë mësuesit e mi të ashpër – i mirëpres.

Shënime mbi librin "Trup e shpirt" të Timo Fllokos

POEZI E NDJENJAVE INTIME TË NJERIUT

Nga Ali Aliu

Timo Flloko vjen si një krijues me formim letrar, kulturor dhe përvojë të gjatë jetësore, që, të gjitha së bashku, janë sa barrë e rëndë aq edhe favor lehtësues në krijimtarinë artistike, veçmas në poezinë lirike, me këtë rast, arrin të krijojë distancim ekuilibrues ndaj dy ngasjeve.

Në librin e tij "Trup e shpirt", autori është në kërkim të shkathët drejt balancimit mes dy boshteve tematike, atij intim dhe atij persiatës nëpër rrjedhat e përditshme të botës. Kjo qasje, kjo lëndë, ky përjetim dhe këndvështrim i autorit na sjell një libër të qëndrueshëm dhe unik... Më të realizuara artistikisht janë poezitë e shtratit të parë, siç është poezia 'Sytë':

Sytë shohin, shihen, fshehin, fshihen.
Sytë ikin, largohen, sytë mërgohen.

Sytë ndrijnë, qeshin, ndizen, ndezin.
Sytë dashurojnë, dashurohen, sytë
verbohen.

Sytë lotojnë, pikëllojnë, harrohen, harrojnë.
Sytë ftohen e s'flasin, sytë vrasin.

Apo poezia tjetër, 'Në ardhsh':



Nëse ndodh me trup të mos vish,
bëhu e padukshme
dhe eja
si frymë, si hije.

Po ashtu, në të njëjtën trajektore, si poezi të ndjenjave intime të njeriut, të cilat autori i sjell të hapura dhe të drejtpërdrejta, vjen edhe poezia 'Mbi urën e Bruklinit':

Kam mall... Eh, ç'mall ta dish!
Ç'mrekulli kur shoh në park,
Se si zogjtë në arrati,
Marrin sytë e mi për larg.
...
Mister dashuria, fshehtësi,
Një rebus i përhershëm mbetet,
Që braktis, për ty jep edhe jetën,
Ajo që lakmon, tjetrit i jepet.

Ndërsa tundimet dhe sfidat e përshkojnë në tërësi librin, tek personalet ato janë më të mprehta. Te vargjet e poezisë 'Dyshimi', urtia elegante e zërit ecën tehut e duket sikur vihet, pro dhe kundër, bukuria e gruas dhe e burrit që magjeps e pushton këtë bukuri. Me një qetësi konstante e mbyll në fund me vargjet:

Një fjalë e pathënë më mbet në fyt,
Si kafshim i Mollës së Adamit.

Tek poezitë e shtratit real-përditshmëri - absurditete, etj. si tek 'Estetika', poeti sjell të tjera tundime, teksa hedh në diskutim, bukuri artificiale apo natyrale? Duket i hapur, kur thotë që, atë që e ka ndëshkuar zoti me shëmti fizike (të pamjes), pse të mos ketë të drejtë të ndjehet i bukur dhe i lumtur... Pra, një ide a mendim që gabimet e tilla të zotit mund t'i përmirësojë njeriu dhe kjo do të ishte fare normale.

Atë çfarë *Zoti e krijoi të mangët,*

Mjekësia estetike e kthen shpejt në hir,
Rilind krijesa me pamjen e ndryshuar,
Shndërrohet defekti në përsosmëri.

Ithtarë të natyrës klithin: Herezi!
Por shëmtimit, si djallit, i ikin me të katra,
I mallkojnë ndërhyrjet në trup e fytyrë,
Ndonëse e vuajnë dramën që u sjell plakja.

Rebelim ndaj natyrës, thërrasin, sakrilegj,
Por atë që vuan e çliron *ky ndryshim,*
Ia fshin përjetë ndjesinë e përuljes,
Që Krijuesi ia la mbi shpinë si mallkim.

Ky tis përsiatës që i përshkon vargjet e këtij libri poetik, e bën autorin të veçantë dhe tërheqës. Duke e lexuar, sidomos poemat në fund të librit, të cilat mbajnë peshën kryesore të tij, do të thosha, krijohet perceptimi mbi mendimin, shpirtin, botën, këndvështrimin ndjenjat, tërë botëkuptimin dhe formimin e këtij artisti të njohur në jetën kulturore të shqiptarëve.

Vëmendjen e lexuesit e marrin edhe poezi të tipit 'Rob i manive', 'Transgresion', 'Ceni i Davidit', poezi të cilat nuk të lejojnë të lexohen si rutinë, porse të mbeten në mendje pas përfundimit të leximit, sepse janë gjetje interesante.

Për ta mbyllur, poezitë e këtij libri, nuk i përkasin fondit të poezive që të vënë në mendime për të zbuluar çfarë fshihet ndër rreshta, këto poezi janë të tejdukshme dhe vijnë si rrjedhojë e çasteve, përjetimeve. Ato janë ndërtuar si një panoramë e hapur, si një fushë e gjelbëruar që na shpaloset para syve dhe çdo gjë që është duket...

Në 77 vjetorin e lindjes së Musa Ramadanit

RINGJALLJA E KAFKËS

(Musa RAMADANI: *Profeti nga Praga, Mapo, Tiranë, 2017)*

Nga Gentiana SOFTOLLI

Autori

Musa Ramadani (1941-2020), shkrimtar, gazetar e redaktor në gazetën Rilindja, shkollimin e lartë e mbaroi në Prizren, Dega Gjuhë dhe Letërsi shqipe. Kishte shpirt artisti dhe përveç krijimtarisë së tij letrare, ai e kishte sfiduar veten edhe në tekste muzikore, konkretisht në zhanrin e muzikës së lehtë. Është marrë po ashtu edhe me pikturë dhe me kritikë teatrore.. Musa Ramadani pas vetes la një krijimtari të pasur letrare, në prozë, poezi dhe dramë. Disa nga krijimet e tij janë: *"Romani pa Kornizë"*, prozë (1975, *"Fluroma"*, tregime, (1978), *"Zezona"*, roman, (1978), *"Ligatina"*, roman (1983), *"Satana ma vodhi gurin e urtisë"*, tregime (1987), *"Vrapuesja e Prizrenit"*, roman, 1995, *"Antiprocesioni" (*1997),*"Inamor: 55"*, minitregime (2000). Ndërsa, prej librave poetikë vecojmë *"Mëkatet e Adamit"* (1969), *"Neurosis" (*1973), *"Mëkatët e E(ha)vës"*, 2006. Ramadani, në mes të tjerave ka përkthyer "Bufi i verbër" të Sadek Hedajatit dhe "*Dhe nuk gjeje vëlla më të mirë"* të Maksud Ibrahimbekov. Ka qenë laureat i një sërë çmimesh vlen të përmendim këtu Çmimin "Kadare" për romanin "Profeti nga Praga" 2017.

1. Romani

Romani "Profeti nga Praga" i Musa Ramadanit trajton rikthimin apo ringjalljen hipotetike të shkrimtarit Franz Kafka, në qytetin e tij të lindjes, Pragë. Romani është ndërtuar në trajtë fiksioni i mbështetur jo pak te faktet, ndaj edhe ndërthurja e ngjarjeve dhe loja me kohën dhe personazhet arsyetohen plotësisht. Kafka rikthehet në Pragën e tij pas plot 41 vjetësh, që kur kishte ikur nga kjo botë dhe përmes 14 njësive rrëfimore, autori e shpie Franzin në vende dhe situata të ndryshme, pikërisht si një profet i cili kthehet për të përfunduar misionin e tij të lënë përgjysmë. Përzgjedhja e këtyre vendeve në të cilat zhvillohet fabula dhe storjet janë tipike për personazhin real,vende këto të cilat mund të supozojmë se Kafka ka ende punë për të bërë.



2. Funksioni i fiksionit

Musa Ramadani në romanin e tij "Profeti nga Praga", edhe përkundër faktit se te lexuesi sjell një rrëfim fiksional hipotetik, ai ndjek një rregull sa i përket shtjellimit të situatës, nismës së rrëfimit, shpalosjes së fakteve, përshkrimit të vendeve dhe strukturimit të romanit. Personazhin kryesor, Kafkën që në hapje na e prezanton dhe na informon për çdo imtësi rreth tij, madje rrëfimin e fillon edhe në trajtë paralajmërimi "Nëse dikund e shihni dhe identifikoni si F.Kafka, luteni të lajmëroni në telefonin me nr. 0123456789", për anonimin gjenial.

Struktura rrëfimore e romanit ngrihet mbi një narrativë retrospektive, ku autori në këtë rast lëviz në kohë dhe hapësirë, me shtrirje të pakufizuar, çka mundëson kështu sintetizimin e jetës reale me atë fiksionale

"Profeti nga Praga" rrëfehet në dy rrafshe, mirëpo që janë të sinkronizuar me njëri-tjetrin; në njërën anë kemi fakte të vërteta nga jeta e Kafkës, ndërsa në anën tjetër kemi fakte mistike, metafizike dhe fiksionale. Madje, dy kaptina janë plotësisht të shkruara nga Kafka, çka e ka plotësuar edhe më shumë misionin e tij të ringjalljes si profet.

Përveç anës fiksionale dhe shtjellimit të ndërthurur, në roman kemi edhe një parakaptinë dhe një paskaptinë si lloj informatorësh hapës dhe përmbyllës të rrëfimit. Për dallim nga romanet tjera, kur si subjekt trajtimi janë ngjarje ose tema me interes të gjerë, ku fundi lihet pezull ose u ofrohet mundësia lexuesve që fundin ta projektojnë vetë, romani "Profeti nga Praga" ka fillimin dhe fundin të hartuar në formë të tillë si një jetë të tërë kushtuar një misioni dhe pasi misioni përfundon, atëherë përfundon edhe jeta e personazhit.

3. Gjuha

Ramadani është cilësuar shumë herë edhe si shkrimtar me leksik dhe shprehje të zgjedhura me një përpikmëri në përdorimin e sintaksës shqipe. Te romani "Profeti nga Praga" shohim po ashtu edhe një përdorim tejet të kujdesshëm të fjalëve të vjetra shqipe. Përdorimi i shprehjeve apo fjalëve të vjetra shqipe, jo vetëm që e pasurojnë diskursin letrar, por edhe e bëjnë më bindës rrëfimin dhe e ofrojnë lexuesin edhe më shumë me personazhin çka i mundëson që ngjarjet brenda romanit t'i përjetojnë më thellësisht. Edhe pse për nga kategoria cilësohet si roman, përveç rrëfimit dhe përshkrimit, në vete përmban edhe dialogë të shpeshtë si shenja dramatike, aty-këtu hasim edhe monologë, si informues rreth biografisë së personazhit kryesor. Teksti është i ndërtuar si lloj miksimi, një intertekstualitet të veçantë, meqë përveç pjesës fabulare fiksionale, autori në roman ka futur edhe tekste të vetë Kafkas.

Romanin e tij Ramadani e titullon si "Profeti nga Praga" duke e krahasuar kështu Kafkën me Mesian e shenjtë, mirëpo kësaj radhe Kafka na vjen me një tjetër mision, përveçse për vetëdijesim letrar, në një farë forme vjen edhe për të shuar mallin për vendet e tij si dhe për të qëruar hesapet me mikun e tij, Max Brod-in, i cili nuk iu përmbajt testamentit për t'i djegur të gjitha dorëshkrimet.

4. Procesi Kafkian

Kafka përveç në rolin e personazhit në roman na paraqitet edhe në rolin e narratorit, duke rrëfyer përshkruar e dialoguar me personazhe të tjera në vende të ndryshme, emrat e të cilëve janë ruajtur për aq kohë sa iu është referuar autori. Kafka vihet përballë situatash të ndryshme, të cilat shpeshherë janë në kontradiktë me njëra-tjetrën, p.sh. kemi rastin kur Kafka ndeshet me birin e tij apo edhe rrëfimi për "Sokakun liliputan, alkimistët".

Personazhi Kafka rikthehet në Pragë për të na dëshmuar edhe një herë relacionet e tij, të cilat mund t'i klasifikojmë apo shohim nga tri perspektiva; Kafka në raport me familjen, Kafka si prezantues i autobiografisë së tij (në suaza të ngushta) dhe Kafka në raport me letërsinë (qëndrimi i tij ndaj krijimeve letrare të të tjerëve dhe ndaj botimit të krijimeve të tij).

Përballja e personazhit kryesor me personazhe të tjera është e monitoruar gjithë kohës nga Ramadani. Në agjendën e tij, autori ka rezervuar një numër të madh takimesh me personazhe të tjera, që bëjnë pjesë në këtë roman e ku ndër ta janë miku i tij Max Brod, mikesha e dikurshme, Jelena, Kafka i ri si dhe personazhe mistike. Ballafaqimi me ta, përveç në formë mallëngjimi, na vjen edhe në trajtë diskutimi apo kërkim llogarie për sa i përket ndodhive, pasi që Frnazi u largua nga kjo botë. Diskutimet dhe dialogimet që pikasin janë ato me Max Brodin, ku diskutohet rreth publikimit të veprave, radhitjes së kapitujve, sidomos për "Procesin" dhe tema të tjera, pa e lënë anash edhe takimin me Kafkën e ri, i cili supozohet të jetë i biri i vetë Kafkës. Përtej dilemave të cilat Ramadani ka trajtuar në romanin e tij për Kafkën, pjesë tërheqëse dhe interesante është padyshim edhe "Një natë në dhomën e Kafkës në Kierling", ku përshkruan qëndrimin e tij në shtëpinë e Kafkës, respektivisht fjetjen në dhomën e tij; halucinacionet, errësira, emocioni dhe përvoja sa mistike aq edhe sfiduese janë brum i këtij romani.

Përfundim

Me anë të admirimit dhe dashamirësisë që ka për Kafkën, Ramadani na ka lënë një roman me fiksion të pastër të ndërthurur mjeshtërisht me faktin real. Kafka do të mbetet përherë një vetmitar i heshtur, i përmbajtur, por Musa Ramadani shkrimtar unik, i cili ka arritur të na e ringjallë edhe një herë në trajtë fiksioni shkrimtarin më të madh të letërsisë moderne evropiane.

(Autorja është studente e vitit të dytë në Fakultetin e Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe)

Versioni që solli Driada Dervishi me teatrin "Aleksandër Moisiu" ishte vezullues, kishte dritë.

BURRA-GRA: EDHE DUHEM, EDHE GRINDEM!...

Nga Josif Papagjoni

Durrës. Mbrëmje… Në amfiteatrin antik të qytetit më në fund do të sfidohej "vdekja" e teatrit. Teatri dilte nga lëngata e gjatë, letargjia e Covid 19. Teatri do të fliste para publikut të tij të munguar. Dhe zgjodhi një fjalë të bukur, tre shaka të mirënjohura të Çehovit, komeditë e tij një aktshe: "Martesa", "Tragjik pa dashje", "Propozimi", "Ariu". E kush nuk e ka fantazuar veten në njërin nga ata role plot sharm, karaktere të vizatuara në imtësi, duke rrugëtuar shpirtit rus dhe jo vetëm, përmes mendjes brilante të gjeniut të padiskutueshëm të dramës. Ja, ulur në karrige mbi barin e kositur, mbi kokën time dhe spektatorëve fëshfëriti një cohë e bardhë. Ishte një fustan i stërmadh që na mbuloi, fustani i nusërisë. E kush nuk e kujton dasmën e vet, nusen e vet. Ajo fëshfërimë cohe mbi kokat tona ishte malli dhe nostalgjia jonë. E të gjithëve ne në këtë rruzull. Qysh këtu instinkti im prej kritiku, në rrëzë të veshit më tha: Ka diçka të bardhë kjo shfaqje! Është gëzimi dhe çasti i mrekullueshëm i dasmës, mbushur plot ekstazë e lumturi, një gjetje e bukur regjisoriale. Ejani këtu sipër te ky shtrat martesor i bardhë dhe i madh, sikur na thoshnin aktorët; ejani dhe të gëzojmë së bashku mes haresë dhe grindjeve si prej budallenjsh mes burrit dhe gruas; dashuria, dhe ai, shtrati martesor, janë aty përballë nesh: lumturia dhe "sherri" ynë.

Versioni që solli Driada Dervishi me teatrin "Aleksandër Moisiu" ishte vezullues, kishte dritë. Në ato tri fate njerëzish te tri komeditë e bëra bashkë në një shfaqje, duke qeshur ne edhe pështpërisnim me vete: Ç'është dashuria vallë, lumturi apo fatalitet, rastësi apo e parashkruar, kënaqësi e epërme apo detyrim cinik, liri apo skllavëri? Unë shqova te kjo shfaqje diçka nga të menduarit e rusit të jashtëzakonshëm, Anton Pavloviç Çehovit; diçka si nga

fotografitë antropologjike zakonore ruse, por që fluturonte qiejve si zog i lirë e na cekte të gjithëve me bishtin e tij duke na çuar hapësirave universale të natyrës njerëzore si të tillë, një hapësire tjetërsoj, që ngjyhet me pak ironi e shaka për çdo rishtar të këtij riti madhështor të përtëritjes dionisiane, kur shushurima e gjakut në zemrën e gjithkujt shkon e vjen nga "Kënga e Këngëve" të Solomonit me ekstazat e fillimit, te pjesa e "grindjes", e keqkuptimit, shpesh e rëndomtësisë, e banalitetit apo e vrazhdësisë së saj rrugës së vetëkonsumimit dhe shndërrimit të pamëshirshëm të dashurisë në rit. Epo ja që jeta e tillë është!…

A është vallë dashuria një "gënjeshtër e bukur", një kular në qafë që ti vetë e vë dhe e pranon, thuajse në delirin dhe situatën sublime të shikimit dhe puthjes së parë, e mëpastaj ja ku na shndërrohesh, o qyqar, në një "kalë karroce" tërë jetën tënde duke tërhequr si në kalvarin biblik peshën e rëndë të "kryqit" sfilitës: familjen, gruan, fëmijët, rropatjen nëpër hallet e shumta, mbijetesën? Gjithë këtë "transformim" të dashnorit të dikurshëm në burrin e sotëm nën zgjedhë e picir na i dha me lojën e tij plot hir komik dhe energji Gentian Zeneli. Shfaqja e Durrësit, por dhe ky aktor, nën një stil të unifikuar e plot ritëm, më grishën bash tek ideja se dashuria vetë, teksa ia heqim paksa cipën e lëbyrjes nga vetëtima e shikimit të parë kur zilka e zemrës tringëllin si e harbuar, e kthen befasisht fytyrën nga e kundërta e vet, dhe prandaj ti sheh një pamje tashmë edhe më të tërbuar se e para, por ndryshe, gjithë kapriço, inate, mëri të kota, kokëngjeshje, idjotësi, gjersa ajo kthehet sërish në vendin ku ka nisur e ka buisur së pari: te syri i bukur, te loti i ëmbël, te puthja, te kurora, te devocioni, te mrekullia.

Sikurse thashë, ka një logjikë në bashkimin e katër pjesëve të Çehovit: **Dashuria**. Por jemi në komedi. Andaj dhe meshkuj e femra, veshur me stilin e shekullit XIX por të modifikuar me kujdes, regjisorja sikur na shpie në një ballo maskash, por ku fshihen fytyra macesh e maçokësh që gricen me thonj me njëri-tjetrin (maska e bardhë në fytyrën e çdo aktori dhe aktoreje të çonte vetiu atje). Dhe vërtet, dashuria a s'është njëherazi edhe një vals i bukur, një serenadë me kitarë teksa "karroca" e jetës ecën e ecën e në fund na çon në strehën tonë, te burri apo gruaja jonë, te fëmijët tanë, qoftë një apo shtatë vajza dhe, nga ana tjetër, a s'është po aq dashuria edhe një kacafytje egosh, inatesh, personalitetesh, kush është i pari e kush i dyti, jo të thashë e jo më the, pra një idjotësi e "bukur", thënë ndryshe një shaka kur syri i Zotit na sheh nga sipër dhe kënaqet duke qeshur me budallallëqet tona. E gjithë kjo koreografi ndjenjash e shprehish të kundërta midis vajzës dhe djalit, midis karaktereve të kundërt në marrëdhënien dashurore, që grinden dhe duhen njëherësh mbetur në kurthin e saj, si të gjithë në këtë dynja, vjen me role të interpretuara me sharm nga aktorët durrsakë

Thashë se stili i trajtimit të shfaqjes ishte unik. E vura re jo thjesht te veshja e hijshme, tek ato shishet e kuqe të verës dioniziane me të cilat luhej në konotacione të ndryshme, te mënyra e shpërfaqjes së personazheve në secilin aktor duke ruajtur ritmin komik dhe duke e rrethuar gjithçka me praninë gazmore të tyre; e vura re tek ai amalgim i pjesëve të shkurtra të ofruara si një e tërë e ndërlidhur dhe harmonike, me burrat dhe gratë bashkuar tanimë në një kor, si sfond interaktiv, si bashkëbisedues e bashkëpjesëmarrës në ngjarje e në konflikt, më në fund si një grup ritualistik që merr pjesë në aktin e përjetshëm e të riciklueshëm të dashurisë. Janë po ata, herë si protagonistë e personazhe në veprim e herë si "kor" dhe sfond bashkëshoqërues. Shfaqja qe ndërtuar pikërisht si e tilla: një dasmë a një ballo, ku të gjithë jemi të përfshirë e të gjithë duhet t'i bishtnojmë "fotografisë", duke qenë pra "veprues" në skenë…

Diku shfaqja lëshon më shumë dritë, ka më shumë përkryerje në stilin e vet, më shumë energji, bukuri, spontaneitet, më shumë humor, origjinalitet. Për mua ajo pati një emër, Ivan Vasiljeviç Llomov. Ky rol më dha gati-gati kënaqësinë e një zbulimi: ishte Amos Zaharia. Unë e kam parë në disa role, në teatër dhe në ekran, dhe vë re se ai ka lëvizur në plane të ndryshme interpretative, ka ndjeshmëri e përjetim, ka ritëm dhe energji, është i natyrshëm dhe, kur qëllon mirë, sjell madje karaktere njerëzish të veçantë në një vetjakësi psikofizike të lëvduar, siç qe edhe roli i Llomovit. Ai vrujonte i tëri dhe kishte ujdisur për bukuri plastikën tejet shprehëse dhe komike me të folurën e shpejtuar (një farë llafazanërie pa të keq, që shndërrohej lirisht në një vetëtallje të këmbënguljes së tij gjer dhe për nofullën e një qeni). Sa shumë shije i kishte dhënë plastikës me atë hapin kinse ushtarak, këmbëngulës, por aq qesharak; ato spërdredhje këmbësh, ajo rrokopujë gjestesh e përzier me rrokopujën e të folurit. Ani pse gjithçka dukej si "rrokopujë", në fakt gjithçka ishte nën vëmendjen e aktorit, tashmë si instrument dhe administrator i krijimit të vet, i psikofizikës së vet. Për një përkryerje edhe më të madhe, kur ai flet shpejt, si altoparlant i prishur, lipset që fjala, sado në ritëm e nxit, të mos humbë asnjë rrokje por të vijë në veshin tonë e plotë.

Bashkangjitur me Amos Zaharinë, solli një lojë të shkathët e me humor partneria e tij, Adelina Muça, në rolin e Natalia Stepanovnës. Një aktore fizikisht e hijshme dhe e bukur në skenë, në disa role që kam parë prej saj Adelina duket se po bëhet gjithnjë e më zotëruese e dhuntive të pjekura. Luajti natyrshëm me kokëfortësinë e personazhit, sikurse me hokat dhe ojnat e femrës, një farë vulgariteti, sidomos duke e kthyer në një rit komik nazen femërore tunduese të zërit. Pjesa e tretë, "Ariu", ishte e këndshme dhe tërhoqi vëmendje. Vijmë për të kërkuar një borxh dhe mbetemi borxhi i tjetrit, borxhi i dashurisë. Edhe këtu po njësoj veprohet, ajo që kundërshtohet me plot zë kthehet në pretekstin e asaj që pranohet nën zë. Edhe këtu fustani i nusërisë ka fuqinë dhe magjinë që ta flak tutje perden e zisë, duke u tallur me fosilet e kujtimeve tona ngulitur në një fotografi diku në kornizë. Është Zhejni Fama si "Ariu" dhe Mimoza Marjanaku si vejusha që e sjellin mirë idenë se jeta të fton drejt dashurisë, andaj dhe vdekja duhet të zmbrapset. Dhe kur dashuria e kris xhamin e kornizës së vdekjes, e zakonit të zisë, e detyrimit dhe nostalgjisë, atëherë vëmë re se lulet nuk janë tharë, se zogjtë ende cicërojnë, se jeta është gjithëpo e bukur. E vrazhda bëhet e butë dhe vulgarja poetike. Këtë transformim të çuditshëm solli me lojën e tij aktori Zhejni Fama, por edhe Mimoza Marjanaku me kokëkrisjen e rolit të saj; jo aq vrazhdësia fizike dhe ajo e sjelljes se sa një lojë e "ëmbël" me komiken, me befasitë, sidomos me kthesat e papritura ishin ato më të pëlqyeshmet në lojën e tyre. Ja që të kundërtat e papajtueshme, në sy të parë kurrë e asnjëherë të zgjidhshme, zgjidhen fët e fët në fund me një propozim a një puthje, sepse dashuria vetë e ka këtë forcë të jashtëzakonshme: të pamundurën e bën të mundur.

Aktorët e Durrësit, ata që i përmendëm dhe të tjerët si Andia Xhunga (Gavrilova), Suela Bako (Martinova), Gjergji Doçi (Çubukov), Alesia Xhemalaj (Dashenjka), Jaho Guma (Apllo;bov), posaçërisht pastërtia e vizionit regjisorial të Driada Dervishit, i merituan duartrokitjet e zgjatura të shfaqjes së tyre me sqimë.

ROMANI I RI I MIRA MEKSIT

KUTIA E AGATHA CHRISTIE-T

Shpëtim Doda

Tashmë është kthyer në diçka proverbiale që, përpara se të hapë kopertinën e një libri të Mira Meksit, qoftë ky roman apo tregim, lexuesit i duhet të përgatitet për një rrugëtim – jo për një udhëtim turistik – në kohë, në ngjarje historike e mnemotike, dhe në hapësirë, në treva gjeografike dhe në viset jetësore e botët psikike të personazheve, një pjesë e të cilëve janë tashmë të mirëngulitur në kujtesën e lexuesit.

Kjo veçori e rrëfimtarisë së Mira Meksit ndeshet lehtë dhe qartë edhe te *Kutia e Agatha Christie*-t, në qendër të të cilit është Mid'hat bej Frashëri, një ndër personalitetet më të arrira të Shqipërisë së viteve '30, portreti i të cilit në roman jepet i gdhendur në reliev në tërë poliedricitetin që rrezatonte dhe në të tëra dimensionet, nga ai politik, kulturor e letrar, te dimensionet e tij të brendshme, te ndjenjat dhe përjetimet, ëndrrat dhe idealet, si dhe historitë e tij dashurore.

Përpos kësaj, ndryshe nga sa më parë, personazhi mbartet në faqet e romanit deri edhe me ideolektin e tij, i cili në fushën e dialektologjisë (një degë e gjuhësisë) shenjon përdorimin e gjuhës sipas intuitës së lindur të njeriut; shprehimisht, gjuhës "bio", për shkak të pranisë të së cilës lexuesi e ka të vështirë të dallojë nëse është Mid'hat bej Frashëri ai që është ngjitur deri në kohën tonë, apo është lexuesi ai i cili ka zbritur nëpër shkallaren e kohës deri në kohën e tij; apo, parë në një vështrim më të gjerë, nëse është Mid'hat bej Frashëri, jeta e tij dhe mozaiku i ngjarjeve të kohës së ndërmbartur në faqet e romanit, apo janë faqet e romanit që janë ndërmbartur tek ai, te jeta e tij dhe te ngjarjet e kohës së tij, kombëtare dhe më gjerë. Në të dyja rastet, dilema mbetet jo vështirësisht, por pamundësisht e zbërthyeshme. Madje, personalisht jemi të mendimit se kjo dilemë mbetet e tillë, pamundësisht e zbërthyeshme, edhe për vetë Mira Meksin, e cila është e ndryshme nga Mira Meksi që gjendet herë pranë e herë brenda lëkurës dhe psikës së personazhit, herë si një vëzhguese e ftohtë dhe herë si njeri i përfshirë drejtpërdrejt në jetën, dilemat, përjetimet dhe ndjeshmërinë e tij apo në ngjarjet, intrigat politike, rreziqet dhe përpjekjet e shovinistëve grekë e sllavë kundër trojeve shqiptare, qëndrimet e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare, të cilat formësojnë jo thjesht mozaikun historik, por edhe temperaturën dhe pulsin e atyre kohëve.

Krahas sa më sipër, ky roman shfaq një tjetër element, i cili e dallon nga romanet e tjera. Fjala është për një zgjerim të rrugëtimit që përmendëm në krye. Ndryshe nga romanet e tjera, këtu lexuesi ftohet edhe në një rrugëtim ndërtekstor, apo në një rrugëtim "babelik", siç mund ta kishte përkufizuar Jorge Luis Borges-i, i shprehur që në titull, i cili kryen mirëfilli funksionin që lipset të kryejë *sine qua* një paratekst. Paraqitja që në titull e Agatha Christie-t, autores së njohur të të ashtuquajturit zhanër policesk, krahas funksionit magnetizues, shenjon edhe hapin e parë në rrugëtimin ndërtekstor, i cili pasohet nga fjalia hapëse, e cila është pothuajse e njëjtë me fjalinë hapëse të *Njëqind vjet vetmi* të Gabriel García Márquez-it, sikundërse ishte fjalia hapëse e *Dashuria në kohërat e kolerës* një lloj parafrazimi i një fjalie nga *Cianur shkumues* e Agatha Christie-t, prej nga lexuesi vihet që në fillim përballë një ekuacioni letrar grishës. Dhe ky rrugëtim vijon herë me qokëzime të dukshme, të drejtpërdrejta, e herë përmes copëza citimesh e parafrazash, të cilat lexuesit do t'i duhet t'i peshkojë vetë. Dhe jo vetëm kaq; në këtë rrugëtim, përpos zërit, lexuesi ndeshet edhe me disa prej autorëve të veprave letrare të përfshira në stofin e romanit dhe, mbi të gjitha, një pjesë e tyre përfshihen në traumën e tij, siç është rasti i Agatha Christie-t dhe personazhit të saj më të njohur, Hercule Poirot, i cili te *Kutia e Agatha Christie*-t, nga personazh fiksional, përfton një ekzistencë të mirëfilltë fizike, reale, apo rasti i Conan Doyle-it, krijuesit të Sherlock Holmes-it. Kjo ndërtekstorësi kaq e dendur e largon paq të vështruarit e *Kutia e Agatha Christie*-t si roman i zhanrit policesk. Pavarësisht ndjenjës së aventurës dhe *thriller*-it të garantuar, *Kutia e Agatha Christie*-t është, më së pari dhe mbi të gjitha, roman mbi dashurinë, mbi sakrifikimin në emër të saj dhe mbi faljen në emër të saj. Tekefundit, si tërë romanet e deritanishme të Mira Meksit.

Shtëpia Botuese e Mësimit dhe Studimit të Gjuhëve të Huaja (Foreign Language Teaching and Research Publishing Co.,(FLTRP)

BOTOHET NË KINË LIBRI "SHQIPËRIA NË ART" I STUDUESIT FERD HUDHRI

Libri "Shqipëria në Art", botim i Shtëpisë Botuese Onufri (Tiranë, 2018) i përkthyer në gjuhën kineze nga Wang Xianya sapo është shpërndarë nëpër libraritë e Pekinit dhe qyteteve të tjera të Kinës. Është realizuar nga Shtëpia Botuese e Mësimit dhe Studimit të Gjuhëve të Huaja (Foreign Language Teaching and Research Publishing Co.,(FLTRP). I botuar me miratimin e Këshillit Shkencor të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, libri "Shqipëria në Art" u përzgjodh për kolanën me vepra të ndryshme që i përkasin fushës së historisë, kulturës, letërsisë dhe artit, të cilat japin një pamje të përgjithshme të historisë dhe kulturës së Shqipërisë si dhe përfaqësojnë arritjet më të mira të krijimtarisë letrare-artistike të vendit.

Libri në Pekin është botuar me titullin "Shqipëria nëpërmjet artistëve". Është realizuar me kopertinë speciale, me cilësinë më të lartë të botimeve të këtij lloji. Të gjitha veprat e artit që ilustrojnë librin, janë vendosur në përmasa të ndryshme nga botimi në Tiranë, përshtatur me stilin e formulimit grafik të botuesve kinezë. Ndryshimet në përmasat e tablove, skulpturave, gravurave dhe veprave të tjera (që nga *Arti ilir, Ndikimet greko-romake, Diaspora e hershme, Arkitektura, Arti pas bizantin, Arti katolik, Arti islam, Arti popullor, Artistët e huaj, Arti i rilindjes dhe pavarësisë, Arti i realizmit socialist, Artistët e diasporës, Arti në treva të tjera shqiptare, Drejtimet e reja bashkëkohore* si dhe në pjesën e dytë e të tretë të librit *Shqipëria nëpërmjet artistëve të huaj* dhe *Shqipëria nëpërmjet artistëve shqiptar*ë), të cilat në shumë raste janë në përmasa krejt të ndryshme nga botimi në gjuhën shqipe, tregon gjithashtu edhe vlerësimet e botuesve kinezë ndaj disa veprave të veçanta apo ndaj disa artistëve shqiptarë apo autorëve të huaj që kanë trajtuar temën shqiptare.

Libri në gjuhën kineze ka tri parathënie. Krahas asaj të autorit që e përcakton botimin si *një enciklopedi e kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare,* janë paraqitur edhe parathëniet nga Shtëpia Botuese në Pekin si dhe përkthyesja e librit Wang Xianya. Më poshtë po paraqesim pjesë nga të dy parathëniet e autorëve kinezë, sipas përkthimit të sinologut të njohur Iljaz Spahiu, kryetar i Shoqatës Kulturore Shqipëri-Kinë.

"...Shqipëria ndodhet në pjesën perëndimore



të gadishullit ballkanik dhe njihet edhe si "Vendi i Shqiponjave". Duke qenë pasardhës të ilirëve, shqiptarët janë ushqyer me qytetërimin lindor dhe perëndimor, duke ruajtur në të njëjtën kohë gjuhën dhe kulturën e tij antike. Në tablonë e larmishme historike e kulturore të tij hasen epope heroike të kohëve antike dhe poema romantike të kohëve moderne që i këndojnë frymës kombëtare, por edhe kryevepra letrare të Ismail Kadaresë me vlera të veçanta kombëtare,të cilat kombinojnë me mjeshtëri historinë me imagjinatën krijuese. Ne kemi zgjedhur për përkthim e botim 25 vepra me karakter klasik, huaman e bashkëkohor, të cilat i përkasin fushës së historisë, kulturës, letërsisë dhe artit, të cilat japin një pamje të përgjithshme të historisë dhe kulturës së Shqipërisë si dhe përfaqësojnë arritjet më të mira të krijimtarisë letrare-artistike të këtij vendi.

Pavarësisht kujdesit dhe impenjimit të specialistëve vendas e të huaj, përzgjedhja e 25 veprave klasike në krijimtarinë e gjerë klasike të "Vendit të Shqiponjave", ka qenë një detyrë e vështirë, sikur të kërkosh guacka në oqean, dhe me siguri *nuk kemi arritur të përsosurën. Jemi të bindur se me përpjekjet e përbashkëta të dy palëve, kineze e shqiptare, botimi i serisë së këtyre librave do të nxisë më tej mirëkuptimin mes dy popujve si dhe do të hapë një faqe të re në shkëmbimet kulturore mes dy vendeve".*

Shtëpia Botuese e Mësimit dhe Studimit të Gjuhëve të Huaja, Pekin (FOREIGN LANGUAGE TEACHING AND RESEARCH PUBLISHING Co., Ltd. (FLTRP), BEIJING

PARATHËNIE E PËRKTHYESIT

Vitet e fundit, me intensifikimin e shkëmbimeve mes Kinës dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, është rritur dukshëm edhe interesimi i lexuesve kinezë për kulturën dhe artin e këtyre vendeve përfshirë Shqipërinë, me dëshirën për tu njohur më mire me historinë, zakonet e traditat e tyre. Botimi në Kinë vitet e fundit i disa veprave letrare të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare, çeli një dritare letrare për lexuesit kinezë për të pare "Vendin e Shqiponjave". Ndërkohë botimi në gjuhën kineze i librit "Shqipëria nëpërmjet Artistëve", si vepra e pare në kinezisht për historinë e artit shqiptar, ka ofruar për lexuesit një këndvështrim të veçantë historik me konotacion letrar.

Autori i këtij libri, Ferid Hudhri, prej vitesh është i përkushtuar në studimin e artit shqiptar, duke u renditur në radhët e studiuesve më autoritarë të historisë së artit. *Ka punuar Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, në Qendrën e Studimit të Arteve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave Albanologjike. Mban titullin Profesor dhe gradën Doktor i shkencave. Për disa vite ka qenë drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve. Është autor i shumë studimeve dhe botimeve për Historinë e Artit Shqiptar. Disa prej librave të tij janë vlerësuar me çmime kombëtare.*

"Shqipëria nëpërmjet artistëve" është ndër veprat kryesore të Zotit Hudhri. Në vitin 2003 ky libër është botuar në shqip në Tiranë, *ndërsa në vitin 2007 është botuar në anglisht njëkohësisht në Tiranë dhe Londër. Libri* në gjuhën kineze është përkthyer sipas botimit të *dytë të shqipes (Onufri, Tiranë, 2018). Vlen të theksohet se për këtë botim autori bëri disa redaktime specifike, duke përfshirë në të edhe punime të artistëve kinezë të viteve 60-70-të të shekullit kaluar, me dëshirën për të qenë kështu edhe më afër lexuesit kinez. Sipas një rendi kronologjik, autori ka përzgjedhur figurat, punimet dhe ngjarjet më kryesore nga fusha e artit vendas dhe të huaj që nga lashtësia deri në ditët tona, duke treguar historinë e Shqipërisë nëpërmjet ilustrimeve artistike. Libri ngjan me një Galeri Arti, në të cilin secili kapitull përbën një pavion* më vete, ku lexuesi nëpërmjet secilës nga veprat e ekspozuara ka mundësi të shijojë artin dhe të njohë e vlerësojë historinë.

Me këtë rast, dua të iu përcjellë një përshëndetje të sinqertë Ambasadës kineze në Tiranë, Shtëpisë Botuese, Qendrës e Studimeve Albanologjike në Universitetin e Gjuhëve të Huaja në Pekin, si dhe kolegëve përkthyes kinez e shqiptarë, pasi falë kujdesit , mbështetjes e ndihmës së tyre u bë i mundur botimi në kinezisht i librit "Shqipëria nëpërmjet artistëve".

WANG XIANYA (*Emri shqiptar* **JETA**)

*

Në kopertinën e fundit të këtij libri në gjuhën kineze janë paraqitur tre komente nga Ismail Kadare, Moikom Zeqo dhe Josif Papagjoni për librat e studiuesit Ferid Hudhri. Po i botojmë më poshtë sipas renditjes së Shtëpisë së Botimeve Ndërkombëtare në Pekin:

Libri i Ferid Hudhrit na dëshmon edhe një herë, në mënyrë bindëse, atë komunikim fisnik midis popujve të realizuar përmes pikturës. Pas një pune të gjatë hulumtuese ai na dëshmon se me dhjetëra kanë qenë piktorët që, duke udhëtuar nëpër Shqipëri, kanë marrë me vete, për t'i ringjallur më pas në pëlhurë, ngjyrat dhe fytyrën komplekse të saj e të shqiptarëve. Të tjerë që, për arsye të ndryshme, nuk erdhën dot fizikisht, erdhën me mendjen dhe përfytyrimin e tyre, huajtën kostumet shqiptare nga kolegët, shpejtuan në studion e tyre dhe atje, me ndihmën e atyre ngjyrave të paharrueshme, të saj ç'ka kishin dëgjuar dhe të intuitës që kanë artistët e vërtetë, krijuan tablo me vlerë të pakontestueshme.

ISMAIL KADARE

Libra të tillë vështirë se përsëriten. Duhet një jetë. Dashuri pa fund. Vullnet të paepur. Eksperiencë. Një libër që nderon vendin e tij, historinë e shqiptarëve, kujtesën tonë. Libër që e ka brenda dashurinë për malet, fushat, brigjet dhe detet e dheut mëmë, kështjellat, heronjtë dhe monumentet. Hirin dhe flakën e shpirtit. Libër që të bën krenar...

Prof. Dr. JOSIF PAPAGJONI

Ferid Hudhri i ka kushtuar jetën historisë së artit dhe është historiani më i njohur shqiptar në këtë rrafsh. Meritën e tij më të madhe si historian ai e ka pikërisht në zbulimin e tërë enciklopedisë piktorike të mjeshtërve të mëdhenj të romantizmit *europian. Informacioni i tij i kujdesshëm dhe korrekt e bën atë një studiues, gati të vetëm në Shqipëri për këtë epokë. Këtu spikat më shumë profesionalizmi i Feridit. Këtu është merita e tij e jetës.*

Dr. MOIKOM ZEQO



Fragment nga romani në dorëshkrim

VDEKJA E OMERIT

nga Adil Olluri

Ata që nuk do të ndjejnë dhimbje për Omerin më mirë të mos e lexojnë fare këtë tregim, sepse as nuk do ta kuptojnë e as nuk do ta përjetojnë. Ata që nuk derdhin lot për vdekjen e një të riu, lë t'i shmangën sa më shumë këtij rrëfimi. Ky rrëfim nuk është për zemërgurët, ata që i shikojnë ftohtë vdekjet, vajet dhe vuajtjet e të tjerëve. Ky rrëfim është për ata që derdhin lot, lot të njëmendtë, jo të shtirur. Daullet nganjëherë bien jo vetëm për ata që kanë vesh, por për ata që dinë të dëgjojnë mirë; tregimet nganjëherë shkruhen jo vetëm për ata që kanë që kanë sy, por edhe për ata që kanë lot.

Kush nuk i duron rrëfimet për vdekjet, më mirë le të heqë dorë nga këndimi i këtyre rreshtave që do të lidhen me njëri-tjetrin për ta ndërtuar një ngrehinë, brenda së cilës vetëm funde të lumtura nuk do të ketë. Ata që janë mësuar me dëgjimin e përrallave të lehta me të ndodhura fatsjellëse e përfundime fatlume, le të ndryshojnë rrugë, lë hynë në kthesa të tjera, sepse këtu nuk do të gjejnë të tilla gjëra. Nuk do të gjejnë zgjidhje të këndshme për të gjitha palët dhe lehtësira të ndryshme, me të cilat mund ta kalojnë një mesditë të bukur a një mbrëmje argëtuese. Ata që janë mësuar t'i marrin gjërat shtruar, të mos e vrasin mendjen për errtat dhe të mynxyrtat e qenies njerëzore, më mirë të mos trokasin në dyert e kësaj godine, sepse nuk do t'iu hapet. Kush është i bindur se lumturia arrihet duke qëndruar anash të gjitha veseve njerëzore, duke mos u përballur e asnjëherë e në asnjë mënyrë me to, më mirë t'i mbyllin faqet e këtij libri, sepse do të zhgënjehet thellësisht dhe shpirtërisht. Vetëm ata që janë të bindur se nuk ka lumturi të plotë, gjersa të ketë vdekje, janë të mirëseardhur në këtë rrëfim, që më shumë të frikëson se sa të gëzon. Ata që janë të gatshëm për të sharë, për të qarë, për të mallkuar e për të urryer, janë të mirëpritur në këtë godinë. Ata janë mysafirët më të denjë të saj.

***

Omeri u gjet i vdekur në një rrugicë të shkurtër e pa drita në periferi të qytetit. Trupi i tij u gjet pranë një dyqani të vogël, m'u te shkallët e tij. U gjet i vrarë me tre plumba, një në bark, një në gjoks e një në ballë. Tre plumba për ta rrëzuar një trup njeriu, për ta zhbërë një jetë e për ta shuar një frymë. Vrasësit nuk i mjaftoi një plumb, atij i duheshin tre për ta përligjur trininë e një krimi. Vrasësi nuk e kishte për ngut, atij nuk i bëhej vonë, i duhej të ishte më së i saktë. Plumbi i parë në bark nuk mjaftonte, plumbi i dytë në gjoks nuk e përmbushte vrasësin në plotninë e një akti të menduar e të stërmenduar, ndërsa plumbi i tretë në ballë ishte ai i vërteti, që i ofronte vrasësit siguri dhe paqe me veprën e bërë. Plumbi i tretë nuk do t'ia linte asnjë mundësi të vrarit dhe për këtë vrasësi do të ketë qenë më së i bindur. Të vrasësh dikë në ballë nuk i lë gjë rastësisë. Vrasësi nuk dëshironte befasi. Sikur plumbi i parë në bark mos të kishte depërtuar thellë në trupin e tij, sikur plumbi i dytë në gjoks mund të mos i ketë prekur organet qenësore të të vrarit, andaj atij për të qenë rehat me punën e bërë, i duhej ta shkrepte edhe një plumb. Dhe atë ku tjetër, pos në ballë, për t'ia ndalur në çast frymën gjahut të tij, gjerë atëherë shëndetplotë, i gjatë, shpatullgjerë, flokëverdhë dhe me korp atleti. Plumbi në ballë nuk i linte gjë befasisë, së cilës gjithsesi do t'ia ketë pasur frikën vrasësi.

Plumbi në ballë e ndali në çast frymën e Omerit. Kjo gjithsesi se do ta ketë gëzuar vrasësin, i cili qetësisht do të ketë ikur në punët e tij. Mund ta ketë pirë një kafe në shtëpinë e tij dhe të jetë shtrirë në divan për ta ndezur televizorin ose telefonin e tij të mençur për t'i parë lajmet se si do ta kenë trajtuar veprën e tij. Ndoshta edhe nuk do të ketë shkuar fare në shtëpi, por do të jetë ndalur për të pirë kafe në kafenetë e shumta në qytet. Aty do të jetë lidhur me internet për t'i lexuar reagimet e pritshme të të tjerëve për atë që kishte bërë. Një vrasës gjakftohtë edhe mund ta ketë bërë këtë. Fundja, të dhënat e mëvonshme të policisë thoshin se vrasja ishte kryer me një armë të pazëshme. Andaj, me siguri vrasësi atë mbrëmje do të ketë ecur i shpenguar rrugëve të qytetit. Askush nuk kishte dëgjuar krisma, askush nuk kishte parë gjë. Vrasësi natyrisht se do t'i ketë pritur reagimet e të tjerëve, sepse Omeri ishte djalë i njohur e i dashur për qytetin, dhe sigurisht se njerëzit do të shprehnin ngushëllime, vaje e mallkime për dorasin. Herë të njëmendta e herë të shpifura, por megjithatë do të shprehnin. Kur vdes një i ri, ose më së rëndi kur vritet një i ri, i njohur i dashur për shumëkënd, njerëzit flasin, vajtojnë, nxjerrin mllef e mallkojnë, edhe nëse asnjëherë nuk e kanë njohur të ndjerin.

***

Omeri u gjet i gjakosur në një rrugicë të shkurtër e pa drita në periferi të qytetit. Gjaku që dilte nga mesi i ballit ia kishte skuqur fytyrën dhe flokët e tij të verdhë. Sytë mezi i shiheshin, goja dhe buzët ishin puthur me gjakun e njomë, fyti i bardhë ishte ngjyrosur me të kuqen e mortit. Sytë që kishin parë sa e sa gjëra të shëmtuara e të bukura, tashmë nuk do t'i shihte kush. Goja që kishte nxjerrë fjalë të pahairit e të hairit, të hijshme e të pahijshme, tashmë nuk do të nxirrte asnjë zë. Buzët që kishin puthur gra e vajza të bukura të qytetit, tashmë mund ta përqafonin vetëm dheun e ftohtë, që do ta përpinte korpin e tij prej atleti dhe do t'i bënte nikoqirllëk të përhershëm.

Gjoksi i gjerë i një burri njëzetë e shtatë vjeçar ishte gjakosur. Këmisha e tij e bardhë kishte marrë tjetër ngjyrë. I kishte rrjedhur gjaku si ujë burimi,

gjersa i kishte mbuluar dhe skuqur të gjitha gjymtyrët e pjesës së epërme të trupit.

Korpi i fuqishëm i një burri njëzetë e shtatë vjeçar nuk i kishte bërë ballë plumbave. Revolja sa një pëllëmbë dore dhe tre plumba të vegjël ishin më të fuqishëm se një trup i plotë dhe i gjatë njëqind e tetëdhjetë e nëntë centimetra. Plumbat do të kenë qenë të vegjël, por të mjaftueshëm për t'ia dhënë fundin e përgjithmonshëm një burri të ri, që cilësohej njëri nga më të fuqishmit jo vetëm të lagjes, por të mbarë qytetit. Trup vigani e trup kreshniku ishte vlerësuar nga të afërmit dhe miqtë, por arma e ftohtë, e vogël dhe vrastare, nuk pyeste për këto cilësime dhe pa një pa dy, shkrepi tri herë mbi të, jo më shumë, aq sa i mjaftonin, dhe një jetë që do të mund të merrte vrull në ditët, muajt dhe vitet në vijim, u pre dhe ra përdhe.

***

Kush e vrau Omerin?

Kështu do të pyes secili lexues i këtij rrëfimi, dhe jo vetëm lexues, por edhe secili dashamirës e i njohur i Omerit.

Ai ose ata do të duan ta marrin lajmin qysh në faqet e para të këtij libri. Me siguri, do të duan që sa hap e mbyll sytë, ta dinë se ku, si, kur dhe kush shkrepi tri herë mbi trupin e të riut. Janë të mësuar t'i marrin të dhënat shpejt e shpejt, të mos humbin kohë duke lexuar qindra faqe për ta kuptuar një të vërtetë, që sipas mendjeve mesatare mund ta marrin me pesë, gjashtë apo dhjetë ose më së shumti njëzetë rreshta. Por jo, këtu nuk do të ndodh kështu, sepse ky libër nuk e ka synim parësor ta tregojë të vërtetën, por ta zbërthejë të vërtetën, ta shpjegojë të vërtetën, ta jap një qëndrim rreth të vërtetës. Me anë të këtij libri nuk do të lajmërojmë, por do të shpjegojmë.

Edhe ashtu, gjetja e një vrasësi nuk është gjë e lehtë. Po të ishte e tillë, me siguri se nuk do të ndodhnin kaq shumë vrasje, nuk do të vdisnin njerëzit nga plumbat e revolverit, qoftë ai me zë apo pa zë. Ata që vrasin, dinë edhe të fshihen. Ata që shkrepin plumba tinëzisht në mes të natës, dinë të ruhen edhe në mes të ditës. Andaj, gjetja e një vrasësi është punë jashtëzakonisht e vështirë edhe për hetuesit më kërkimtarë e më të zotë, lëre më për një rrëfimtar që më shumë i intereson arsyeja e një vrasjeje, se sa zbulimi i emrit të vrasësit. Fundja, emri i vrasësit nuk është për të qëllim parësor e qëllim në vete.

Duke lexuar dhe duke menduar rreth vrasjes së Omerit, dikush, dikur dhe diku, me siguri do të pyes se pse njeriu vret njeriun. Ç'nxitje e ç'fuqi të brendshme duhet ta ketë një vrasës i mundshëm kur niset për ta vrarë dikë? A frikësohet vrasësi gjatë rrugëtimit të tij gjerë te vendi i krimit? A ndjen diçka kur e sheh në sy prenë e tij? A ndodh ndonjëherë që ai t'i bie pishman m'u në çastin kur do të duhej t'i shkrepte plumbat mbi trupin e të përndjekurit të tij? A ka vrasje të arsyeshme dhe kur mund të arsyetohet një vrasje? Andaj, njëra pas tjetrës mund të shtrohen një grumbull pyetjesh të njëpasnjëshme që nuk mund të marrin përgjigje të shpejta e as të lehta. Edhe ashtu, ky libër nuk mëton të japë përgjigje të thjeshta për çështje jashtëzakonisht të ndërlikuara, sepse po të donte të jepte përgjigje të tilla, të thjeshta, të shpejta e të lehta, autori nuk do ta shkruante këtë libër. Do të mjaftohej me një shënim të shkurtër, të pamenduar hollësisht e gjerësisht, të cilin do ta hidhte faqe botës, ku njerëzit do të argëtoheshin dhe do të ndiheshin falënderues që kanë i gjetur përgjigjet e gatshme për gjërat që mund t'i shqetësojnë.

MEDITIME MBI LIRINË – DUKE TYMOSUR NË LIRI

Poezi nga Ballsor Hoxha

Të vuash lirinë, (qoftë me Borgesin apo pa të)

Është në burg
(qoftë me leopard, qoftë pa të)
(qoftë me Borgesin, qoftë pa të)
Muret e bëjnë të lirë pafundësisht
Dhuna e rendit, ndonjë thyerje e krahut etj, edhe më shumë
I zoti dhe shërbyesi, i burgosuri
Shërbyesi i lirë nga frika prej vdekjes
I lirë nga mundësia e lumturisë
(dhe për këtë i lumtur)
(dhe për këtë pafundësia brenda mureve)

Fluturojnë vitet, çdo vit një tullë e hequr
Ia hapin derën, "i lirë je", i thonë me një të shtyrë
Tërë ditën e parë, tërë ditën e vetme
Kërkon një derë, jo për ta hapur
Por për ta mbyllur
Hapësira, liria, kjo robëri e pa peshë
E udhërrëfen për në kopsht zoologjik
Ku shitet për tigër
Në tërë lehtësinë e pafundësisë brenda mureve të burgut
I janë lëkurëzuar vijat e uniformës së burgut, si tigër
Apo, si duket, nga lehtësia e pafundësisë
eshtrat nga brenda i janë vijëzuar si linja tigri
(ndërmjet njeriut tigër dhe determinimit të lirisë)

Përballë lisit

Shkoqur
Një copë lëkure
Sa thellë, sa qenie e zezë, e prekshme
E mbanë në dorë dhe shikon lisin
Shfaqen lëngjet, rrëshira që rrëzëllejnë në trung
Zbulojnë gjallimin e tij
Por copa që mbanë në dorë e pakthyeshme
Në prekje
E në gjallim
Në mëvetësinë e saj kthehet në arkë
Në të vërtetë, i marrë nga shkëlqimi i gjallimit të lisit
Arkë, në arkë i duket vetja
Bashkë me luhatjen e trungut, degëve, gjetheve
Arka luhatet si barkë

I lumtur është, i mjafton ta quaj liri
Shkoqur copën e lëkurës, zbuluar prekjen
E lisi mvetëson
Luhatet, luhatet, luhatet

Determinimi i lirisë

Duke tymosur pyetet ç' është liria
E kjo, robëri
(tymosja?)
(pyetja?)
(apo liria?)
(apo çdo gjë?)
"le të themi", e jep, e vendosë, "liria është lumturi"
Tymosë
Në thellimin më të madh të lumturisë
Përballë, shiun e majit duke rënë rrëmbim
Tymosë
Brenda në akustikë druri norvegjez
Dëgjon banesën duke frymëmarrë
Bashkë duke lundruar në xhaz
Tymosë
Dhe i bllokojnë mushkëritë në moment
Kollitet, i dhemb
Më nuk është i lumtur
Më nuk është i lirë, mendon
Por tymosë
Nuk e din
E ndjek dhembjen si flutur bezdisëse
Se dhembja e liron nga çdo gjë!

Duke kërkuar "A Clean Well Lighted Place" [1]

Se si në disa momente para mbrëmjes
Kur dhemb aq mirë
Hapet qyteti
Si mushkëri universi
Si fyt mendjehumbur
Si zemër në ndërmjetësinë e ëndrrës

Dhe është rrezik
Dhe është paqe
Dhe është rrëshqitshëm, si në hënë
Dhe nuk mund ta ndalë veten
Nuk mund të mos dalë
Te troshitet deri në asht
Nga kjo hapësirë

Njerëzit faqet pakthyeshem si era
Asfalti jehon, artikulon kujtimin, vetë dhembjen
Ndërtesat janë pështjellë, humbur në gjumë, me batanije
Dhe të gjitha, të gjitha kafenetë pamjaftueshëm të ndriçuara

Shkëputur nën hapësirën e lirisë së dhembjes

Çka është kjo, banesë, pa derë
Pa hyrje pa dalje
Me hyrje me dalje
Terri ndërmjet banorit, apo banorëve si elefant i ulur
Çuditërisht i prekshëm, i përshkueshëm
Drita, përkundrazi, zbuluese, verbuese
Si muri nga ku goditet, jehon shikimi i banorit, apo banorëve
Dyshemeja e gjelbër si lum i dërmuar
E gjelbër si kokë e kthyer anash
Dritaret, në këtë banesë, shfaqjen e ikur
Shfaqjen që e shpërbën qielli
Çka është kjo banesë
Hyrjen pa numër
Daljen pa emër
Ndoshta është hija e shpirtit?

I liruar nga liria

E kafta e tavolinës shpaloset, oqean
Dy bishtat e cigareve të tymosura para
Gjigantë, dy balena te lehta, mbi ujë
Duke rrotulluar cigaren e radhës, me maje të gishtave, mbi ta
Shpërbëhem në tymin përreth
Sa më shumë qe i prekë me gacë,
derisa zbuten, sikur mblidhen
Aq më shume rrah zemra
E zbuluar theqafëse si gur i rrokullisur
Kafshon hapësirën si qen
Pastaj fiki dhe të tretën cigare
Zhyten balenat, janë hiç
Hiç janë
Hiç bëhen
Hiç janë bërë
(assesi të ketë kuptim kjo gjë!)
Shkëputem
Ti, tjetri, si reflektim i lirisë
Ritëm, apo gjurmë e saj
Nuk ishe për këto momente

VIANU MUREȘAN

E MBËSHTOLLE VETEN NË NJË FUSTAN TË ZI

Përktheu nga origjinali Oana Anca Mihaela Glasu



VIANU MUREȘAN ka lindur në 1969. Jeton në Cluj-Napoca dhe Bukuresht. Shkrimtar, publicist, doktor në Filozofi, i diplomuar në Universitetin BabeȘ-Bolyai të Cluj-Napoca (2003), i specializuar në fenomenologjinë franceze. Ai botoi ese, studime, trajtesa mbi përvojën fetare, teologjinë dhe artin e ikonave, filozofinë e magjisë, mbi tjetërsinë në perspektivën etike, krijimtarinë tek fëmijët. Ai gjithashtu shkruan poezi dhe prozë. Në vitin 2005, ai mori çmimin «Henri Jacquier" nga Qendra Kulturore Franceze për tezën e tij të doktoratës - "Heterologjia. Hyrje në etikën e Lévinas ". Ai aktualisht punon si redaktor libri dhe referent shkencor në Shtëpinë Botuese Eikon. Libra të botuar: "Themelimet Filozofike të Magjisë" (2000), "Heterologjia. Hyrje në etikën e Lévinas "(2005)," Simboli, ikona, fytyra "(2006)," Pavese, njeriu i ofenduar "(2015)," Tjetër përveç Zotit "(2017)," I çmenduri i Zotit "(Roman, 2014)," Sophia Leopold, le të luajmë duke bërë art "(2014)," Vetë-portrete në pasqyrat e librave "(2016); "Bravo, kampion!" (2019)

E MBËSHTOLLE VETEN NË NJË FUSTAN TË ZI

E mbështolle veten në një fustan të zi
që të dukesh e padepërtueshme.
Kujtove se heshtja do mjaftonte
për të mbetur e padukshme,
besove se nëse do të të gozhdoja me sy
nuk do të më mahniste shushurima
që lije pas tek zhdukeshe hijeve.

Vetëm se papritur qetësia në ty u thye
si nga një sirtar ku shfryn erë
shqisat e tua fërfëllojnë në sy të botës -
shalle në erë!
Dehja të bëri të harroje ndrojën,
nuk dije t'i fshihje duart që të dridheshin,
t'i ndaloje buzëqeshjet misterioze
që të qëndisnin përsosmërisht faqet,
të heshtje kur gjuhës të rrjedhshin lëvdata...

Ishe varur në ajër nga dashuria jote,
rrymat ta bënin trupin muzikë
që hovte në çdo dridhje.
Askush nuk guxonte të të fliste në emër
për të mos rënë,
dukej që larg trazimi i gjoksit tënd,
dukej qartë si ngopeshe me erën që të zhbironte,
dukeshin vezullimet e ylberit
që trupin ta tretshin...

Ajër i përvëlimtë shfrynte nga ty
në çdo fjalë që më thoshe,
por shpirti yt i rrokullisur jashtë
turpëruar prej lakuriqësisë
më shikonte i dridhur,
priste fjalën time si strehë,
sytë e të huajve e vinin në siklet,
trembur edhe nga kurioziteti më i vogël.

Ti nuk dite ta përballosh atë lakuriqësi
me gjithë shpërthimin
që ta shpërndante trupin në sytë e botës.
Nuk dite të bëheshe e padukshme
pa e tërhequr zvarrë pas vetes rrjedhën
ku gjoksi yt lahej me ditë...

I LINDUR PAK NGA PAK

Nuk linda papritmas;
shpirti im ka vonuar, ka vonuar,
kam arritur të mërmëris fjalët,
kam filluar të rrokullisem dhe të qesh,
të shikoj me habi sytë e kafshëve,
të ngrohem në avullin e gojës së tyre,
të rris fëmijë që nuk ishin të mitë,
ta shoh veten të braktisur nga ca gëzime
që vetëm i kam ëndërruar,
të ngre ujë nga pusi edhe sot, edhe nesër
megjithëse i paetur...

Më në fund erdhi dhe shpirti,
dukej i lodhur, i mplakur.
S'di në më përshtatej,
s'di a ishte i imi,
por e mora siç ishte,
e lashë në mua.
Kisha jetuar pa të,
por nuk di
ndihesha më keq apo më mirë.
u mësova ashtu.
Shumë gëzim sikur të kisha atëherë
do të isha rinuar befas
pa ditur si të sillesha.

Gjithmonë kisha jetuar në një moshë
kur çdo ditë i ngjan ditës së shkuar,
çdo natë sjell gjumë të përjetshëm.
Në atë moshë mëngjeset janë mrekulli,
humbjet në ëndrra
më të dhimbshme se ora e lindjes.

Shumë mirëkuptim
do të më kishte prishur qetësinë,
deri atëherë fola pa gjuhë,
gjithçka që nuk mund të thosha
m'i jepte aromë gojës,
ngrohja ajrin me faqet e mia
kur mbetesha pa fjalë.

Por askush nuk pa një shenjë të mirë,
kam dashuruar deri atëherë
pa pasur asnjë dashuri,
ka rrahur më fort herë pas here zemra
që të dëgjohej përreth
një lëvizje e nxituar, e zhurmshme,
një thirrje...

Por nëse dikush do të më dilte përballë
do turpërohesha dhe zemra më s'do rrihte.
Rrija kokulur për ca kohë
gjersa bota vithisej rreth meje,
më në fund vinte nata,
errësira e natës isha unë...

SHIU I ARTË

Nuk e dija emrin e saj,
nëse ishte të paktën një bimë e vërtetë.
E kam parë vetëm një herë
kur kam hapur librin e një poeti province,
por edhe atëherë u ndjeva në ëndërr.
Ai e quajti atë forsythia në një poemë misterioze
me fjalë shkruar nga kryqe të artë
në vend të shkronjave
që mund të lexoheshin vetëm në terr.

Atëherë vargjet shkëlqenin
dhe në zhurmën e asaj ndezjeje
dëgjohej shiu
nën dritaren ku poeti shkruante me kaligrafi
përkulur mbi fletët e kartonit,
kishte mbirë një kaçubë që vetëm ai mund ta
shihte.

Kur thyhej nata poeti fikte dritën në dhomë
dhe tërhiqej drejt dritares
ashtu, i ndrojtur sikur po e ndiqnin,
sikur e ndenjura në terr qe punë e pamenduar -
gjumi i tij ishte shiu i ndritshëm
që i rridhte syve,
mëngjesi e gjente të habitur,
me faqet larë në ar...

Një natë doli fshehtaz nga shtëpia
kur gjithë fqinjët flinin.
Theu një degëz nga kaçuba nën dritare
dhe shkoi të endej varrezës.
Kishte kaluar mesnata
kur ia behu papritmas stuhia;
qielli derdhte ujëra të arta,
nëpër ajrin kristal shikohej gjer te shpirtrat;
të gjithë dridheshin plot ndrojë,
ishin mësuar mbetur fshehur e harruar
largimi nga sytë e tokësorëve
i mbronte si hiena,
mosbesimi se ka jetë në parajsë
i mbante në një letargji të ëmbël.

Vetëm kur në ta ngjitej një i ri,
i panjohur, i hutuar
dëgjohej një zhurmë konfuze
dhe fjalët u dilnin nga goja
të pakuptueshme.
qielli i madhërishëm
zbriti ta preknin me dorë,
kryqet e varreve
u zverdhën si lule forsythia,
një krah i egër e tërhoqi poetin
nga ngurosja marramendëse
dhe e hodhi diku mbi varrezë.
"Vetëm poeti si zog fluturues" mbi tokë
i bënte me britma shkëndijë erës,
vetëm fryma e tij nëpër erë
kumbon kallamishtes si lirë...

Pa poshtë, varrezë libri i tij,
kryqet - petalet e arta që shkroi poemën.
Atëherë pranvera
zgjati veç një natë,
kush lexon poemën forsythia
thotë se është për natën e Ngjalljes...

Silvio D'Arzo

DY PLEQ

Përktheu Anxhela Lepuri

S'di a është tepricë a mungesë ndjeshmërie, por, faktikisht, tragjeditë e mëdha nuk më prekin aspak. Ka dhimbje të lehta, situata dhe marrëdhënie të caktuara, që më prekin më shumë se një qytet i përpirë nga flakët.

Kjo është arsyeja e parë përse sot nis e shkruaj për dy pleqtë Grimaldi.

Të lindur rreth viteve 1880-të, jetuan në një kohë relativisht të lumtur, e të tillë qenë edhe ata për shumë vite. Patën fatin të trashëgonin pasuri, e për më tepër thuhet se ishin që të dy shumë të pashëm. Por më pas gjërat ndryshuan.

Rreth viteve pesëdhjetë (pasi prej dhjetë vjetësh kishin filluar të jetonin paksa të mënjanuar), vdiq djali i tyre i vetëm: e nëse lumturia i kishte bërë gati të ngjashëm me qindra të tjerë, kjo humbje e parë arriti t'i bënte thellësisht të ndryshëm. Që prej atij momenti filluan të ishin vetvetja. Nuk dilnin më, nuk mirëprisnin pothuajse askënd. Nga vitet pesëdhjetë në vitet gjashtëdhjetë (përfshirë katër vitet e fundit të luftës), vërenin sesi pasuria e së shkuarës mpakej dita-ditës, por nuk e vunë hiç ujin në zjarr për ta ndryshuar. Për dhjetë vite me radhë u mjaftuan vetëm duke vëzhguar, siç shihet ndonjëherë cikërrima e fundit e një letre që zjarri i vatrës po e firon ngadalshëm.

Sakaq u degdisën vetëm me një shtëpi. Andaj, me një lloj cinizmi prekës, bënë hesapet e viteve që me shumë mundësi iu mbeteshin për të jetuar, si dhe llogarinë e asaj çka mund të fitonin nga shitja: e si rrjedhojë vendosën ta nënshkruanin marrëveshjen. Kështu, pasi morën gjysmën, e ndoshta shumë herë më pak të asaj që çdokush tjetër mund të fitonte me lehtësinë më të madhe, u zhvendosën në një apartament në qendër.

– Nëse do të na nevojitet diçka, nuk ka asgjë më larg nga qendra, - vërejti ai, që nga kohët e shkuara kishte ruajtur vetëm një xhepore paradoksesh dhe maksimash.

Filloi kështu faza e tretë e jetës së tyre, pa dyshuar se së afërmi do t'ia behte edhe një e katërt. Si një ledhë të fundit, ai filloi të lexonte Horacin, ndërsa ajo bënte ndonjë punë të lehtë tek-tuk nëpër shtëpi, të cilën e shihte të domosdoshme. Kështu kalonin pasditet; dhe nëse në këtë botë mund të ketë lloje të ndryshme lumturish, nuk më është e vështirë të mendoj se qenë pothuajse të lumtur.

Ia behu papritur një të mërkure.

Ora në sheshin atypari shënonte dhjetë e gjysmë; e, si zakonisht, gruaja që vinte çdo mëngjes për të bërë psonisjen dhe pastrimin, hoqi përparësen, përshëndoshi dhe doli nxitimthi. Para njëshit duhet ‹‹të bënte" edhe dy shtëpi. Por u kthye vrikthi.

Ka ardhur një... një zotëri që pyet për ju, - tha paksa vrenjturazi për vonesën që iu shkaktua. Zonja hodhi një sy përreth nëse ish çdo gjë në rregull.

Mendoj se mund ta mirëpresim edhe këtu, - vendosi ajo. – Fute brenda, Maria.

Nuk mundet, - tha gruaja duke hyrë sërish. – Kërkon ndjesë, por dëshiron të flasë vetëm për vetëm me ju. I shoqi hoqi sytë nga libri.

I ri? – pyeti duke iu drejtuar gruas.

Eh...po, - ia behu kjo, pa kuptuar mirë. – Po, po, i ri. Pak a shumë tek të tridhjetat.

Ah, ç'kohëra të bukura, ç'kohëra të bukura. Nxiton, - tundi kokën ai duke parë të shoqen. – Se mos pret që të dalë i shoqi...

Duhet të presë çik si shumë, - u përgjigj duke qeshur e shoqja. – Ke më shumë se dy vjet që nuk bën çap nga shtëpia.

Për moshën dhe gjendjen e tyre, një vizitë përbënte një lloj ngjarjeje aventurore: e nuk kish bërë vaki, kurrë ndonjëherë, t'u vinin për vizitë riosha. Dhe tani, ky person, djalosh i ri, kërkonte personalisht atë. Nuk arrinte ta kuptonte.

Nuk ka rëndësi. Nuk ka rëndësi. Përse të të kërkoj ndjesë? Të kërkova gjësend? – vazhdoi ai të tallej me të njëjtin ton. – Unë po lexoja Horacin dhe nuk dëgjova hiç asgjë. Mos ma vë re.

Ajo doli duke qeshur me vete. Në sallon gjeti një djalosh rreth të tridhjetave, që natyrisht nuk e kishte parë kurrë, emri i të cilit i ishte krejtësisht i panjohur. Kishte një mjekër tre a katërditëshe, dhe mbathte një mushama verdhalaqe të vjetër, si ato që përdornin një herë e një kohë oficerët e kalorësisë. Si kravata ashtu edhe këpucët, nuk dëshmonin gjë tjetër veçse përmbushjes së nevojave. Me pak fjalë – përveç një lloj agresiviteti që nuk ishte aspak i pakëndshëm – figura shembullore e studentit të varfër të letërsisë, i cili do të bëhet padyshim gazetar, por që për momentin deklarohet i gatshëm të japë leksione private me çmim sa për ndonjë kacidhe.

Epo ja, shihmëni, ja tek jemi, - ia nisi ai teksa uleshin, me një lloj ngathtësie rastësore dhe të padurueshme, për të cilën edhe ai vet dukej se nënqeshte. – Historia është shumë e gjatë, e di mirë; sidoqoftë, nuk mendoj se mund ta shkurtosh kushedi se çfarë. Më dëgjoni... jam njëzetegjashtë vjeç (njëzeteshtatë i bëj në gusht) dhe studioj juridik. Apo më mirë, jam regjistruar në një vit të juridikut, që me shumë mundësi duhet të jetë i fundit...

Si im bir, - i vjen vetvetiu të komentojë zonjës, e cila ishte e gatshme të dëgjonte me një lloj ironie mëmësore dhe dashamirëse.

Kam studiuar ca në Bolonjë: dy vite. Ju e dini pak a shumë si është... dhe dy vite të tjera në Milano.

Pikërisht si im bir, - kujtoi ajo sërish.

Bah, - thotë duke qeshur rioshi që ndihej në siklet nga këto kombinime të papritura. – Mendoj se këto janë të vetmet pika të përbashkëta mes ne të dyve. Ja, - ia bëri duke treguar mushamanë dhe këpucët; e ndoshta edhe ndonjë mjerim tjetër që duhet të ishte ca më i thellë dhe më vetjak, sesa veshja e vjetërsuar. – Nuk ka më keq se unë.

Zonja ndryshoi ton:

Do të doja dhe unë të kisha të njëjtën siguri...

Oh, më vjen keq, - tha ai, duke kuptuar vetvetiu se i biri duhet të kishte vdekur. – Më vjen keq. Gjithsesi, edhe meqë qenka kështu, unë qëndroj në timen.

Dhe priti me një padurim të hallakatur që vala e tronditjes, ngjallur tek ajo nga ai aluzion të farosej, për të rimarrë argumentin e ndërprerë.

Mirë, - u përgjigj pas disa sekondash. – Edhe sikur të isha ca më pak koherent, jo kaq shumë, nuk do të më interesonte fare se çfarë mund të mendoni ju për mua. Në fakt, përveç të tjerash, seç kam përshtypjen se ju më vlerësoni njëfarësoj. Do të thotë të jesh idiot, apo jo? – (Zonja nuk pipëtiu). – Pardje, duke menduar për takimin tonë, kisha imagjinuar një mal me fjalë të bukura. Oh, por edhe të vërteta, të jem i sinqertë. Për shembull, gjëra të tilla si, njeriu është gjithmonë më i mirë se fjalët dhe veprimet e veta. Por këtu bëhet fjalë për diç tjetër. Këtu...

Dhe afroi paksa kolltukun me atë të zonjës, e cila gjatë fjalëve të fundit, kishte filluar ta dëgjonte, nuk e di nëse me më shumë vëmendje, por sigurisht me një vëmendje të tjetërsojtë.

Dua t'ju them vetëm këtë. Jam njëzeteshtatë vjeç, kam punuar, kam studiuar, i kam dhënë krahëve. Dhe, mbi të gjitha, kam bërë edhe nja dy vite luftë. Kam bërë çdo gjë që mund të bëja, e disa herë edhe atë që nuk mundesha. Edhe atë që nuk mundesha, e sigurt, - theksoi ai, duke ngritur paksa zërin, sikur ajo të kishte kundërshtuar diçka, apo sikur fytyra e saj të kishte shprehur në njëfarë mënyre mospajtim. – E di shumë mirë që kur ke një shtëpi të tillë, kolltukë si këta, e çdo gjë tjetër, është kollaj të ndjesh përbuzje.

Por unë nuk ndiej asnjëfarëlloj përbuzjeje, - ia priti ajo.

Tanimë mendoj se nuk mund të indinjohem as kundër vetes.

Më mirë kështu atëherë. Është pikërisht ajo që doja: dhe ka për të qenë më e lehtë për të dy ne, - ia preu shkurt studenti. Dhe rinisi: - Nuk munda të përmbyll asgjë. E nëse vazhdoj kështu nuk do e sos kurrë.

Kurrë? – pyeti ajo paksa e habitur.

Po... kurrë, kurrë. Hiçi për dikë është diç për dikë tjetër. Por tani le të kthehemi tek ne të dy. Epo, tani do bëj diçka që mund të jetë turp, që të gjithë do ta konsideronin pa diskutim një turp.

Ajo ngriti sytë instinktivisht drejt tij.

Një turp? – e pyeti.

P...o. Një turp, - konfirmoi ai me një lehtësi prej të pakënaquri duke parë majat e këpucëve. – Por kij parasysh që unë nuk lëviza asnjë gisht për ta kërkuar; edhe nëse do të ishte gjëja më e thjeshtë në botë, nuk do ta kisha vënë ujin në zjarr. Nuk pretendoj që kjo të jetë një meritë e madhe, por është e vërteta dhe po ua them. Në fakt ai... po, turpi, u prezantua vetë: bie fjala, ishte ai që erdhi e më kërkoi. Gjeti emrin tim, shtëpinë time, dhomën time: erdhi tek unë. As

më pak e as më shumë se kjo: erdhi tek unë. Dhe atëherë, nëse është kështu, më duket gjërat ndryshojnë. Edhe ju duhet ta pranoni këtë. Gjëra të tilla nuk dihet kurrë se nga vijnë; dikush edhe mund të mendoj se vinë nga shumë lart... Kushedi nga sa lart.

Ajo, natyrisht, nuk mund ta pranonte që turpi të mund të vinte nga lart (përkundrazi, kishte menduar gjithmonë se mund të vinte vetëm nga honet tona më të thella): hëpërhë edhe mund ta pranonte një gjë të tillë. Ajmé, tani ishte shumë e trazitur për të gjykuar apo menduar.

Gjithkush, - vazhdoi ndërkohë djaloshi, - ka riskun e vetë. Dhe për një si unë, më i mirë s'gjendet. Dua të them se, nuk e çoj ndërmend ta flakë tutje.

Po flisni! – tha fuqishëm ajo. – Çfarë prisni tjetër?

Mirë, - ngurroi djaloshi. – Para së gjithash duhet t'ju thosha këtë, që ju të bindeshit se nuk mund të bëja veçse kështu.

Por për çfarë mund t'ju interesojë mendimi im?... Për çfarë...

Djaloshi nxori nga xhepi një letër dhe e mbështeti mbi tavolinë.

Këtu, zonjë, keni një letër që duhet t'ju interesojë shumë: dhe që tani më intereson po njëlloj edhe mua. Kur ju keni shitur, së bashku me mobiliet e tjera, tavolinën tuaj të shkrimit, unë kam gjetur rreth dyzetë të tilla, të fshehura në një pako brenda sirtarit të tretë në të majtë. A nuk ju thashë se erdhi vetë tek unë? Mirë: dua të them se personi i tretë të cilit mund t'i interesojnë këto letra më shumë se ne të dyve është... është burri juaj. Dhe e di mirë që personi i vetëm që nuk duhet t'i lexojë këto letra është pikërisht ai, dhe se ju do të bënit ç'është e mundur që ai të vazhdojë të mendoj se nuk janë shkuar kurrë. Di madje se ju disa javë më parë keni shitur një shtëpi, prej së cilës keni marrë mjaftueshëm. Dikush tjetër mund të kishte fituar më shumë, po ç'ka keni marrë është mjaft.

Zonja po fillonte të kuptonte mjegullthi: e vështroi e shqetësuar dhe bëri të hapë gojë. Por ai e ndërpreu për ta përmbyllur ngutas.

Mendoj se 150 000 lireta do të zgjidhnin shumë gjëra, edhe ne të treve. Përnjëmend, tani bëhet fjalë për të tre ne.

Zonja tentoi sërish të fliste: por sapo çeli gojën, ai e ndërpreu sërish.

Jo, - tha tek çohej. – Ju nuk duhet të më thoni asnjë fjalë. Çdo gjë që mund të thoni, e di: e di tashmë prej disa ditësh, dhe mendoj madje se jam dakord me ju. Po, unë jam dakord me ju. Por e gjithë kjo nuk mund të ndryshojë asgjë. As mbi shifrën s'keni ç'thoni: mund t'ju kisha kërkuar më shumë ose edhe më pak. E në fakt ju kërkova ekzaktësisht aq, që, shpresoj të më mjaftojnë për të mos ua pasur më nevojën kësmeteve të tilla.

Pati një sekondë heshtje.

Sot është e mërkurë, - rinisi ai. – Të shtunën në mëngjes në orën nëntë, dhjetë ose edhe më vonë, nëse më vonë do të ishte më mirë për ju, do të kthehem me të gjitha letrat.

Edhe zonja u ngrit, duke e ndjekur qetësisht drejt portës. Këtu djaloshi ndali për një moment për të parë një pikturë në mur.

Ja, - provoi të thoshte me një zë paksa më të ëmbël. – Siç e shihni, pikëtakimet mes meje dhe "tij", nuk shkonin përtej dy viteve të universitetit.

"Ai" nuk u bekua nga kësmete të tilla, - u përgjigj ajo me një ironi prekëse. Djaloshi u largua.

Eh, eh, - ia bëri i shoqi duke hyrë në atë moment në sallon me librin e tij të hapur e duke iu afruar. – E përcolle me një fytyrë paksa të zymtë, më duket.

O Zot, sa kravatë e shpifur! – u mjaftua të thoshte ajo me zë të lodhur, duke provuar t'i bënte nyjën.

Eh, eh. Shenjë e keqe. Ana Karenina kuptoi se nuk e donte më të shoqin, kur vuri re se kishte veshë të shëmtuar, - vazhdoi të tallej ai.

Por ti kravatat mund t'i ndryshosh, - u përpoq t'ia kthente ajo me të njëjtin ton.

Por nuk ia doli. Madje nuk mundi as të qeshte.

Vetëm më vonë, pasi lexoi letrën, ajo krijoi idenë se çfarë paskësh qenë në të vërtetë për të ajo vizitë as njëzet minutëshe. As më shumë e as më pak se vetë shkatërrimi. E gjitha, në fakt, kishte ndodhur në mënyrë kaq të çuditshme dhe të papritur, dhe toni kishte qëndruar pothuajse deri në fund kaq familjar, saqë nuk kishte arritur ta kuptonte. Dhe fakteve, pas të gjithash, të cilave iu referohej ajo letër ishin tashmë kaq të largëta në kohë, sa i përkisnin një tjetër jete, nga e cila ajo vetë nuk ishte veçse një dëshmi e vetëdijshme.

Tridhjetë vjet më parë, pikërisht në atë kohë kur i shoqi ia mbathte çdo muaj në Livorno dhe kryente çmenduri të paqena pas një gruaje të re, dikush ishte dashuruar me të. Ai, që kishte zgjuarsinë dhe fatin dhe dinte sesi të zotëronte si njërën dhe tjetrën, i kishte shkruar letra të bukura, në një kohë dhe në një ambient ku kjo ishte ndoshta më e rëndësishme se vetë fati. Edhe ajo ishte dashuruar dhe nuk kishte vonuar t'i përgjigjej. Asgjë tjetër. Nuk kishte ndodhur asgjë tjetër. Dhe tani ai person ishte një i vdekur, ndërsa ajo asgjë më tepër sesa një plakë, e cila nuk kujtonte as emrin e atij që atëbotë i kishte shkruar atë tufë me letra të bukura. Por, gjithsesi, ajo letër ndodhej aty, mbi tavolinë. E vetmja gjë së cilës koha nuk i kishte shkaktuar shkëputje apo pafajësi ishte pikërisht ajo faqe e shkruar. Ajo ishte e tashmja, ishte mëkat i gjallë: ishte një gur i tridhjetë viteve më parë, i ruajtur falë një mrekullie ironike, që hidhej papritur në liqenin vetmitar të pleqërisë së tyre.

‹‹Zoti im, - u ngrit zonja duke vënë duart në kokë. – Janë shumë para. Janë shumë, shumë. Dhe për më tepër duhet ta bëj në atë mënyrë që ai të mos kuptojë asgjë..." Ishte shumë e dëshpëruar për t'u indinjuar nga një gënjeshtër, por shumë e lodhur për t'ia nisur kësaj meseleje. Zuri të dëgjonte shiun.

Në moment u bë xurxull: i shoqi nuk pati as kohën të hynte e ta ndihmonte të ulte grilat, sakaq u përfshinë nga rrebeshi. U lagën gjer në palcë që të dy. Më pas papritur u fikën dritat. Poshtë në rrugë u dëgjuan të bërtitura dhe të qeshura.

Mëpastaj u qasën pranë njëri-tjetrit.

Mendoj se nuk bëmë mirë që e shitëm shtëpinë, - tha ai pas ca çastesh. Ironia ishte një lloj mbrojtje për të dhe i vinte ndoresh kurdoherë: por tani, ora, terri dhe shiu e bënin të padobishme.

Oh, nuk do të jetojmë shumë gjatë, - u përgjigj ajo duke hamendësuar mendimin e tij.

Bah, po nuk doja të thosha këtë, - gënjeu ai.

Ndërsa unë po, - tha ajo me një ëmbëlsi paksa të athtë. – Unë në fakt doja të të thosha pikërisht këtë.

Është i gjithë faji i shiut, - ia ktheu ai. – Mendoj se nuk na takon të ankohemi, dhe për më tepër nuk ka shije të mirë. Kemi ditur të jemi të rinj në rini dhe pleq në pleqëri: jo të gjithë kanë qenë. Dhe dua të të them edhe diçka tjetër. Kur Rikardoja vdiq, mendova se s'do kish padrejtësi më të madhe në botë... Atëkohë më dukej që fakti shkonte kundër rendit të gjërave. Dhe tani, të flasim shkoqur, jam i bindur që vdekja e tij ka ndjekur pikërisht një lloj rendi që unë nuk arrij ta shpjegoj, por që duhet të jetë... E me gjithë keqardhjen që ndiej për të, mendoj se jeta e tij nuk do ta kishte bërë kaq të bashkuar të tonën. Mendoj se ka kontribuar edhe ai në kryeveprën tonë. E kam seriozisht.

Ajo u përhumb në heshtje.

Janë gjëra që thuhen në errësirë, më duket, - shtoi pas ca çastesh.

Natyrisht, natyrisht. Terri duhet edhe për këtë. Dhe duke qenë se dritat nuk po vijnë, dua të të them edhe diçka tjetër: jeta e dy pleqve vlen mijëra herë më shumë se ajo e dy të rinjve. Një mijë herë më shumë. Pa asnjë ngurrim.

Edhe mundet, nuk di ç'të them. Por nuk e kam dëgjuar kurrë të thuhet nga dikush tjetër.

Po sepse askush nuk na dëgjon, - tha ai. – Dhe sepse mendjen e kemi aq top, sa nuk na intereson se ç'mendojnë të tjerët për ne.

Një tjetër minutë heshtjeje.

Po, edhe unë mendoj se terri duhet ndonjëherë, - pranoi më në fund ajo, edhe pse duke hezituar paksa. – E meqë kështu edhe unë dua të të them diçka. Mendoj se është shumë e rëndësishme për ty, për mua dhe për çka the më parë... Fort e rëndësishme.

Ai afroi pak karrigen. Ajo u anua drejt tij. Në atë moment erdhën dritat.

Edhe unë mendoj se bëmë gabim që e shitëm shtëpinë, - ia preu ajo.

Gjithçka kishte mbaruar për atë mbrëmje. U ngritën.

Por, më vonë, ajo priti që të shoqin ta zinte gjumi për t'i shkruar këtë.

I dashur,

çka the më parë, kur dritat u fikën, është gjëja më e vërtetë që kam dëgjuar ndonjëherë prej teje, dhe jam gati të falënderoj rrebeshin që e bëri të mundur. Edhe unë doja të të thosha diçka, dhe isha gati duke hapur gojë, kur terri aq e pat; kështu që, nuk gjej mënyrë më të mirë se të të shkruaj. Ora shënon një e çerek, dhe ti po fle prej së paku një ore.

Këtu do të lexosh një letër që do të shkaktoj shumë dhimbje: të gjithë dhimbjen që, në moshën tonë, jemi ende të aftë: dhe të shtunën në mëngjes, rreth orës nëntë a dhjetë, djaloshi që erdhi sot të më takonte dhe rreth të cilit u talle paksa, do të të sjellë një pako plot.

Mund të ta kisha kursyer këtë dhimbje, duke i dhënë djaloshit 150 000 lireta: një të tretën e asaj që siguruam prej shitjes së shtëpisë sonë të shkretë. Kështu ti, mund të vazhdoje të mendoje, se jeta e ne të dyve ishte me të vërtetë ajo kryevepra që the, dhe se ikja e Rikardos sonë kishte kontribuar. Mendo pak për dhimbjen tënde dhe timen, dhe më pas atë lloj melankolie dhe ftohjeje mes nesh, ndoshta deri në ditën e fundit, dhe për çfarë, për një shumë që dikush mund ta fitojë në më pak se pesëmbëdhjetë ditë. Sa pak vlejmë, do të thuash! Të rinjtë do të ofendoheshin për shumë më pak, e di mirë këtë, por nuk do të ndihesha e sigurt duke i fajësuar ata. Por paskëtaj, Enrikua im i gjorë, ne jemi më shumë se gjashtëdhjetë vjeç dhe jemi fillikat: sot më është dashur të bindem se të jesh apo të konsiderohesh i lumtur është një luks që tashmë nuk mund ta përballojmë më, ashtu si dinjiteti i njëherë e një kohe, krenaria e shumë gjëra të tjera të shkuara. Kemi ende tre a katër vite jetë, Zoti mos e dhëntë, por ndoshta edhe pesë; dhe kam menduar se ne nuk kishim detyrë tjetër, pos pritjes së fundit ditë pas dite.

Unë e di mirë dhe po ta them, që hidhësia më e madhe nuk do të vijë nga vetë dhimbja, sesa nga konstatimi që lumturia jote është vlerësuar kaq mizorisht: shumë më pak se ato dhurata që më shumë se njëherë më ke bërë në të shkuarën, pa menduar asfare që qe diç më shumë se një marrëzi e lezetshme.

E gjithë kjo është e trishtë, i gjori Enriko, e gjithë kjo është kaq e trishtë, sa unë nuk mundem të gjejë asnjë fjalë shprese apo ndjese. Është ora dy dhe ti fle ende. E ke frymëmarrjen shumë të rëndë. Ende nuk di asgjë.

Xhovana

Pesë Zëra Emancipues nga Poezia Moderne Hebraike

KËNGË GRUAJE

Përktheu nga origjinali Melsen Kafilaj

Esther Raab
(1894-1981)

Këngë gruaje

Bekuar qoftë AI që më bëri grua –
që jam Adamah[1] dhe Adam bashkë,
një brinjë e butë;
Bekuar qoftë Ai që më krijoi
rrathë mbi rrathë, posi orbitat e planeteve
dhe bërthama e frutit –
Ai që më dha një shtat të gjallë që lulëzon
dhe më bëri posi bima e fushës
që jep fryte;
Aq sa hija jote griset,
duke rrëshqitur posi mëndafshi
mbi fytyrën dhe kofshët e mia;
Dhe unë që jam rritur
dhe dua të jem ajo vajzë,
që vajton prej hidhërimit
dhe që buzëqesh e këndon zë-lartë,
më e hollë se e holla –
Posi ai bulkthi i vockël
në korin madhështor të kerubinëve –
më e vogël se e vogla –
Unë luaj në këmbët e tua,
Krijuesi im!

Rachel Bluwstein
(1890-1931)

Tokës sime

Unë nuk të kam kënduar kurrë, toka ime
dhe as nuk e kam lartësuar emrin tënd
përmes bëmash heroike, me plaçkën e luftës.
Duart e mia kanë mbjellë vetëm një pemë
përgjatë bregut të qetë të Jordanit.
Vetëm një shteg ka zaptuar këmba ime
mbi sipërfaqen e fushave.
Në të vërtetë, është shumë i varfër
E di, Nënë!
Në të vërtetë është shumë i varfër
blatimi i bijës sate ;
Vetëm tingulli i një britme gëzimi
në ditën kur drita shndriti,
Vetëm një e qarë e fshehtë
për vuajtjen tënde.

[1] Adamah (Heb: המדא) – Tokw.

Dahlia Ravikovitch
(1936-2005)

Kukulla mekanike

Dhe atë natë isha një kukull mekanike
dhe kthehesha sa majtas-djathtas, nga të gjitha anët.
Befas rashë me fytyrë përdhe dhe u bëra copash,
Dhe ata u përpoqën të më bashkonin me duart e tyre mjeshtërore
Më pas u ktheva sërish në një kukull të ndrequr
dhe të gjitha lëvizjet e mia ishin të studiuara e të kurdisura.
Por qysh atëherë u ktheva në një lloj kukulle ndryshe,
posi një degëz e plagosur e varur në një dredhëz.
Dhe më pas shkova të kërceja në një ballo
por ata më lanë në shoqërinë e qenve dhe të maceve
edhe pse hapat e mi ishin të matur e të modeluar.
Dhe unë kisha flokë të artë dhe sy deti
dhe unë kisha një fustan me ngjyrën e luleve në kopsht
dhe unë kisha një kapelë kashte të stolisur me një qershi.

Leah Goldberg
(1911-1970)

Portretit të nënës sime

Portreti yt është kaq i qetë. Ti je ndryshe:
Shumë pak krenare dhe në siklet që je nëna ime.
Duke më shoqëruar me një lot dhe një buzëqeshje nënshtruese
Ti nuk pyet kurrë: "Kush?"

Ti kurrë nuk u shtange, kurrë nuk u zemërove kur vija drejt teje
me kërkesën e radhës: *"Kam nevojë!"*
Me duart e tua ti jepje gjithëçka
Vetëm sepse unë jam unë.

Ti i kujton sot më tepër se unë
keqardhjet e fëmijërisë time dhe atë çka shpirti yt hiqte:
Ditën kur vajza jote e pjekur do të vinte drejt teje,
dhe sillte bashkë me të edhe pikëllimin e saj të rritur.

Po. Do të vij e rrënuar dhe nuk do të pyes si je.
Nuk do të qaj në krahët e tu dhe të pëshpëris: "Nënë!"
Ti do ta dish atëherë
se ai që më braktisi ishte më i dashur për mua se ty
dhe nuk do të pyesësh kurrë: "Kush?"

Zelda Schneurson Mishkovsky
(1914-1984)

Secili prej nesh ka një emër

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga Zoti
dhe nga prindërit tanë

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga shtati ynë, buzëqeshjet tona
apo nga ajo ç'ka veshim

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga malet
dhe nga muret tanë

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga yjet
dhe nga fqinjët tanë

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga mëkatet tona
dhe nga zgjatja e tyre

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga armiqtë tanë
dhe nga dashuritë tona.

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga festat tona
dhe nga puna jonë.

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga stinët
dhe nga verbëria jonë

Secili prej nesh ka një emër
të dhënë nga deti
dhe nga vdekja jonë.

Bernard–Henri Lévy

REFLEKSIONE MBI LUFTËN, TË KEQEN DHE FUNDIN E HISTORISË

(Autobiografi: ajo që do bëjë në këtë punë të detyruar)

E përktheu nga frëngjishtja Flurans Ilia

Militantizëm, dakord. Humanizmi i tjetrit. Të tërheqësh vëmendjen e botës mbi luftërat, arsyet, virtytet, që intelektualët japin për të bërë çka bëjnë dhe të cilët, në rastin tim sikur edhe në rastin e të parëve të mi, dukshëm, mbartin pjesën e tyre të së vërtetës. Po të tjerat? Pjesa tjetër e arsyeve të vërteta? Atyre që kanë përzgjedhur t'i mbajnë për vete dhe që, edhe për vete, ngurojnë ndonjëherë t'i pranojnë? Aventura. Duhet thënë, po qe se duhet të them gjithëçka, shija e aventurës. Eksperimenti i vetvetes. Shija, si thoshte Foucault, të ndryshosh, të mendosh ndryshe nga ç'mendojmë, të jetosh ndryshe nga ç'besojmë se si duhet jetuar. Dashuria e identiteteve të ndryshme. Të jesh ky këtu dhe ai atje. Të mos jesh mbi të gjitha, tipi që ju kanë caktuar për një qellim, këtu, atje, identiteti. Jo me romantizëm, jo. Nuk besoj se është një rikthim te romantizmi, estetizmi, etj. Por Michaux shprehet : duam me ngul të jemi dikushi. Ose : duam shumë të jemi besnikë të vetvetes, varfanjaken e tij «të jesh vetvetja» - si mundet ta thyesh? Si ta tradhëtosh? Si, edhe pse e dimë mirë se është, thuajse gjithmonë, një iluzion, përdredhje e qafës e shkëlqesisë së saj vetvetes. Liria, pra. Kjo këtu : të qenit në shumës, gjithçka dhe asgjë, të shumfishtë dhe askush – të shenjtërosh në pabesi. Por kjo formë tjetër gjithashtu, ëndërr antike, që e gjej veç këtu, në këtë situatë lufte, këto reportazhe, ku loja e së vërtetës, e luajtur gjer në fund, të detyron të thuash : jetoj në mënyrën time; principet e tyre, të miat. Emocione të reja. Ndjenja të reja. Një tjetër regjim, i befasishëm, për motorin mendor që do të thotë, fiziologjikë. Këto «gjendje të limituara» për të cilat Sartre thotë se, ja shqisin subjektin vetvetes, dhe ringrehin pjesën e tij të rastësishme. Këto situata të cilat Bataille i quan «gjendje pseudoperiodike», sepse ato «vërshojnë jashtë» subjektit, sepse janë të shkëputura nga ky i fundit dhe marrëdhëniet e tij dykahëshe, duke i dhënë kah një algjebre të re të ndjesive. Dakord, Bataille thotë : lojëza gjendjesh, erotike, revolucionare, mistike. Po përse jo luftëtare, ashtu si janë? Përse jo luftën në vend të lojës, të mistikes, të revolucionit? Dhe përse jo një prirje e cila, zë vend, sikur te Batallie, që ta lidhi njeriun në një organikë të humbur, ta shpjerë në kahun ekstrem të vetes, në pikën e tij – radikalisht të veçantë, tipar i të gjithë vazhdimit absolut? Kjo pra është. Sartre shkrirë në Bataille. Efekti-Sartre në gjendjet Bataille. Subjekti absolut sartrien në vendin e shkrirjes organike të autorit të Bluja e qiellit. Dhe ndijimeve pra. Të parafytyrimeve të pa shprehura. Ka shkrimtarë të cilëve romani u shërben për të kërkuar mundësitë e panjohura të ekzistencës. Unë shkruaj reportazhe. Ndoshta ngaqë edhe unë e mbart, sikur Sartre, reportazhin për lloj letrar "par excellence". Ndoshta ngaqë romanet e sotëm të gjithë, në të gjitha mënyrat, janë duke u bërë reportazhe. Fakti, cilidoqoftë, është aty. Gjendet në reale, jo në trill, në të cilin prej kohësh jam duke kërkuar parafytyrimet e mia të pashprehura. Ka parafytyrime «të mëdha», sigurisht. Parafytyrime madhore. Ka parafytyrime që kapërcejnë Ferrin. Përvoja të Djallit dhe të Hiçit. I them shpesh vetes se një shkrimtar duhet, sikur edhe një herë të vetme, të përshkojë brenda vetes diabolikën e hiçit. I them gjithmonë vetes se shprehja e njohur «Historia është një ëndërr e keqe nga e cila përpiqem të zgjohem» ka pasur e sigurt një kuptim të detajuar, konkret, dhe që do të ishte mirë ta dije ekzaktësisht cilin nga këto kuptime. Ja. U krye. Një sezon që ecën me hapa pas, Ferri, Historia bashkëkohore. Disa muaj të shkuara duke provuar hipotezën e madhe blasfemike : një botë e krijuar, jo nga Zoti, por nga Djalli – Zoti i reduktuar, si në Kabbalën e Lurias, në disa thëngjij shenjtëronjës. Por ekzistojnë gjithashtu parafytyrime krejt të vogla. Dhe jam dikush i cili nuk «shikon» sipas rrjedhës së jetës. Shpesh pyes të afërmit e mi për motin që ka bërë përgjatë ditës. Janë ata që më informojnë rreth ngjyrës së një pejsazhi që më ka pëlqyer apo tingullin që kam dasht. Atje, një reportazh i detyrueshëm, e shoh. I dëgjoj. Njësoj sikur trupi im të jetë në gjendje alarmi. Radarët e mi që nuk humbin kurrë energji. Është njësoj sikur të gjitha kapacitetet e mia të parafytyrimit të kallaiseshin, papritur, në funksion të veprimit. Ngjyra. Zhurma. Aroma e amësht e gjakut që puhiza e shpje nëpër pemët e kafesë në Tenga. Gjithmonë themi «aroma e zbarët e gjakut». Por nuk e dija që një aromë mund të ishte kaq e fortë, kaq e ashpër, e dhunshme. Të gjitha konturet e muzgut. Të gjitha ngjyrat e mundshme të agut. Nuk ka dy mëngjese, as dy netë, që ngjasojnë – dhe është, në Afrikë, në Sri Lanka, në Bosnie, në qytetet e stërgjatura të reportazheve të mia qysh prej tridhjetë vjetësh, që jam maturuar. Dritëza agu mu në zemër të territ. Hëna që duket midis dy reve dhe përmbyt kampin, mbi kreshtat e Donji Vakuf, ku trupat bosniake përgatisin në fshehtësi mësymjen. Ditë të rënda në ngritje, pothuajse të ngrysura në gri, si në Maglaj, disa javë më parë, - dhe atje, në të kundërt, çfarë fati, edhe unë vet habitem, njësoj si ushtarët, duke e bekuar këtë zgjatim të hijes në favorin e lëvizjes tonë. Murmurima të panjohura. Ulërima misterioze. Nuk besoj, akoma më tepër atje, që mund të ketë kaq shumë



mënyra të mundëshme e të ndryshme ulërimash, kaq shumë tonalitete të veçanta të thirrjes – të prera apo të zgjatura; vajtonjëse apo tërbonjëse, të prera me vrik, si një grykë e prerë me thikë; zgjatonjëse, si një klithmë pulëbardhe; ulëronjëse; kuitëse; buitëse; hingëllitëse si hingëllima e një kali të plagosur; klithma që ngrihen drejt qiellit; zhyten drejt humnerës; ulërimë për të të trembur; ulërmë sepse ke frikë; ulërimë, më pas rënkim, si në gjykimin e fundit; alfabeti i emocioneve, toni i ndjesive, e lexueshme në ngjyrën e ulërimës. Çaste ngashnjimi gjithashtu. kënaqësia më e vogël – jo kënaqësia e luftës, sigurisht ! të gjitha kënaqësitë e tjera të vogla që lufta ende nuk ka mundur t'i vjedhë ! menunë e kënaqësive të të jetuarit fitimtar mbi dhe kundra luftës ! një rreze dielli... aromën e pishës së sapo prerë në një kazermë bosniake... pushimin pas një marshimi të gjatë... një gllënjkë ujë të vakët... një dush... çarçafë prej vërteti në një shtrat të vërtetë kur më bie rruga sërish nga Luanda... një telefon që funksionon dhe që lejon të dëgjosh zërin e njerëzve të tu... – kënaqësinë më të pakët, them, që merr përmasa mrekullie. Të qeshura. Frikëra. Psherëtima të trishtuara. Të papriturën e tejskajshme, kur predhat bien shumë afër edhe kur frika dhe streha e saj, nuk dëgjon më veç zhurmën e gjakut që troket kundruall ballit. Qetësia, në kundërpërgjigje, një qetësi gati hyjnore, heritazhi i shenjtorëve, kur bombardimi ndalon - «paqe magjike dhe e tmerrshme, shija e vërtetë e kalimit të kohës» (Guy Debord). Koka që shpërthen sërish, mushkritë që djegin, pikat e ngrira të djersës që, mu në pikun e diellit të përcëllojnë sytë, kur goditjet e artilerisë rifillojnë, duhet, në Grondj, t'ja mbathësh transheve duke zbritur si rrufe përgjatë linjës së kodrës me bombat serbe që të ndjekin këmba këmbës. A bënë shumë ftohtë apo nxehtë në Ferr? Evangjelistët thonë : shumë nxehtë. Isaïa thotë : xhehneja, vendi i torturave të zjarrit. Milton, Blake, Udhëtimi i Telemakut i Féneloit, flasin për lumenj flakësh, liqenë vullkanikë, llumra gropash që zjejnë, tenxhere ku engjëjt hapin kapakët për të vëzhguar deformimin e mishit të të mallkuarve. Por Pitagora, pas Ovidit, pretendon që Styxi është i ngrirë. Ka pirgje teologësh të Mesjetës që, të turbulluar nga ky zjarr që djeg pa e shkatërruar dhe ruajtur trupin e viktimave sikur kripa e shëllirës, popullon mbretërinë e të vdekurve në burimin e lotëve të ngrira, turbina bore, shkretëtira akulli, liqene të ngrirë. Dante thotë është i ftohtë, shumë ftohtë – fundi i ajrit në Ferr. Edhe Baudelaire... Në transhetë bosniake më ka rënë ndër mend dhe kuptova për të parën herë që i dija për mendësh poezitë e Baudelaire. Dhe këtu në Angola, dymbëdhjetë vjetë pasi shkrova Ditët e fundit të Charles Baudelaire, më janë rishfaqur vargjet e tij «diabolike». Një tjetër funksionim i kujtesës. Kujtime të zhytura që ringrihen në sipërfaqe. Kujtime të aty për atyshme që emocioni i nxjerr jashtë shtratit të kujtesës dhe i kref po ashtu. Një tingull i padëgjuar më parë, një zhurmë tamburi në jug të Bujumbura, kërcitja e krisur e një bidoni të ndryshkur mbi të cilin po shkelja pa e pasur mendjen në një transhe në Bubanza, e gjitha një kazan kujtimesh të hedhura atje tej dhe që fillojnë të lëkunden. Frika, sigurisht. Efekti i frikës mbi kujtesën. Kam frikë, po, kam pasur dendësisht frikë, në Tenga, Burundi, në çastin e shkëmbimit të zjarreve me armë, edhe përgjatë udhës së kthimit, me ushtarët e plagosur që jepnin shpirt brinjë meje, që, nën efektin e kësaj frike, nën tryezën e kësaj jete të keqe që më mbyt, ndodhen të tjera copëza kujtese, pa asnjë lidhje me situatën në fjalë, të dhjamura, parazite, që depërtojnë në shpirtin tim ; një ledhatim, një psherëtimë, një perëndim dielli meksikan, floku i A. në dritën e një pejsazhi mesdhetar, një fjalë e saj, një gjest i njohur i saj që nuk ka nevoj për fjalë, për të parën herë, i përket pastërtisht, një pejsazhi dëbore, një filxhani me çaj, një perëndim dielli në gjirin Positano, një lojë kukamçefti e fëmijërisë, një sekuencë filmi që më ka lënë mbresa të forta dhe e cila nuk më kujtohet më. Çmenduria e kohës. Vënia në ujë të nxehtë e shejzave të saj. Shpesh ato janë ditë të shfaqura qartë, plumb, ku nuk ndodh asgjë dhe minutat janë të dyfishuara - «univers i ndyrë dhe çaste të tij tepër të rënduara». Disa herë është e kundërta : një kohë që ikën shumë shpejt; çaste të pjestuara në dy; ide pa lidhje logjike, të pakontrollueshme, që sillen si insekte të çakërdisura. Libra, sigurisht. Vazhdoj të lexoj, por ndryshe. Këto kujtime kurrë nuk e kanë kapërcyer Vdekja e Virgjilit që isha duke lexuar, natën e parë si bujtës gjer në shuarjen e zjarrit në vatër, në shtëpinë mikpritëse të komandantit afganas Massoud në Panshir. Të njohësh aty për aty – një njohje e çuditshme, pak magjike, por e sigurt – që është duke gdhendur, me një bojë të pashlyeshme, detajet e pakta të këtij botimi të Kaputt (Curzio Malaparte) rilexuar për të disatën herë, në Huambo, në bujtinën e vogël të ish sheshit qendror Norton-de-Matos, përballë pallatit qeveritar, ku edhe gjeta një dhomë : kuptimet, sigurisht, fjalët; sulmi i kapitullit të tretë («atë mëngjes, kisha shkuar me Svartsröm për të liruar kuajt nga burgu i akullt; një diell jeshil, mu në qiellin e hapur ngjyrë blu, ndriçonte, ...») ; tipografia e vet librit ; përmbajtja e këtyre kapitujve ; një numër telefoni zhgaravitur sipër një faqe e cila më rivjen gjithherë në kujtesë ; një njollë e kuqe, sipër një tjetër faqeje, e cila kishte kulluar sipër fjalisë «banda e madhe e çifutërve po ja mbathte rrugëve». Të rimëson se si të mbulosh kokën. Me të qeshura nën dhëmbë, nga këto budallalliqe diskrete. Të presësh. Të vraposh. Të mbushesh me frymë. Të vraposh sërish. Trupat, të ngulura në tokë, të cilat, në situata rreziku, pretendojnë se e komandojnë shpirtin. Trupat kërkojnë veç t'i japin res-

ton shpirtit. Shpirtërat kërkojnë veç të përballen. Por është trupi që i reziston tundimit. Është ai që vidhoset pas të vetmes dëshirë se si të mbijetojë dhe që, ndonjëherë, në kalkulim e sipër, i bënë dëm lidhjes me shpirtin. Kështu pra, në Maglaj, ku duhej të bridhje, i zbuluar, duke kapërcyer një vreshtë, për të mbërritur nga një transhe në tjetrën : shpirti është i bindur të lëshohet përpara : shpirti e di që duhet të vrapojë si era për të kapur pa u vonuar transhenë tjetër ; shpirti nuk ka se si ta dijë që në të gjithë këtë lojë në pak çaste dhe të cilat janë të vetmet që i kanë ngelur ndoshta, përballë ka, një artilier që e ka vënë në shënjestër ; por janë gjunjët që nuk e ndjekin, që jetojnë jetën e tyre të pavarur dhe që, duke besuar se po bëjnë më të mirën e mundëshme, më bllokojnë mu në mesin e trajektores, mes vreshtës, mu si një kafshë me katër këmbë. Një krejt tjetër ndjesi për të mbijetuar. Tjetër përvojë në vetevete. Me thënë të vërtetën nuk ka të bëjë me shpirtin. As trupin. Por me kafshën. Gjendja ime kafshërore krejt intime. Kjo bishë që shtrihet tek unë, akoma edhe më e pandashme se sa vet hija ime dhe që, atë mëngjes, kishte marrë gjithçka në dorë. Një tjetër lojë e jetës dhe vdekjen. Një jetë që, papritur, sikur nuk më është dhuruar. Një pjesë e imja që sapo e zbuloj dhe për të cilën them se mundet, pa asnjë dhimbje, ta shbëjë. Për këtë lloj përvoje vetëm të vdekurit mundet të dëshmojnë. Por e kam përjetuar edhe unë në dy raste të ndryshme. Një herë në Jessore, në Bangla-Desh, në ditën e pushtimit të qytetit, kur një ushtar pakistanez, i armatosur gjer në dhëmbë, më vendosi pas murit. Një tjetër herë, njëzet vjet më pas, në lartësitë e Sarajevos, natën e parë, në atë kazermën e njohur serbe në Lukavica, bombarduar nga bosniakët kësaj here, ku besoja se ora ime e fundit kishte mbërritur. Kjo përvojë, pra, të shohësh një përshpejtim, apo të përqafosh në një drejtim të vetëm vështrimin, është një film i ekzistencës së vet jetës. Një ndjesi revolte, çdo herë. Një tmerr, edhe revoltë, ndaj idesë së hiçit. Tjetërkund jo. Nuk është e mjaftueshme asgjëja. Nuk do të kisha ndjerë, po qe se kjo nuk do ishte veç kthimi në zero, as këtë tmerr, as këtë revoltë. Sekretet e vërteta të cilat fillojnë e ç'mbështillen. Të vërteta që fshihen nga vet vetja e tyre dhe që shpesh, shpërthejnë si gonxhe. Vdekja si gjithmonë. Vdekja në zemër të jetës. Vdekja, jo si një e vërtetë, apo kufi i jetës, por si një bërthamë e fortë e saj. Shija për të luajtur me këtë vdekje. Shija për ta shbërë lojën. Shija, thoshte Perken, heroi i Rruga e kurorës, për të luajtur jo vetëm me të, por kundra saj, vdekja e vdekjes, e ndoshta kështu për ta shmangur. Portreti i një aventurieri si lojtar. Të luash kukamçefti me vdekjen. Arti si t'ja dredhësh vdekjes, të hysh në lojën e saj, të dalësh fitimtar. Më duket vetja njëçikë si ata aeroplanët me ndihma që përshkonin qiellin e Sarajevos dhe të cilët qysh nga çasti kur radarët e tyre detektonin faktin se ishin nën shënjestrën e artilerisë serbe, prodhonin një imazh sonor të gënjeshtërt dhe e lëshonin diku nëpër re larg vetes për ta çoroditur dhe mashtruar kundërshtarin. Sindroma e zhytësit. Temat e njohura sartriene të thembrave prej plumbi të cilat ju bëjnë të zbrisni nga perandoria juaj filozofike për t'ju shpënë në lakuriqësinë e kushteve njerëzore dhe të jetës. E kam vënë re mjaftueshëm te shumë të tjerë këtë tërheqje pas rëndesës, si të thuash në anën e dobët të ndërgjegjes, e kam thënë madje mjaftueshëm se përmasa e shlyerjes dhe e pendimit të cilat janë pjesë përbërëse të angazhimit të intelektualëve, më kanë bërë për të qeshur me mënyrën se si kënvështrohet angazhimi si një «goditje» e relitetit në një shpirt i cili me ose pa të drejtë, beson se është duke u shkëputur nga thithka e gjirit (Nizani dhe tundimi i Adenit, modeli real i Aragonit, të gjithë këta murgjë me duart tepër të bardha të ardhur, në fillin e viteve '30, më pas '50, sërish në shkollën e jetës vetëm e vetëm për të shlyer mëkatin e tyre fillestar...) shumë kam thënë për këtë nostalgji të konkretes tek të tjerët, në epokat antike, për të mos e përmendur në raport me veten time, sot, në epokën (internet, klonazh, virtualitet i shkëputur) ku realja, nuk përpiqet të të gllabërojë, është duke shpërthyer, është duke u eklipsuar. Shija e kaosit. Kurioziteti ekstrem i Perëndimit përparon ball këtyre imazheve të rrëmujës dhe shkatërrimit. Shkatërrimi ishte Beatriçja ime. Jo si kampist, por të shkruash, mbi rrënoja. Duke shpëtuar trupin sigurisht. Por gjithashtu, si ta mohosh?, duke vëzhguar se si funksionon një trup i vuajtur, i vdekur, në kufijtë më ekstreme të jetës – poshtërim i madh i reportazhit, fëlliqësi e madhe e udhëtimit, entomologji e egër, eksperiment i apasionuar me kafshë të gjalla. Nostalgji e asketizmit. Kam miq që shkojnë nëpër luftëra, të ushqejnë shijen e tyre të epikes, lirizmit. Unë jo. Jo epikën. As lirizmin. Sepse gjithmonë kam menduar, e mendoj, se e kam pasur pa reportazhet, dozën time të lirizmit (jetë e brendëshme). E në vazhdim, nuk mendoj se lufta është vendi i duhur për lirikët dhe epikët. Asketizmi në të kundërt, po. Shija e një jete të zhveshur në të cilën mobilimi është ndoshta teje i ngarkuar : zakone, konventa, urbanizëm, para, e gjithë kjo pjesë e jetës që përbënë pasurinë e saj – dhe e cila, shpesh, fluturon në shpërthime – duke lënë veç një trup të brishtë, tre këmisha, botimin e vjetër të Kaput, disa ëndrra. Nga të gjitha këto, edhe ato kupat e tjera me sekrete madje, nga kjo kënaqësi e huaj që provoj kur jam duke bërë asketikun, këtë çast më ndjekin këmba-këmbës hije që, me doemos më shtyjnë të bëhem i denjë, nuk dua të flas pra për përparësi – ndoshta ngaqë nuk shoh, këtë çast, shumë qartë. Ja, kjo është.

ATË SERGI, "MËKATI I KRENARISË"

Nga Agim Baçi

(Shënime mbi novelën "Atë Sergi" të Leon Tolstoit, përkthim i Jorgji Doksanit)

Njeriu dhe mëkati. Beteja ka nisur kur njeriu hodhi hapin e parë. Rrugët përballë i ndan një fill i hollë, e kufiri i vetëm mbetet ndoshta te një pyetje që duhet ta bëjmë për të kuptuar më pas edhe përgjigjet – kur e kuptojmë botën, kur i kemi kthyer sytë te vetja apo te të tjerët?

Nuk ka nevojë për përgjigje me zë të lartë, sepse vetëm zemra mundet t'ia numërojë rrahjet rrugës së cilës kërkon t'i dish emrin.

Leon Tolstoi ka pikturuar krenarinë e hipur mbi kalin që duhet ta shohin të tjerët teksa trokëllin kur merr udhën, kur hapat e kanë kërcitjen për veshin tjetër, për syrin tjetër, për historinë që duhet të të thurin kur je gjallë e pas vdekjes. Një kalë që, vrapon të të largojë sa më shumë nga ajo shtëpizë brenda kraharorit tënd, brenda qenies tënde, por që thjesht krijon disa largësi të rreme.

Togeri Stepan Kasatskin kapërceu derën e Kishës, për t'u futur në rrobën e murgut, kur kuptoi se nuk mund të ishte ai që kish menduar në rrugën e tij drejt ngjitjes para botës. Krenaria e mori përdore dhe e drejtoi në shtegun e zhvlerësimit të dashurinë së nëpërkëmbur. Po përse? Sepse e fejuara, kontesha Korotkova, me të cilën ai krijoi njohjen, me qëllimin për t'u bërë i pranuar në oborrin e shoqërisë mondane, ishte dashnorja e perandorit Nikollai Pavlloviçit. Por ç'mund të ndodhë kur rrugën drejt Zotit e nis me llogaritë për të kërkuar t'i tregosh të tjerëve veçse krenarinë pa zemrën, për të bërë gjithçka që të tjerët të flasin vetëm për ty?

"*...Ai zgjodhi rrugën e manastirit për të qenë më lart se ata që deshin t'i tregonin se qëndronin më lart se ai*", shprehet motra e Kasatskinit kur ai vendos të bëhet murg menjëherë sapo e fejuara i rrëfen historinë me perandorin. ("Atë Sergi", L. N. Tolstoi, f. 13, botim 1992, përktheu J. Doksani).

Ajo perde që duket aq e hollë në fillim, kur ti kërkon gjithçka ta bësh që të biesh në sy, nis e thuret përditë si një gardh mes teje dhe zemrës tënde. Kështu ndodh me togerin e Tolstoit. Përballja me epshin është aty, e ai e lufton përditë. Ia di fuqinë. I ruhet. Kërkon të japë nga trupi i tij, nga gjaku i tij, që epshi të mos e përshkruajë në zemër. Por, ende ka diçka që nuk ka mundur ta mposhtë: epshi për të bërë një veprim për të rënë në sy mbi të tjerët– ndoshta epshi më i vështirë se gjithëçka tjetër me të cilën përballet njeriu në këtë botë. Ajo krenari për të mos pranuar se ka humbur është ende e fortë brenda tij, duke qëndruar si një portë e hapur për mëkatin.

Por, mëkati nga mendjemadhësia, nga pafuqia për të falur dikë, apo edhe për të pranuar të të ndihmojnë e të falin të tjerët, qëndron aty, për sa kohë nuk ke dashur ta lexosh mrekullinë që vjen nga rruga drejt vetes. Madje, edhe vetëgjymtimi, si i Atë Sergit, për t'i shpëtuar mëkatit me zonjëzën që donte medoemos ta provokonte, nuk e ngre dot britmën deri brenda zemrës. Sepse nëse nisim një rrugë drejt Atij, pa ndërmjetës, pa pasur nevojë as për veshë e sy të tjerë, kemi nevojë të kalojmë nga shtegu mes faljes e pendimit.

Një novelë që sjell para nesh portretin e krenarisë tone për botën. Të paktën deri në momentin kur Atë Sergi përballet me atë që nuk e ka besuar kurrë se është e vërteta, por që e ka patur pranë që në fëmijëri - me Pashenkën që ka tentuar ta tallë e ta shohë si të kotë. Vetëm kur ndeshet me të, me përulësinë e saj, ai nis të lëvizë perden që e kish penguar gjithnjë zemrën të ecte në rrugën e krenarisë pa mëkatin e mendjemadhësisë.

E sa të tillë janë të padukshëm në mirësitë e tyre, rreth e rrotull nesh, pa fjetur në shtrat krenarie? Shumë, mund të jenë më shumë se sa mendojmë, përderisa miliona buzëqeshje tek ne shkaktohen nga "gjërat që nuk i dimë si na erdhën". Është shpesh Fati me fytyrën e të pamenduarit që na bën shpesh të ndryshojmë në jetën tonë.

"*Ja pra,* ç'domethënie *pati ajo* ëndrra *ime. Pashenka* është *njeriu që duhej të isha unë, por që nuk isha. Unë rrojta për njerëzit i fshehur prapa Zotit, ajo rron për Zotin, dhe i duket se rron për njerëzit. Po, një punë e mirë, një gotë ujë që jepet pa bërë hesap shpërblimin,* është *më e shtrenjtë se bamirësitë e mia drejtuar njerëzve*". ("Atë Sergi", L. N. Tolstoi, f. 65-66, botim 1992, përktheu J. Doksani).

Një novelë që ja vlen lexohet e rilexohet, sepse arrin të ndërtojë pyetje që kanë nevojë për përgjigje. Sepse, për të kuptuar veten dhe ata që duam tí kemi pranë, është e rëndësishme të nisim të pyesim: A jemi gati të përballemi me krenarinë tonë për jetën e kësaj bote?

Por, a e kemi zemrën "në vendin e duhur" për të dhënë përgjigje?



中国—阿尔巴尼亚经典图书互译出版项目

SHQIPËRIA NËPËRMJET ARTISTËVE

艺术阿尔巴尼亚

[阿尔巴尼亚] 费里德·胡泽里 著
王娴雅 译

外语教学与研究出版社